



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR
RAPORTIMIN E DETYRUAR DHE PERIODIK TË
SHOQËRIVE TË SIGURIMIT DHE RISIGURIMIT

Miraturar me Vendimin e Bordit nr. 34, datë 28.05.2015
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 17, datë 26.02.2016
*Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 77, datë 30.05.2016**
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 107, datë 31.05.2019

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore ka objekt përcaktimin e formës, mënyrës, përmbajtjes, listës, periudhës, si dhe afateve kohore për përgatitjen nga ana e shoqërisë së sigurimit të pasqyrave financiare dhe raporteve të tjera të detajuara mbi veprimtarinë e saj.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo Rregullore miratohet në zbatim të nenit 111, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".

Neni 3

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet nga shoqëritë e sigurimit të licencuara për të ushtruar veprimtari sigurimi në Republikën e Shqipërisë, së bashku me kërkesat e Rregullores "Mbi funksionimin e sistemit të raportimit AMF In-Reg", miraturar me Vendimin e Bordit nr. 26, datë 23.02.2011, e ndryshuar.

Neni 4

Raportet dhe pasqyrat financiare e statistikore

1. Lista e raporteve dhe pasqyrave financiare, statistikore e të qeverisjes e korporatës, që përbëjnë llogaridhënien e detyruar vjetore e periodike të shoqërive të sigurimit, të cilat raportohen në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare nëpërmjet sistemit AMF- In Reg, është si më poshtë, e grupuar në kategoritë përkatëse:

a. ***Pasqyra financiare 3 mujore** (raportohet me bazë tremujore)

Kjo pasqyrë, si rregull, raportohet deri më 31 janar të vitit pasardhës për vitin dhe brenda 30 ditëve kalendarike nga fundi i çdo tre mujori, për periudhat e ndërmjetme. Pasqyrat FI 17Q, 18Q, 19Q, 20Q dhe 21Q raportohen në çdo rast brenda 30 ditëve kalendarike nga fundi i çdo tremujori. Forma, përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të pasqyrave financiare 3 mujore përcaktohen në aneksin 1, të kësaj rregulloreje.

ER: Kurset e këmbimit

FI 1Q: Bilanci – Aktiv

FI 2Q: Bilanci – Pasiv

FI 3Q: Llogaria Fitim / Humbje, Jo-Jetë

FI 4Q: Llogaria Fitim / Humbje, Jetë

FI 5Q: Pasqyra e Fluksit të Parave

FI 6Q: Llogaria Fitim / Humbje, Aktiviteti jashtë territorit të R.Sh.

FI 7.1Q: Llogaria teknike, Jo-Jetë (Pjesa A)

FI 7.2Q: Llogaria teknike, Jo-Jetë (Pjesa B)

FI 8A: Llogaria teknike, Jetë

Raportim mbi portofolin e investimeve

FI 9.1Q: Toka dhe ndërtesa

FI 9.2Q: Investime në filiale dhe shoqëri të bashkëkontrolluara

FI 9.3Q: Investimet financiare afatgjata

FI 9.4Q: Investimet financiare afatshkurtra

FI 10Q: Llogari të arkëtueshme tregtare

FI 11Q: Llogari të pagueshme tregtare

FI 12Q: Kostot e marrjes në sigurim, Jo-Jetë

FI 13Q: Kostot e marrjes në sigurim, Jetë

FI 15Q: Shpenzimet administrative

FI 16Q: Përputhshmëria e aktiveve

FI 17Q: Provigjoni i primit të pafituar – Jo-Jetë

Provigjone bruto për primin e pafituar

Pjesa e ceduar në risigurim

FI 18Q: Provigjone matematike – Jetë

Provigjone bruto për primin e pafituar

Pjesa e ceduar në risigurim

FI 19Q: Provigjoni i dëmeve- Jo-Jetë

Provigjone për dëme pezull

Provigjone IBNR

Pjesa e ceduar në risigurim

FI 20Q: Provigjoni i dëmeve – Jetë

Provigjone për dëme pezull

Provigjone IBNR

FI 21Q: Rezerva të tjera teknike

b. *Raport mbi Aktivet në mbulim të Provigjoneve Teknike (raportohet me bazë tremujore)

Kjo pasqyrë, si rregull, raportohet deri më 31 janar të vitit pasardhës për vitin dhe brenda 30 ditëve kalendarike nga fundi i çdo tre mujori, për periudhat e ndërmjetme. Forma, përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të raportit mbi aktivet në mbulim të provigjoneve teknike përcaktohen në aneksin 2, të kësaj rregulloreje.

FI 10 Raport mbi Aktivet në mbulim të Provigjoneve Teknike

c. *Raport mbi Mjaftueshmërinë e Kapitalit (raportohet me bazë tremujore)

Kjo pasqyrë, si rregull, raportohet deri më 31 Janar të vitit pasardhës për vitin dhe brenda 30 ditëve kalendarike nga fundi i çdo tre mujori, për periudhat e ndërmjetme. Forma, përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të raportit mbi mjaftueshmërinë e kapitalit përcaktohen në aneksin 3, të kësaj rregulloreje. Kjo pasqyrë raportohet në të njëjtat afate kohore dhe në të njëjtën formë dhe për grupet e sigurimet sipas përkufizimeve të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014.

FI 9 Raport mbi Mjaftueshmërinë e Kapitalit

d. *Statistika 3 mujore (raportohet me bazë tremujore)

Këto pasqyra, si rregull, raportohen deri më 31 janar të vitit pasardhës për tremujorin e fundit dhe brenda 30 ditëve kalendarike nga fundi i çdo tre mujori, për tremujorët e tjerë. Forma, përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të statistikave 3 mujore përcaktohen në aneksin 4, të kësaj rregulloreje.

St BA 1Q: Raport mbi primet dhe dëmet

ST 3Q: Sigurimi individual i Pensionit Vullnetar Suplementar

ST 4Q: Sigurimi kolektiv i Pensionit Vullnetar Suplementar

e. **Statistika mujore** (raportohet me bazë mujore)

Këto pasqyra raportohen brenda datës 15 të muajit pasardhës. Forma, përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të statistikave mujore përcaktohen në aneksin 5, të kësaj rregulloreje.

St 1M: Primet, Jo-Jetë

Kontrata sigurimi të paguara

Kontrata sigurimi të anuluar

St 2M: Primet, Jetë

Kontrata sigurimi të paguara

Kontrata sigurimi të anuluar

St 3M: Dëmet, Jo-Jetë

Dëme të paguara

Dëme pezull

St 4M: Dëmet, Jetë

Dëme të paguara

Dëme pezull

St 1R M: Risigurim i pranuar: Primet, Jo-Jetë

St 2R M: Risigurim i pranuar: Primet, Jetë

St 3R M: Risigurim i pranuar: Dëmet, Jo-Jetë

St 4R M: Risigurim i pranuar: Dëmet, Jetë

f. ***Statistika vjetore** (raportohet me bazë vjetore)

Këto pasqyra, si rregull, raportohen deri më 31 janar të vitit pasardhës. Forma, përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të statistikave vjetore përcaktohen në aneksin 6, të kësaj rregulloreje.

ST 2A: Trekëndëshat e dëmeve në sigurimet motorike

ST 3A: Të dhëna të punësimit

G 1A: Shpërndarja gjeografike e primeve të Jo-Jetës

G 2A: Shpërndarja gjeografike e primeve të Jetës

G 3A: Shpërndarja gjeografike e dëmeve të Jo-Jetës

G 4A: Shpërndarja gjeografike e dëmeve të Jetës

G ST 5Q: Kufijtë e mbajtjes

ST 6Q: Primet dhe dëmet - Cedimi në Risigurim

ST 7Q: Pasqyra e zhvillimit të provigjonit të dëmeve

TI 12: Mbajtja maksimale neto, për çdo risk për çdo produkt sigurimi

g. Të dhëna teknike 3 mujore (raportohet me bazë tremujore)

Kjo pasqyrë raportohet deri më 31 mars të vitit pasardhës për vitin dhe brenda 30 ditëve kalendarike nga fundi i çdo tre mujori, për periudhat e ndërmjetme. Forma, përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të të dhënave teknike 3 mujore, përcaktohen në aneksin 7, të kësaj rregulloreje.

TI 1: Kufiri minimal i aftësisë paguese, Jo-Jetë

h. Të dhëna teknike Ad-Hoc (raportohet rast pas rasti sipas afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi – shiko dhe shënimet përbri pasqyrave si më poshtë). Forma, përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të të dhënave teknike Ad-Hoc, përcaktohen në aneksin 8, të kësaj rregulloreje.

TI 3: Informacion për marrëveshjet e risigurimit - Kjo pasqyrë plotësohet në mënyrë progresive dhe në mënyrë të veçantë për çdo marrëveshje risigurimi, brenda 5 ditëve nga data e kontraktimit të saj.

TI 4: Lista e rreziqeve mbi 10%-in e Aftësisë Paguese - Kjo pasqyrë plotësohet në mënyrë progresive dhe në mënyrë të veçantë për çdo përgjegjësi të kontraktuar, brenda 5 ditëve nga data e kontraktimit të saj.

TI 5: Informacion mbi risigurimet fakultative - Kjo pasqyrë plotësohet në mënyrë progresive dhe në mënyrë të veçantë për çdo marrëveshje risigurimi fakultativ, brenda 5 ditëve nga data e kontraktimit të saj.

TI 6: Informacion mbi risiguruesit - Kjo pasqyrë plotësohet në mënyrë progresive dhe në mënyrë të veçantë për çdo marrëveshje risigurimi, brenda 5 ditëve nga data e kontraktimit të marrëveshjes.

TI 7: Lista e dëmeve mbi 10 mln. lekë - Kjo pasqyrë plotësohet në mënyrë progresive dhe në mënyrë të veçantë për çdo dëm të ndodhur, brenda 5 ditëve nga data e marrjes dijeni të dëmit nga ana e shoqërisë.

TI 8: Raporti i Auditit të Jashtëm

TI 9: Caktimi i Ekspertit Kontabël të Pavarur

TI 10: Raporti i Auditit të Brendshëm

TI 11: Programi i Risigurimit - Kjo pasqyrë plotësohet jo më vonë se 60 ditë kalendarike para

i. **Të dhëna teknike vjetore** (raportohet me bazë vjetore)

Këto pasqyra raportohen deri më 15 Shkurt të vitit pasardhës. Forma, përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të të dhënave teknike vjetore, përcaktohen në aneksin 9, të kësaj rregulloreje.

TI 2: Kufiri minimal i aftësisë paguese, Jeta

FI 22Q: Primet dhe dëmet

j. **Të dhëna Tremujore mbi Qeverisjen e Korporatës** (raportohet me bazë tremujore)

Këto pasqyra raportohen deri më 31 mars të vitit pasardhës për vitin dhe brenda 30 ditëve kalendarike nga fundi i çdo tre mujori, për periudhat e ndërmjetme.

Forma, përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të të dhënave 3 mujore mbi qeverisjen e Korporatës, përcaktohen në aneksin 10, të kësaj rregulloreje.

CG 1: Aksione dhe Aksionarë

CG 2: Kompania

CG 3: Drejtorët

CG 4: Organigrama

CG 5: Informacione

CG 6: Të dhëna të punësimit

2. Pasqyrat duhet të jenë të firmosura nga Drejtori i Përgjithshëm dhe në varësi të informacionit, nga aktuari i autorizuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.
3. Nëse shoqëria zbaton firmën elektronike sipas përcaktimeve në sistemin AMF In-Reg, atëherë pasqyrat depozitohen vetëm në formë elektronike. Në rast të kundërt shoqëria pasi plotëson pasqyrat, përveç dërgimit nëpërmjet sistemit AMF In-Reg, i printon, firmos dhe vulos pasqyrat e më pas i dërgon dhe në kopje letër në Autoritet brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
4. Shoqëritë e sigurimit duhet të plotësojnë pasqyrat bashkëlidhur, pjesë integrale e kësaj rregulloreje, duke mbajtur parasysh dhe dispozitat e rregullores “Mbi funksionimin e sistemit të raportimit AMF In-Reg”, miratuar me Vendim Bordi nr. 26, datë 23.02.2011.
5. Shoqëritë e sigurimit përdorin Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar në përgatitjen e pasqyrave financiare. Format i raportimit në Autoritet kryhet në përputhje me pasqyrat e

përcaktuara në këtë rregullore.

6. Vlerat në pasqyrat statistikore dhe pasqyrat e tjera ku është e zbatueshme, duhet të korrespondojnë me vlerat në pozicionet përkatëse të pasqyrave financiare, si bilanci dhe pasqyra fitim/humbje.

Neni 5

Dispozita përfundimtare

1. Udhëzimi nr. 140, datë 26.09.2012 “Për listën e dokumenteve të llogaridhënies së detyruar vjetore e periodike të shoqërive të sigurimit e risigurimit”, shfuqizohet.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas mbylljes së vitit financiar.

ANEKS 1.

Forma, përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të pasqyrave financiare 3 mujore:

ER: Kurset e këmbimit

Në këtë pasqyrë duhet të vendosen kurset e këmbimit detajuar në monedhat përkatëse sipas Bankës së Shqipërisë në datën e mbylljes së Bilancit.

FI 1Q: Bilanci – Aktivi

Aktivi i shoqërive të sigurimit do të ketë strukturën e mëposhtme:

AKTIVI:

- A. Kapitali i nënshkruar i papaguar
- B. Aktive jo-materiale
- C. Investime në toka, ndërtesa dhe investime financiare
- D. Depozita në shoqëri ceduese
- E. Investime për llogari të policëmbajtësve të sigurimit të jetës që mbajnë riskun e investimit
- F. Pjesa e risiguruesve në provigjonet teknike
- G. Pjesa e risiguruesve në provigjonet teknike për llogari të policëmbajtësve të sigurimit të jetës që mbajnë riskun e investimit
- H. Pjesa e risiguruesve në provigjone për risqe dhe detyrime të tjera
- I. Llogari të arkëtueshme tregtare
- J. Aktivi tatimor i shtyrë
- K. Parapagime dhe të ardhura të llogaritura
- L. Aktive të tjera

Bazuar në kuadrin konceptual (Framework) përkufizimi i një aktivi është:

Një aktiv është një burim ose e drejtë ekonomike e kontrolluar nga entiteti, i cili ka ardhur si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe nga përdorimi i të cilit entitetit pritet ti vijnë përfitime ekonomike të ardhshme (për shembull, përmes hyrjes së pagesave ose pakësimit të daljes së pagesave). Një aktiv njihet në bilanc kur është e mundur që në njësinë raportuese do të hyjnë përfitime të ardhshme ekonomike dhe aktivi ka një kosto ose vlerë që mund të matet me besueshmëri.

Aktiv: A. Kapitali i nënshkruar i papaguar

Kapitali i rritur me miratimin e Asamblesë së Aksionarëve, por ende i pa paguar.

Aktiv: B. Aktive Jo materiale (1+2+3)¹

Aktiv: B - I. Emri i mirë

Teprica mes çmimit të blerjes së një shoqërie dhe vlerës së drejtë të aktiveve neto (totali i aktiveve - totali i detyrimeve) të shoqërisë në momentin e blerjes.

Në datën e blerjes, blerësi duhet:

- Të njohë emrin e mirë të blerë në një kombinim biznesi si një aktiv; dhe
- Të masë fillimisht këtë emër të mirë me koston e tij, që është tejkalimi i koston së kombinimit të biznesit mbi interesin e blerësit në vlerën neto të drejtë të aktiveve, detyrimeve e detyrimeve me kusht.

Mbas njohjes fillestare, blerësi mat emrin e mirë të blerë në një kombinim biznesi me kosto minus çdo humbje të zhvlerësimit të akumuluar.

Emri i mirë (SNRF 3) i blerë në një kombinim biznesi nuk amortizohet. Por në vend të kësaj, blerësi teston atë çdo vit për zhvlerësim, ose më shpesh nëqoftëse ngjarje ose ndryshime në rrethanat tregojnë se ai mund të jetë zhvlerësuar, në përputhje me SNK 36 zhvlerësimi i Aktiveve.

Aktiv: B - II. Aktive të tjera jo materiale

Aktive jo financiare pa substancë fizike, por që mund të identifikohen: patenta, licenca, marka, franshiza, e drejta e autorit, programe kompjuterike, modele, prototipe, formula si dhe aktive jo-materiale në fazën e zhvillimit.

Për të përmbushur kriterin e identifikueshmërisë që jepet në SNK 38 aktivi duhet të jetë:

- I ndashëm - Të ketë mundësi të veçohet ose ndahet nga njësia ekonomike dhe të shitet, transferohet, licencohet, jepet me qira ose shkëmbehet, qoftë individualisht ashtu edhe me një kontratë, aktiv ose pasiv, ose;
- I krijuar nga të drejtat ligjore ose kontraktuale, pavarësisht nëse këto të drejta janë të transferueshme ose të ndashme nga të drejtat dhe detyrimet e tjera.

Pas njohjes fillestare, aktivet jo-materiale (aktivet e patrupëzuara) duhet të maten duke përdorur:

- Modelin e Kostos, ose
- Modelin e rivlerësimit (jo i zakonshëm).

Aktiv: B - III. Amortizimi i aktiveve jo-materiale (-)

Aktivët jo materiale me jetëgjatësi të përcaktuar ekonomike duhet të amortizohen në mënyrë sistematike në varësi të metodës së zgjedhur.

Aktivët jo materiale me jetëgjatësi të papërcaktuar ekonomike duhet të testohen në bazë vjetore për humbje të vlerës (SNK 36) dhe jo të amortizohen.

Aktiv: C. Investime në toka, ndërtesa dhe investime financiare (I+II+III)

Në këtë grup regjistrohen të gjitha investimet sipas burimeve të financimit: nga provigjonet

teknike dhe matematike të sigurimeve nga veprimtaria e dëmeve, nga provigjonet teknike e matematike të sigurimeve nga veprimtaria e jetës, fitimet nga aktiviteti i shoqërisë dhe nga investimet e kapitalit. Të veçanta mbahen edhe investimet në toka dhe në ndërtesa.

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar për një njësi ekonomike dhe një detyrim financiar ose instrument të kapitalit të vetë për njësinë tjetër ekonomike.²

Aktiv: C - I. Toka dhe ndërtesa³ -

Në këtë zë përfshihen toka dhe ndërtesa, parapagimet dhe pagesat pjesore të kryera për ndërtimet në proces, të drejtat në pasuri të paluajtshme dhe të drejta të tjera të ngjashme të përcaktuara në Kodin Civil. Ky zë duhet të paraqitet i detajuar sipas zërave përbërës dhe amortizimeve përkatëse në pasqyrën e shënimeve të pasqyrave financiare.

Në njohjen fillestare, Aktivet afatgjata materiale/ toka dhe ndërtesa maten me koston e tyre në datën e blerjes. Në kosto përfshihen të gjitha shpenzimet e nevojshme që kryhen për ta bërë aktivin të gatshëm për t'u përdorur për qëllimet e parashikuara. Zëvendësimi i pjesëve të aktiveve afatgjata materiale ose shtesat të përkufizuara si kosto të mëpasshme duhet të kapitalizohen po qe se ato plotësojnë kriteret e njohjes si aktiv dhe përmirësojnë dobitë ekonomike të aktivit (për shembull rritje e jetës së dobishme të aktivit, rritje e sipërfaqes së punës etj.). Kostot e mirëmbajtjes së përditshme duhet të përfshihen në shpenzimet e periudhës. SNK 23 lejon edhe trajtimin alternativ të lejuar të kapitalizimit të kostove të huamarrjes që lidhen drejtpërdrejt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e një aktivi të kualifikuar (aktiv që kërkon patjetër një periudhë kohe të gjatë për të qenë gati për qëllim përdorimi apo shitjeje).

Pas njohjes fillestare, aktivet afat gjata materiale/toka dhe ndërtesa përfshirë dhe rastin kur këto janë të investuara (SNK 40) duhet të maten duke përdorur:

- Modelin e Kostos, ose;
- Modelin e Rivlerësimit.

Pasi modeli të jetë zgjedhur, ai duhet të përdoret për të gjitha aktivet e përfshira në këtë klasë (toka dhe ndërtesat, makineritë e pajisjet).

Bazuar në SNK 16 rivlerësimi duhet të jetë periodik. Rivlerësimi duhet të jetë i bazuar në një ekspertizë të certifikuar dhe të pavarur e cila duhet të lëshohet në të njëjtën ditë të bilancit. Raporte të tilla duhet të lëshohen periodikisht (p.sh. çdo 3 vjet).

Shumat që i korrespondojnë asaj pjese të tokës dhe ndërtesës të zëna nga një shoqëri sigurimi për zhvillimin e aktivitetit të vet, raportohen në pasqyrën Fl 9.1Q "Toka dhe Ndërtesa".

Totali i këtij zëri duhet të përkojë me totalin e po të njëjtit zë në pasqyrën Fl 9.1Q "Toka dhe Ndërtesa".

Toka dhe Ndërtesa duhet të çregjistrohet:

- Kur del nga përdorimi dhe;
- Kur parashikohet të mos japë përfitime ekonomike të mëtejshme.

Në momentin e çregjistrimit, diferenca midis shumave neto të marra nga dalja prej përdorimit (shitja) dhe vlerës kontabël të aktivit mund të jetë fitim ose humbje neto. Fitimi ose humbja neto nga çregjistrimi i Aktiveve afatgjata materiale duhet të njihet në pasqyrën fitim/humbje. Fitimet neto nuk duhet të përfshihen në të ardhurat e shfrytëzimit.

¹SNK 38

² SNK 32

³ SNK 16 & SNK 40

Aktiv: C - II. Investime në filiale dhe shoqëri me interesa pjesëmarrëse (1+2+3+4+5)⁴

Filiale (Shoqëri të kontrolluara) - Në këtë zë do të përfshihen ato investime në njësitë ekonomike në të cilat shoqëria mëmë zotëron influencë domethënëse dhe kontroll mbi aktivitetin e kësaj njësie ekonomike; zakonisht shoqërohet me zotërim të aksioneve në masën 50-100% (Investimet në Filiale/shoqëri të kontrolluara)⁵.

Një shoqëri mëmë do të paraqesë pasqyra financiare të konsoliduara në të cilat ajo konsolidon investimet e saj në filiale/ shoqëri të kontrolluara në përputhje me SNK 27.

Kur përgatiten pasqyra financiare individuale për një shoqëri mëmë për kontabilizimin e investimeve në filiale shoqëri të kontrolluara përdoret metoda e kostos së amortizuar. Metoda e kostos është një metodë e kontabilitetit për një investim, sipas të cilës investimi njihet me kosto. Investitori njeh të ardhura nga investimi vetëm në shkallën që investitori merr shpërndarje nga përfitimet e akumuluar të investimit pas datës së blerjes. Shpërndarjet e marra përtej këtyre përfitimeve konsiderohen si mbulim i investimit dhe njihen si zbritje të kostos për investim (SNK 27).

Interesa Pjesëmarrëse (ose investime në shoqëri të bashkëkontrolluara) - Në këtë zë do të përfshihen ato investime në njësitë ekonomike në të cilat shoqëria mëmë zotëron influencë domethënëse (dhe e cila nuk është as filial/ shoqëri e kontrolluar dhe as një interes kapitali në një sipërmarrje të përbashkët) por jo kontroll mbi aktivitetin e kësaj njësie ekonomike; zakonisht shoqërohet me zotërim të aksioneve në masën 20-50%. Zotërimi i aksioneve në këtë masë me të drejtë vote përbën pjesëmarrje të cilësuar. Për vlerësimin kontabël të investimeve me interesa pjesëmarrëse do të përdoret metoda e kapitalit neto.

Metoda e kapitalit neto është metodë e kontabilitetit sipas të cilës investimi njihet fillimisht me kosto dhe rregullohet më pas për ndryshimin pas blerjes të pjesës që i përket investorit në aktivet neto të të investuarit. Fitimi ose humbja e investorit përfshin pjesën që i takon atij në fitimin ose humbjen e të investuarit (SNK 38). Gjithashtu zbatohen kërkesat e SNK 39 për të përcaktuar nëse ndonjë humbje zhvlerësimi shtesë duhet të njihet në lidhje me interesin e investorit në pjesëmarrje. E gjithë vlera kontabël e investimit testohet për zhvlerësim.

Totali i këtij zëri duhet të përkojë me totalin e po të njëjtit zë në pasqyrën Fl 9.2Q “Investime në filiale dhe shoqëri të bashkëkontrolluara”.

Aktiv: C - III. Investime të tjera financiare (1+2+3+4+5+6+7)⁶ -

Totali i këtij zëri duhet të përkojë me totalin e po të njëjtit zë në pasqyrat Fl 9.3Q “Investimet financiare afatgjata” dhe Fl 9.4Q “Investimet financiare afatshkurtra” (në përputhje me afatet e maturimit të këtyre instrumentave).

Njohja fillestare e aseteve duhet të jetë në përputhje me SNK 39. Edhe llogaritjet në vijim të vlerës së aseteve do të kryhen në varësi të llojit dhe klasifikimit të asetit sipas SNK 39.

Aktiv: C – III – 1. Të mbajtura deri në maturim

Këto do të përfshihen aktivet financiare jo derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe me maturim të përcaktuar, për të cilat shoqëria ka treguar qëllim të mirë dhe aftësi për t’i mbajtur deri në maturim si letra me vlerë të qeverisë (në zërin “1.1.1 Letra me vlerë të Qeverisë”) si dhe investime të tjera të kësaj natyre (1.1.2 Të tjera).

Aktiv: C – III – 2. Të vlefshme për shitje (2.1 + 2.2)

Në këtë zë do të përfshihen aktive financiare jo derivative me të ardhura fikse ose të ndryshueshme të cilat mbahen nga shoqëria të vlefshme për shitje (aksione – zakonisht nën 20% ose letra borxhi) të cilat nuk janë klasifikuar nga shoqëria si:

- a. Hua dhe të arkëtueshme;
- b. Deri në maturim;
- c. Vlerë e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Aktiv: C – III – 3. Me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (3.1+3.2+3.3+3.4)

Në këtë zë do të përfshihen aktive financiare me të ardhura fikse ose të ndryshueshme (aksione - zakonisht nën 20%, letra borxhi apo derivativë), të cilat mbahen nga shoqëria për tregtim (shitje/blerje) me qëllim fitimin afat-shkurtër dhe/ose aktivet financiare të cilat në bazë të SNK 39, pika 9-b që në fillim njihen si të tilla nga shoqëria.

Aktiv: C – III – 4. Depozita në bankë

Në këtë zë përfshihen shumat e depozituara në institucione të autorizuar, me afate maturimi mbi 3 muaj, të përcaktuara në marrëveshje, duke përfshirë dhe Fondin e Garancisë.

Një detajim i këtij zëri për çdo bankë dhe për çdo llogari të depozitave me afat duhet dhënë në pasqyrën FI 9.1 Raport mbi Mjaftueshmërinë e Kapitalit (1) . Në pasqyrat FI 9.3Q dhe FI 9.4Q jepet detajimi i depozitave sipas afateve të maturimit.

Aktiv: C – III – 5. Hua hipotekore

Në këtë zë përfshihen hua të dhëna nga shoqëria të cilat janë të garantuara me hipotekë.

Aktiv: C – III – 6. Hua të tjera

Në këtë zë përfshihen hua të dhëna nga shoqëria të cilat janë të pa garantuara me hipotekë.

Aktiv: C – III – 7. Investime të tjera financiare

Në këtë zë përfshihen të gjitha investimet e tjera, që nuk janë përfshirë në zërat e mësipërm. Në rast se shumat e investimeve të tilla janë të konsiderueshme dhe zënë më shumë se 30% të totalit të grupit kryesor “Investime”, ato duhet të pasqyrohen të analizuar në aneksin e bilancit në formularin "Shënime".

⁴ SNK 28

⁵ Pjesëmarrja influencuese nënkupton zotërimin e drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë të aksioneve në një shoqëri sigurimi nga një person fizik ose juridik, në bazë të të cilave personi fizik ose juridik zotëron jo më pak se 10 për qind ose më shumë se 10 për qind të aksioneve me të drejtë vote në kapitalin e shoqërisë, pjesëmarrje, e cila i jep të drejtën e vendimmarrjes në këtë shoqëri sigurimi . Nëse një investitor zotëron, në mënyrë direkte ose indirekte (p.sh. nëpërmjet filialeve/ shoqërive të kontrolluara), 20 përqind ose më shumë të fuqisë votuese të të investuarit, supozohet që investitorika influencë domethënëse/pjesëmarrje të cilësuar.

⁶ SNK 39

Aktiv: D. Depozita në shoqëri ceduese

Në këtë zë pasqyrohen depozitat që vendosen si garanci financiare nga shoqëria e risigurimit për shoqërinë ceduese (të sigurimit). Këto shuma shërbejnë si garanci për të siguruar ceduesin për pagesat e pritshme të ardhshme të dëmeve.

Këto shuma nuk mund të bashkohen me shuma të tjera të zotëruara nga shoqëritë ceduese të sigurimeve për risiguruesit, si dhe me shumat e zotëruara nga risiguruesit për shoqëritë ceduese (siguruese).

Ky zë pasqyrohet në aktivin e shoqërisë risiguruese dhe në detyrimet e shoqërisë ceduese (shoqërisë së sigurimit).

Aktiv: E. Investime për llogari të policëmbajtësve të sigurimit të jetës që mbajnë riskun e investimit

Në këtë zë përfshihen investimet e policave të sigurimit të jetës, për të cilat riskun e investimit e mbart policëmbajtësi. Këto polica konsistojnë në një kontratë ndërmjet policëmbajtësit dhe shoqërisë së sigurimit që e lejon policëmbajtësin të ketë një plan kursimi përveç atij të sigurimit në të njëjtën policë. Policëmbajtësi mund të zgjedhë vetë portofolin në të cilin do të investojë atë pjesë të primit që shkon për planin e kursimit, duke mbartur kështu riskun e investimit por edhe potencialin për kthim të investimit.

Aktiv: F. Pjesa e risiguruesve në provigjonet teknike (I+II+III+IV+V+VI)

Kjo rubrikë e aktivit llogaritet e veçantë sipas llojit të provigjonit teknik për primin e pafituar, për sigurimin e jetës, për dëmet pezull, për bonuse e rabate, për provigjone të tjera teknike.

Aktiv: F - I. Provigjone të primit të pafituar

Në këtë zë përfshihet shuma e primeve të pafituara e ceduar në risigurim. Shuma e këtij provigjoni i përket pjesës së primit të shkruar të ceduar, që i përket periudhës së rrezikut pas datës së mbylljes së vitit financiar.

Ky zë duhet të përkojë me totalin (detajuar sipas klasave të sigurimit) të po të njëjtit zë në pasqyrën Fl 17Q “Provigjoni i primit të pafituar – Jo-Jetë, Pjesa e ceduar në risigurim” në rastin e një shoqërie që ushtron veprimtari sigurimi për klasat e sigurimit të jo jetës dhe me pasqyrën Fl 18Q “Provigjone matematike – Jetë, Pjesa e ceduar në risigurim” në rastin e një shoqërie që ushtron veprimtari sigurimi për klasat e sigurimit të jetës.

Aktiv: F - III. Provigjone të Dëmeve

Në këtë zë përfshihen shumat e parashikuara të dëmeve pezull të cilat sipas marrëveshjes kontraktuale të risigurimit janë përgjegjësi e risiguruesit. Këto shuma i përkasin dëmeve të ndodhura dhe të raportuara në vitin financiar aktual, ende të pa paguara.

Në rastin kur pjesa proporcionale që i takon risiguruesit për një dëm (sipas marrëveshjes kontraktuale të risigurimit) i paguhet policëmbajtësit nga shoqëria e sigurimit (pra policëmbajtësi shlyhet plotësisht), por risiguruesi nuk i ka paguar shoqërisë së sigurimit pjesën proporcionale të

dëmit kjo pjesë e papaguar do të kontabilizohet në zërin “Llogari të arkëtueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria e risigurimit”.

Totali i këtij zëri duhet të përkojë me totalin (e detajuar sipas klasave të sigurimit) të po të njëjtit zë në pasqyrën FI 19Q “Provigjoni i dëmeve- Jo-Jetë, Pjesa e ceduar në risigurim” në rastin e një shoqërie që ushtron veprimtari sigurimi për klasat e sigurimit të jo jetës dhe me pasqyrën FI 20 Q “Provigjoni i dëmeve – Jetë, Pjesa e ceduar në risigurim” në rastin e një shoqërie që ushtron veprimtari sigurimi për klasat e sigurimit të jetës.

Aktiv: G. Pjesa e risiguresve në provigjonet teknike për llogari të policëmbajtësve të sigurimit të jetës që mbajnë riskun e investimit

Në këtë zë përfshihet pjesa e risiguresve në provigjonet teknike, sipas marrëveshjes kontraktuale të risigurimit, për llogari të policëmbajtësve të produktit në “Aktiv:E”.

Aktiv: H. Pjesa e risiguresve në provigjone për risqe dhe detyrime të tjera (I+II)

Aktiv: H. I. Provigjone për pensione

Në këtë zë përfshihet pjesa që i takon risiguresve në provigjonet për planet/skemat e pensioneve që shoqëria e sigurimit krijon dhe menaxhon në përfitim të punëmarrësve të saj, aktual dhe të mëparshëm, sipas marrëveshjes kontraktuale të risigurimit.

Aktiv: H. II. Provigjone të tjera

Në këtë zë përfshihet pjesa e risiguresve në provigjonet e tjera që shoqëria e sigurimit krijon dhe menaxhon në përfitim të punonjësve të saj, të ndryshme nga skemat e mësipërme të pensioneve.

Aktiv: I. Llogari të arkëtueshme tregtare (I+II+III)

Aktiv: I - I. Llogari të arkëtueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria direkte e sigurimit (1+2+3+4)

Totali i këtij zëri duhet të përkojë me totalin e zërit I. “Llogari të arkëtueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria e sigurimit”, të pasqyrës FI 10Q, sipas nënzërave përkatës.

Aktiv: I – I – 1. Policëmbajtësit

Në këtë zë përfshihen:

- Policëmbajtësit që detyrohen për këstet vijuese të kontratës, për të cilat ata kanë paguar të paktën një këst;
- Detyrime për dëmet e shkaktuara nga mbajtësit e mjeteve motorike të pa pajisur me certifikatën e sigurimit;
- Detyrime të tjera të policëmbajtësve si dëme të paguara më tepër apo prime të arkëtuara më pak, etj.

Aktiv: I – I – 2,3. Ndërmjetësit, Filialet/ Shoqëritë e kontrolluara

Në këtë zë përfshihen:

- Detyrimet e ndërmjetësve (agjentëve) për policat e sigurimit të shitura në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit si dhe detyrimet e tjera që lindin nga marrëdhëniet e ndërmjetësimit në sigurime;
- Detyrimet e filialeve/shoqërive të kontrolluara ndaj shoqërisë mëmë për primet e risigurimit, dëmet e paguara (paguar nga kjo e fundit për llogari të filialit/shoqërisë të kontrolluara) apo çdo lloj marrëdhënieje që lind nga veprimtaria direkte e sigurimit.

Aktiv: I – I – 4 Të tjera

Këtu regjistrohen të tjera llogari të arkëtueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria direkte e sigurimit të pa përfshira në zërat e mësipërm.

Aktiv: I – II. Llogari të arkëtueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria e risigurimit (1+2)

Totali i këtij zëri duhet të përkojë me totalin e zërit II. “Llogari të arkëtueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria e risigurimit”, të pasqyrës FI 10 Q, sipas nën zërave përkatës.

Aktiv: I – II – 1. Llogari të arkëtueshme tregtare nga risigurime të shitura nga shoqëria

Ky zë gjendet në aktivin e shoqërisë që kryen aktivitet risigurimi. Në këtë zë përfshihen të drejtat e arkëtueshme të shoqërisë risiguroese nga shoqëritë siguroese (ceduese).

Aktiv: I – II – 2. Llogari të arkëtueshme tregtare nga risigurime të blera nga shoqëria

Në këtë zë përfshihen të drejtat e shoqërisë ceduese (siguroese) nga shoqëritë risiguroese që lindin nga marrëdhënia e risigurimit:

- Detyrime që rrjedhin nga shoqëritë risiguroese, për kontratat e lidhura dhe ende të paarkëtuara, që përballohen nga risiguroesi si;
- Detyrimet e shoqërive risiguroese ndaj shoqërisë së sigurimit për pjesën e dëmeve, që sipas kontratave të lidhura, përballohen nga shoqëritë risiguroese;
- Shuma e primit, e vendosur në formën e depozitës për risiguroesit;
- Të tjera detyrime që lindin nga marrëdhëniet midis shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, që nuk janë përfshirë në grupimet e mësipërme.

Aktiv: I – III. Të tjera llogari të arkëtueshme tregtare (1+2+3)

Në këtë zë përfshihen debitorë të tjerë të ndryshëm nga ato të veprimtarisë direkte të sigurimeve/risigurimeve, si debitorë nga palë të lidhura, nga financimet ndaj palëve të treta, nga marrëdhëniet me shtetin, dhe nga marrëdhënie të tjera.

Totali i këtij zëri duhet të përkojë me totalin e zërit III. “Llogari të tjera të arkëtueshme tregtare” të pasqyrës FI 10Q.

Aktiv: J. Aktiv tatimor i shtyrë

Këtu përfshihen vlera të aktivit tatimor të shtyrë që lindin nga dallimet e përkohshme mes

raportimit financiar dhe atij për efekt tatimesh.

Aktivët tatimore të shtyra janë shumat e tatimeve mbi të ardhurat të rikuperueshme në periudhat e ardhshme në lidhje me:

- diferencat e përkohëshme të zbritshme;
- mbartjen e humbjeve tatimore të papërdorura; dhe
- mbartjen e kreditimeve tatimore të papërdorura.(SNK 12)

Aktiv: K. Parapagime dhe të ardhura të llogaritura (1+2+3)

Aktiv: K– I. Shpenzime të marrjes në sigurim të shtyra.

Në këtë zë përfshihen shpenzime të marrjes në sigurim të Jetës dhe Jo-Jetës të shtrira në vitet e ardhshme në përputhje me kohëzgjatjen e kontratës së sigurimit dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në rregulloren e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për llogaritjen e provigjoneve teknike dhe matematike. Shpenzimet e marrjes në sigurim të shtyra trajtohen si aktiv dhe amortizohen përgjatë kohëzgjatjes së kontratës së sigurimit.

Aktiv: K– II. Interesa dhe qira të llogaritura

Në këtë zë përfshihen interesat të llogaritura të periudhës por ende të pa arkëtuara dhe shpenzime të parapaguara qiraje.

Aktiv: K– III. Të tjera parapagime dhe të ardhura të llogaritura

Në këtë zë përfshihen shpenzime të paguara në vitin financiar por që do njihen në periudhat e ardhshme kontabël, si dhe të ardhura të tjera që janë njohur në këtë periudhë por pritet të arkëtohen në periudha të ardhshme kontabël.

Aktiv: L. Aktive të tjera (I+II+III+IV)

Aktiv: L– I. Aktive afatgjata materiale, të ndryshme nga toka dhe ndërtesa

Në këtë zë pasqyrohen të gjitha aktivet e tjera të qëndrueshme përveç zërit “Toka dhe Ndërtesa” si pajisje, mjete transporti, mobilie, pajisje kompjuterike, etj.

Aktiv: L– II. Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare (1+2)

Aktiv: L– II - 1. Llogari rrjedhëse dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në bankë⁷

Në këtë zë përfshihen shumat e depozituara në institucione të autorizuar pa afat kohor dhe/ose shumat e depozituara në institucione të autorizuar, me afate maturimi deri në 3 muaj (përfshirë 3 muaj). Gjithashtu, në këtë zë regjistrohen edhe balancat negative siç është rasti i overdraftit (‘llogari bankare e zbuluar’) për shumën e përdorur.

Aktiv: N. Llogaritë jashtë bilancit

Në këtë zë përfshihen angazhime (të drejta) të shoqërisë me palë të treta (siç mund të jenë palët e lidhura), të cilat mund të kenë efekte financiare ndaj shoqërisë së sigurimit, sipas kontratës së lidhur për këtë qëllim. Shuma përfaqëson vlerën totale të angazhimit dhe amortizohet sipas kushteve të kontratës.

⁷ SNK 7

FI 2Q: Bilanci – Pasivi

Pasivi i shoqërive të sigurimit do të ketë strukturën e mëposhtme:

PASIVI:

- I. Kapitalet e veta;
- II. Detyrime të varura;
- III. Provigjone teknike;
- IV. Provigjone teknike për llogari të policëmbajtësve të sigurimit të jetës që mbajnë riskun e investimit;
- V. Provigjone për risqe dhe detyrime të tjera;
- VI. Depozita që i detyrohen risiguruesve;
- VII. Llogari të pagueshme tregtare;
- VIII. Detyrim tatimor i shtyrë;
- IX. Shpenzime të llogaritura dhe të ardhura të marra në avancë.

Pasiv: A. Kapitalet e Veta (I+II+III+IV+V+VI+VII)

Bazuar në kuadrin konceptual “Kapitalet e veta” është interesi i mbetur në aktivet e entitetit pas zbritjes së të gjitha detyrimeve të tij.

Pasiv: A - I. Kapitali aksionar

Në këtë zë përfshihet kapitali i miratuar dhe i regjistruar.

Pasiv: A - II. Rezerva të kapitalit

Në këtë zë do të përfshihen shuma të fitimeve të lëna mënjanë për një kohë të gjatë deri në një vendim të kundërt të organeve kompetente të shoqërisë. Këto rezerva krijohen në zbatim të dispozitave statutores të shoqërisë së sigurimit.

Pasiv: A - III. Rezerva nga fitimet

Në këtë zë përfshihen rezervat që shoqëria e sigurimit krijon dhe mban çdo vit financiar nga fitimet e veta, nëse fitimi nuk përdoret për mbulimin e humbjeve të trashëguara nga vitet e mëparshme.

Këto rezerva krijohen sipas legjislacionit dhe statutit të shoqërisë së sigurimit.

Pasiv: A - IV. Rezerva rivlerësimi

Në këtë zë përfshihen rezervat që krijohen nga rivlerësimi me rritje të vlerës kontabël të elementeve të Aktiveve Materiale afatgjatë (ulja në vlerë pasqyrohet në pasqyrën fitim

/humbje) ⁸. Këtu përfshihen dhe ndryshimet – rritje/ulje në vlerë (përveç humbjes së vlerës dhe efekteve të normave të këmbimit) – të investimeve financiare të kategorizuara si të vlefshme për shitje ⁹.

Pasiv: A - V. Aksionet e veta (-)

Në këtë zë përfshihen aksionet e riblera nga shoqëria, të cilat në bilancin e shoqërisë emetuese pasqyrohen të zbritshme në përlllogaritjen e “Kapitaleve të Veta”. Gjithashtu, ato nuk merren parasysh kur përlllogariten raportet që matin vlerën e aksioneve.

Pasiv: A - VI. Fitimi/Humbje të mbartura (+/-)

Rezultati financiar i mbartur nga periudhat e mëparshme.

Pasiv: A - VII. Fitimi/Humbje neto për periudhën

Rezultati financiar i periudhës aktuale.

Në rastin kur shoqëria e sigurimit ushtron veprimtari sigurimi për klasat e sigurimit të jo jetës, ky zë duhet të përkohet me zërin XIX, “Fitime / Humbje neto për periudhën”, të pasqyrës FI 3Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jo-Jetë”.

Në rastin kur shoqëria e sigurimit ushtron veprimtari sigurimi për klasat e sigurimit të jetës, ky zë duhet të përkohet me zërin XX, “Fitime / Humbje neto për periudhën”, të pasqyrës FI 4Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jetë”.

Në rastin kur shoqëria e sigurimit ushtron veprimtari sigurimi për klasat e sigurimit të jo jetës dhe të jetës, ky zë duhet të përkohet me shumën midis zërit XIX, “Fitime / Humbje neto për periudhën”, të pasqyrës FI 3Q, “Llogaria Fitim / Humbje, Jo-Jetë” dhe zërit XX, “Fitime / Humbje neto për periudhën”, të pasqyrës FI 4Q, “Llogaria Fitim / Humbje, Jetë”.

Bazuar në kuadrin konceptual Një *detyrim* është një obligim i tanishëm i entitetit që ka lindur nga ngjarje të ndodhura në të kaluarën, shlyerja e të cilit pritët të sjellë daljen nga entiteti të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike.

Një detyrim njihet në bilanc kur është e mundur që një dalje e burimeve, mbartës të përfitimeve ekonomike, do të rezultojë nga shlyerja e një detyrimi aktual dhe shuma me të cilën do të shlyhet ky detyrim mund të matet me besueshmëri.

Pasiv: B. Detyrime të varura

Në këtë zë përfshihen përgjegjësitë (detyrimet) sipas një marrëveshje kontraktuale, që në rastin e mbylljes ose falimentimit të shoqërisë së sigurimit, përgjegjësitë që burojnë nga kjo marrëveshje do të paguhet pasi paguhet të gjithë kreditorët e tjerë.

Pasiv: C. Provigjone teknike (I+II+III+IV+V+VI)¹⁰

Pasiv: C - I. Provigjone të primit të pafituar

Në këtë zë përfshihen provigjonet për primin e pafituar (PPP), si nga shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin e jetës dhe nga ato që ushtrojnë aktivitetin e jo jetës. Shuma e këtij provigjoni

⁸ SNK16, ⁹ SNK 39

¹⁰ Vlerësimi kryhet sipas legjislacionit në fuqi të sigurimeve

përkon me pjesën e primit të shkruar që i përket periudhës së rrezikut pas datës së mbylljes së vitit financiar.

Provigjonet për primet e pafituara për çdo klasë sigurimi krijohen në përpjesëtim me primet e shkruara që lidhen me mbulimet e sigurimit të cilat janë ende të vlefshme pas përfundimit të periudhës financiare gjatë së cilës janë krijuar këto provigjone.

Përveç sa më sipër, shoqëria e sigurimit mund të krijojë provigjone për rreziqe të paskaduara, nëse nga një vlerësim i përgjegjësisë totale, (d.m.th duke përfshirë edhe shpenzimet) në lidhje me ekspozimin ndaj rrezikut pas datës së mbylljes së vitit financiar për policat e lëshuara para asaj date, mund të tregojë që provigjoni teknik i primit të pafituar është i pamjaftueshëm për të mbuluar rreziqet në të ardhmen. Nëse shoqëria e sigurimit mbulon rreziqe që lidhen me sigurimin e garancive dhe kredive, ngjarje të forcës natyrore, si dhe dëmtime të shkaktuara nga energjia bërthamore, ajo krijon provigjone shtesë për primet e pafituara për këto klasa, në përputhje me natyrën e veçantë të tyre.

Provigjonet për primet e pafituara dhe provigjonet për rreziqet e paskaduara përbëjnë së bashku provigjonet për primet.

Pasiv: C - II. Provigjone matematike

Provigjonet matematike, krijohen nga shoqëria e sigurimit që ushtron veprimtari në sigurimin e jetës apo në klasa të tjera sigurimi ku ku primet janë grumbulluar në formën e një fondi kursimi ose një fondi për tu përdorur për mbulimin e rreziqeve e viteve të ardhshme, të cilat janë të natyrës afatgjatë dhe janë subjekt i tabelave të probabilitetit dhe llogaritjeve të njëjta me ato të sigurimit të Jetës.

Provigjonet matematike përllogariten nga shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin e jetës, për secilën nga klasat e sigurimit. Këtu do të përfshihen provigjonet e sigurimit të jetës, të cilat do të krijohen si vlerësim aktuarial, duke marrë parasysh të gjitha detyrimet e ardhshme të shoqërisë së sigurimit, të cilat burojnë vetëm nga kontratat e sigurimit të jetës. Shoqëria e sigurimit llogarit provigjonet matematike për çdo kontratë sigurimi.

Përafrimet ose përgjithësimet mund të zbatohen vetëm nëse gjykohet se zbatimi i tyre sjell një rezultat përafërsisht të njëjtë me atë të llogaritur veçmas.

Kur i siguruari, në bazë të kontratës së sigurimit, ka të drejtën e pagesës së vlerës së dorëzimit, provigjonet matematike, që krijohen duke iu referuar kësaj kontrate, nuk duhet të jenë nën vlerën e pagesës së dorëzimit.

Pasiv: C -III. Provigjone të dëmeve

Këtu regjistrohen provigjonet për dëmet, si nga shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin e jetës dhe ato të jo jetës.

Provigjonet teknike të dëmeve krijohen në nivel të njëjtë me përgjegjësitë e marra përsipër nga shoqëria e sigurimit përmes kontratave, kur ngjarja e siguruar ndodh para përfundimit të periudhës financiare, pavarësisht nëse ngjarja është raportuar apo jo, duke përfshirë çdo shpenzim të pagueshëm nga shoqëria e sigurimit të përcaktuar në kontratën e sigurimit.

Në këtë zë përfshihen shumat e parashikuara të dëmeve pezull të ndodhura dhe të raportuara në vitin financiar aktual, por ende të pashqyrtuara/vlerësuara plotësisht, përfshirë dhe

parashikimin për shpenzimet e trajtimit të dëmeve, si dhe shumat për dëme të ndodhura në vitin financiar, por të paraportuara në këtë periudhë (IBNR). Këtu përfshihen edhe detyrimet e shoqërisë ndaj policëmbajtësve për dëmet e ndodhura të llogaritura/vlerësuara dhe të rëna dakord për t'u paguar por akoma të palikuiduara (përfshirë këtu edhe vlerësimet për dëmet që janë në proces gjyqësor). Gjithashtu shoqëria e sigurimit në këtë zë paraqet dhe vlerësimet për dëmet e refuzuara nëse pala e dëmtuar paraqet provat të reja të kërkuara nga shoqëria e sigurimit përpara përfundimit të afatit të parashkrimit parashikuar në Kodin Civil.

Pasiv: C -IV. Provigjone për bonuse dhe rabate

Provigjonet për bonuse dhe rabate, krijohen në nivel të njëjtë me shumën e pagesave, që merr i siguruari bazuar në:

- a. Të drejtën për përfitimet që rrjedhin nga kontratat e sigurimit ose të drejta të tjera (bonuse) që rrjedhin nga kontratat e sigurimit;
- b. Të drejtën për reduktim të pjesshëm të primit të sigurimit (rabat);
- c. Të drejtën e rimbursimit të një pjese të primit të sigurimit në rast të përfundimit të parakohshëm të kontratës së sigurimit.

Pasiv: C -V. Provigjone barazimi dhe katastrofe

Provigjoni i barazimit të dëmeve krijohet për balancimin e luhatjeve të ndodhjes së ngjarjeve që shkaktojnë dëme. Shoqëria e sigurimit mund të krijojë provigjonin e barazimit të dëmeve për ato klasa të sigurimit, në të cilat, ka një devijim të konsiderueshëm nga shumat e zakonshme të dëmshpërblimeve të llogaritura mbi baza vjetore, devijim i cili, bazuar në të dhënat statistikore, është i pritshëm. Provigjoni i barazimit të dëmeve krijohet bazuar në devijimin e masës së dëmshpërblimeve të pritshme për periudhën financiare, nga masa mesatare e dëmshpërblimeve për të njëjtën periudhë.

Provigjone katastrofe - Këtu regjistrohen provigjone teknike që krijohen duke iu referuar detyrimeve të pritshme dhe rreziqeve për dëme të mëdha, për sigurimin e përgjegjësive nukleare, prodhimeve farmaceutike, tërmete, përmbytjeve, etj.

Pasiv: C -V. Provigjone të tjera teknike

Shoqëria e sigurimit krijon provigjone të tjera teknike me qëllim për të mbuluar përgjegjësitë e pritshme dhe rreziqet për dëme të mëdha të cilat rrjedhin nga siguri i përgjegjësive për humbje nga rreziqe bërthamore, përgjegjësinë e prodhuesit të produkteve farmaceutike, rreziqet e përmbytjes dhe tërmetit, si dhe rreziqe apo përgjegjësi të tjera për të cilat nuk krijohen provigjonet e përmendura më sipër.

Pasiv: D. Provigjone teknike për llogari të policëmbajtësve të sigurimit të jetës që mbajnë riskun e investimit

Këtu regjistrohen provigjonet teknike të krijuara për mbulimin e përgjegjësive që lindin nga produkti në 'Aktiv: E'. Për këtë provigjon teknik, nuk ekziston një metodë e përcaktuar për llogaritjen. Ajo duhet të mbahet në përputhje me rreziqet e mundshme të investimeve që gjykon shoqëria.

Pasiv: E. Provigjone për risqe dhe detyrime të tjera*Pasiv: E – 1. Provigjone për pensione*

Këtu regjistrohen provigjonet për planet/skemat e pensioneve që shoqëria e sigurimit krijon dhe menaxhon në përfitim të punëmarrësve të saj, aktual dhe të mëparshëm.

Pasiv: E – 2. Provigjone të tjera

Këtu regjistrohen provigjonet që shoqëria e sigurimit krijon dhe menaxhon në përfitim të punonjësve të saj, të ndryshme nga skemat e mësipërme të pensioneve. Këtu do të përfshihen edhe rezervat që shoqëria mban për Fond Kompensimi.

Pasiv: F. Depozita që i detyrohen risiguruesve

Në këtë zë përfshihen depozitat e lëna si garanci financiare nga shoqëria e Risigurimit për shoqërinë ceduese (të sigurimit), për ta siguruar këtë të fundit për pagesat e pritshme të ardhshme të dëmeve. Ky zë pasqyrohet në detyrimet e shoqërisë ceduese (shoqërisë së sigurimit) dhe në aktivin e shoqërisë Risiguruese.

Pasiv: G. Llogari të pagueshme tregtare (I+II+III+IV+V)*Pasiv: G – I. Llogari të pagueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria direkte e sigurimit
(1+2+3+4)*

Totali i këtij zëri duhet të përkojë me totalin e zërit I. “Llogari të pagueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria direkte e sigurimit”, të pasqyrës FI 11Q, “Llogari të pagueshme tregtare”, sipas nënzërave përkatës.

Pasiv: G – I - 1. Policëmbajtës

Në këtë zë përfshihen:

- Detyrimet e shoqërisë ndaj policëmbajtësve që sipas kontratave të sigurimit shoqëria u detyrohet për kthimin e primeve;
- Detyrime të shoqërisë së sigurimit ndaj mbajtësve të policave të sigurimit të Jetës për të cilat është marrë përsipër rreziku i investimeve (interesi që përfitojnë klientët), etj.

Ky zë duhet të përkojë me zërin I. 1. “Policëmbajtës”, të pasqyrës FI 11 Q, “Llogari të pagueshme tregtare”.

Pasiv: G – I – 2,3. Ndërmjetësit, Filialet

Këtu regjistrohen llogari të pagueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria direkte e sigurimeve që përfshijnë detyrimet ndaj ndërmjetësve në sigurime për komisionet e ndërmjetësit dhe detyrimet ndaj ndërmjetësve për dëmet që këta të fundit kanë paguar për llogari të shoqërisë së sigurimit dhe/ose risigurimit, si dhe të tjera detyrime që rrjedhin nga shitja e policave.

Këto zëra duhet të përkojnë me zërat I. 2. “Ndërmjetës” dhe I. 3. “Filiale/shoqëri të kontrolluara”, të pasqyrës FI 11Q, “Llogari të pagueshme tregtare”.

Pasiv: G – I – 4. Të tjera

Këtu regjistrohen të tjera llogari të pagueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria direkte e sigurimit të pa përfshira në zërat e mësipërm. Ky zë duhet të përkojë me zërin I. 4. “Të tjera”, të pasqyrës FI 11Q, “Llogari të pagueshme tregtare”.

Pasiv: G – II. Llogari të pagueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria e risigurimit (1+2)

Totali i këtij zëri duhet të përkojë me totalin e zërit II. “Llogari të pagueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria e risigurimit”, të pasqyrës FI 11 Q, “Llogari të pagueshme tregtare”, sipas nënzërave përkatës.

Pasiv: G – II - 1. Nga risigurime të shitura nga shoqëria

Në këtë zë përfshihen detyrimet e shoqërisë risiguruese ndaj shoqërisë siguruese (ceduese) për pjesën e dëmeve që duhet të paguajë sipas kontratës, detyrime për retrocedimet, si dhe detyrimet e tjera që lindin nga ushtrimi i veprimtarisë së risigurimit.

Ky zë duhet të përkojë me zërin II. 1. “Nga risigurime të shitura nga shoqëria”, të pasqyrës FI 11Q, “Llogari të pagueshme tregtare”.

Pasiv: G – II - 2. Nga risigurime të blera nga shoqëria

Këtu përfshihen detyrimet e shoqërisë siguruese (ceduese) ndaj shoqërive të risigurimit për likuidimin e pjesës së primit, sipas kontratës së risigurimit.

Ky zë duhet të përkojë me zërin II. 2. “Nga risigurime të blera nga shoqëria”, të pasqyrës FI 11Q, “Llogari të pagueshme tregtare”.

Pasiv: G – III. Letër me vlerë e mbështetur me instrumenta financiare me të ardhura fikse (1+2)

Këtu regjistrohen ato instrumenta borxhi (Debenture) që shoqëria emeton duke i kolateralizuar me investime në instrumenta financiare me të ardhura fikse. Ky zë duhet të përkojë me zërin III. “Letra me vlerë (Debenture) të kolateralizuara me instrumenta financiar me të ardhura fikse”, të pasqyrës FI 11Q, “Llogari të pagueshme tregtare”.

Pasiv: G – III – 1. Të konvertueshme (në aksione të shoqërisë)

Këtu regjistrohen ato instrumenta borxhi (Debenture) që shoqëria emeton duke i kolateralizuar me investime në instrumenta financiare me të ardhura fikse dhe që i japin të drejtën e zgjedhjes mbajtësit të saj, për ta konvertuar në aksione të shoqërisë emetuese si një alternativë ndaj rimarrjes së huas (Convertible Debenture).

Pasiv: G – IV. Shuma që u detyrohen institucioneve të kreditit

Këtu regjistrohen detyrimet për huatë e marra pranë institucioneve të kreditit, qofshin këto kredi afat gjata (më të mëdha ose baraz me 1 vit) ose kredi afat shkurtra, linja kredie të hapura në llogari rrjedhëse (overdraft) dhe detyrime për qera financiare. Ky zë duhet të përkojë me zërin IV. “Shuma që u detyrohen institucioneve të kreditit”, të pasqyrës FI 11Q, “Llogari të pagueshme tregtare”.

Pasiv: G – V. Të tjera llogari të pagueshme tregtare(1+2+3+4)

Totali i këtij zëri duhet të përkojë me totalin e zërit V. “Të tjera llogari të pagueshme tregtare”, të pasqyrës FI 11Q, “Llogari të pagueshme tregtare”, sipas nënzërave përkatës.

Pasiv: G – V - 1. Llogari të pagueshme tregtare nga financimi (1.1 + 1.2)

Pasiv: G – V – 1.1. Të pagueshme nga palë të lidhura të ndryshme nga filiale/shoqëri të kontrolluara ose shoqëri me interesa pjesëmarrëse

Detyrime që rrjedhin nga investimet financiare të bëra nga palët e lidhura të ndryshme nga filialet ose/dhe sipërmarrje me interes pjesëmarrës.

Pasiv: G – V - 2. Llogari të pagueshme tregtare shtetit (Taksa dhe të ngjashme)

Detyrimet që rrjedhin nga marrëdhëniet me institucionet shtetërore.

Pasiv: G – V - 3. Llogari të pagueshme tregtare që u detyrohen punonjësve

Detyrime për pagat, shpërblimet apo pagesa të tjera për punonjësit.

Pasiv: G – V - 4. Të tjera llogari të pagueshme tregtare

Në këtë zë do të përfshihen dhe detyrimet e shoqërisë për dëmet e shkaktuar nga personat e pasiguruar, pra detyrimet për Fondin e Kompensimit . Detyrimi do të njihet në bilanc kur është e mundur që një dalje e burimeve, mbartës të përfitimeve ekonomike, do të rezultojë nga shlyerja e këtij detyrimi aktual dhe shuma me të cilën do të shlyhet ky detyrim mund të matet me besueshmëri

Në këtë zë përveç detyrimeve për fondin e kompensimit përfshihen dhe detyrime të tjera që nuk përfshihen në zërat e mësipërm.

Pasiv: H. Detyrim tatimor i shtyrë

Këtu përshihen detyrimet tatimore të shtyra të cilat krijohen nga dallimet e përkohshme mes raportimit financiar dhe atij për efekt tatimesh.

Pasiv: I. Shpenzime të llogaritura dhe të ardhura të marra në avancë (1+2)

Pasiv: I – 1. Shpenzime të llogaritura

Këtu regjistrohen shpenzime të njohura por që në datën e mbylljes së bilancit rezultojnë të papaguara.

Pasiv: I – 2. Të ardhura të marra në avancë

Këtu regjistrohen të ardhura të arkëtuara para datës së mbylljes së bilancit financiar të cilat do të njihen në periudhat e ardhshme financiare.

Pasiv: K. Zëra jashtë bilancit

Këtu regjistrohen kryesisht angazhime (detyrime) të shoqërisë me palë të treta (siç mund të jenë palët e lidhura), të cilat mund të kenë efekte financiare ndaj shoqërisë së sigurimit, sipas kontratës së lidhur për këtë qëllim. Shuma përfaqëson vlerën totale të angazhimit dhe amortizohet sipas kushteve të kontratës.

Secili prej zërave të pasqyrave FI 1Q dhe FI 2Q duhet detajuar (horizontalisht) sipas monedhës në të cilën mbahet (vendase në Lekë ose monedhës së huaj, konvertuar në monedhë vendase).

Gjithashtu detajimi i mësipërm duhet të kategorizohet edhe në kategoritë: 'Rezidentë' dhe 'Jo- Rezidentë' duke evidentuar marrëdhëniet (të drejtat dhe detyrimet) me personat fizike ose juridike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë (rezidentë) dhe jashtë saj (Jo-Rezidentë).

FI 3Q: Llogaria Fitim / Humbje, Jo Jetë

Pasqyra Fitim / Humbje, Jo jetë do të ketë strukturën e mëposhtme:

- I. Prime të Fituara neto;
- II. Të ardhura të tjera teknike nga veprimtaria e sigurimeve;
- III. Shpenzime neto për dëme të paguara;
- IV. Ndryshimi në provigjone të tjera teknike;
- V. Shpenzime neto për bonuse dhe rabate;
- VI. Shpenzime operative neto të veprimtarisë;
- VII. Shpenzime të tjera neto të veprimtarisë;
- VIII. Të ardhura të llogaritura nga investimet transferuar nga llogaria jo-teknike;
- IX. Rezultati teknik;
- X. Rritja në vlerën reale (fair value) nëpërmjet llogarisë Fitim / Humbje;
- XI. Investime neto;
- XII. Të ardhura të llogaritura nga investimet transferuar në llogarinë teknike;
- XIII. Të ardhura të tjera;
- XIV. Fitim Humbje të tjera nga investimet;
- XV. Të ardhura të jashtëzakonshme;
- XVI. Shpenzime të jashtëzakonshme;
- XVII. Fitime / Humbje para tatimit;
- XVIII. Fitimi mbi tatimin;
- XIX. Fitime humbje neto për periudhën.

Të ardhurat klasifikohen në: të ardhura nga primet, të ardhura nga investimet, dhe të ardhura të tjera të shoqërisë.

Shpenzimet klasifikohen në: shpenzime për dëmet, shpenzimet operative, shpenzime për investime dhe shpenzime të tjera të sigurimeve.

I. Prime të fituara neto (1+2+3+4)

Këtu përfshihen të ardhurat nga primet e sigurimit bruto të korrigjuara me primet e paguara për risigurime, me ndryshimin e provigjoneve (rezervave) për primet bruto dhe me ndryshimet në provigjonet (rezervat) e primit të risigurimit.

I - 1. Prime të shkruara bruto

Këtu përfshihen primet e shkruara (vlerën totale të policës), sipas kontratës së sigurimit, të risigurimit ose të pjesës së bashkësigurimit që i takon shoqërisë, e cila bëhet e vlefshme në vitin aktual financiar, pavarësisht nga arkëtimi i tij. Ky zë përfshin primin e regjistruar në llogaritë e shoqërisë së sigurimit përpara zbritjes së komisioneve, shpenzimeve të marrjes në sigurim dhe primeve të ceduara në risigurim.¹¹

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë (02) në pasqyrën FI 7.2Q “Llogaria teknike e sigurimeve, Jo-Jetë”.

I - 2. Prime të ceduara në risigurim (-)

Ky zë përfshin pjesën e primit të shkruar bruto të ceduar në risigurim, sipas kontratës së risigurimit e cila hyn në fuqi në vitin aktual financiar.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë (03) në pasqyrën FI 7.2Q “Llogaria teknike e sigurimeve, Jo-Jetë”.

I - 3 Ndryshimi në provigjonin e primeve të pafituara bruto (+/-)

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me diferencën e vlerës së zërit C - I “provigjoni për primet e pafituara bruto” (Bilanc – Pasivi), në datën e raportimit me vlerën me 31 dhjetor të vitit paraardhës, por me shenjë të kundërt.

I - 4 Ndryshimi në provigjonin për primin e pafituar pjesa e risiguresit

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me diferencën e vlerës në zërin F - I në “Bilanc – Aktiv”, përkatësisht “provigjoni i primit të pafituar” në datën e raportimit dhe “provigjoni i primit të pafituar” me 31 Dhjetor të vitit paraardhës.

II. Të ardhura të tjera teknike neto nga veprimtaria e sigurimeve

Ky zë përfshin të ardhura nga aktiviteti i brokerimit apo të ardhura nga aktiviteti i vlerësimit të dëmeve që mund të kryejë shoqëria e sigurimit për llogari të të tretëve. Në këtë zë do të përfshihet edhe vlera e rimbursimeve të dëmeve nga shkaktarët (padi regresi).

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë (06) në pasqyrën FI 7.2Q “Llogaria teknike e sigurimeve, Jo-Jetë”.

¹¹ Për kontrata me jetëgjatësi me të madhe se një vit, nëse kontrata ka klauzolën “automatikisht e rinovueshme” primi shkruhet në bazë vjetore, në të kundërt, primi shkruhet për vlerën totale të kontratës.

III. Shpenzime neto për dëme të paguara (1+2+3+4)

III - 1. Dëme të paguara bruto

Në këtë zë përfshihet vlera monetare e kompensimit për dëmin e ndodhur dhe shpenzimet e trajtimit që i përkasin këtyre dëmeve. Vlera e kompensimit për dëmin e ndodhur është shuma që përfitojnë personat e siguruar në rastin e ndodhjes së dëmit, sipas rezultatit të raportit të vlerësimit.

Në shpenzimet e trajtimit të dëmit¹² përfshihen shpenzimet e brendshme ose të jashtme, që lidhen me trajtimin e rastit të sigurimit, llogaritjen e vlerës së dëmit, shpenzime për investigime, shpenzimet për pagat e vlerësuesve të dëmeve, shpenzime të marrjes me qera (në rastin kur shoqëria e sigurimit i lë palës së dëmtuar mjet me qera deri në riparimin e mjetit të tij), shpenzime rimorkimi, parkimi, shpenzimet gjyqësore dhe shpenzimet për ekspertë. Këto shpenzime kategorizohen në shpenzime të alokueshme dhe jo të alokueshme. Në shpenzimet e alokueshme sipas dëmeve përfshijmë ato shpenzime të cilat i alokohen një dëmi individual specifik.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë (08) në pasqyrën FI 7.2Q “Llogaria teknike e sigurimeve, Jo-Jetë”.

III - 2. Dëme të paguara nga risiguruesit (-)

Në këtë zë do të përfshihet ajo pjesë e “totalit të dëmeve të paguara bruto” që është paguar nga risiguruesi në varësi të kontratës së risigurimit midis palëve, deri në datën e mbylljes së bilancit.

III – 3 Ndryshimi në provigjonin e dëmeve, bruto

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me diferencën e vlerës në zërin e Bilancit – Pasivi, C- “provigjoni për dëme”, në datën e raportimit me vlerën më 31 Dhjetor të vitit paraardhës.

III – 4 Ndryshimi në provigjonin e dëmeve, pjesa e risiguruesit

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me diferencën e vlerës në zërin e Bilancit – Aktivi, F – II “provigjone të dëmeve”, në datën e raportimit me vlerën më 31 Dhjetor të vitit paraardhës, por me shenjë të kundërt.

IV. Ndryshimi në provigjonet e tjera teknike (+/-)

Në këtë zë do të përfshihen ndryshimi në provigjonet e tjera teknike (midis dy bilanceve), referencë zëri C. VI në pasqyrë e bilancit FI 2Q Pasivi.

¹² Në përputhje dhe me bazën ligjore në fuqi për sigurimet, aty ku trajtohen kontabilizimet e shpenzimeve për dëme.

V. Shpenzime neto për bonuse dhe rabate

Në këtë zë përfshihen shpenzime për bonuset dhe/ose rabatet që i ofrohen policëmbajtësve në varësi të kushteve të kontratës. Pjesa e risiguruesit duhet ti zbritet këtyre shpenzimeve, pra shpenzimet duhet të paraqiten neto.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë (13) në pasqyrën FI 7.2Q “Llogaria teknike e sigurimeve, Jo-Jetë”.

VI. Shpenzime operative të veprimtarisë (1+2+3+4+5+6)

VI - 1. Shpenzime të marrjes në sigurim

Në këtë zë përfshihen shpenzime të lidhura me nënshkrimin dhe rinovimin e kontratave të sigurimit duke përfshirë shpenzimet direkte, siç janë: komisionet e paguara agjentëve (ndërmjetësve) të marrjes në sigurim dhe risigurim, pagat e rrjetit të shitjes, shpenzime lidhur me procesin e vlerësimit të riskut të sigurimit, dhe shpenzime indirekte, siç janë: shpenzimet e reklamave dhe promovimeve të produkteve të sigurimit (jo të shoqërisë në tërësi) si dhe shpenzime të përgjithshme të lidhura me verifikimin e aplikimeve dhe lëshimin e policave.

Shpenzimet e marrjes në sigurim duhet të përfshijnë dhe komisionet për rinovimin e kontratave të sigurimit. Shpenzimet e marrjes në sigurim të përfshira në këtë zë nuk janë ato të arkëtuara gjatë periudhës financiare, por ato që i përkasin kësaj periudhe.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë (15) në pasqyrën FI 7.2Q “Llogaria teknike e sigurimeve, Jo-Jetë”. Si edhe me totalin e vlerës në pasqyrën FI 12Q “Shpenzimet e marrjes në sigurim”.

VI - 2. Ndryshimi në shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim (+/-)

Në këtë zë përfshihet ndryshimi në zërin e bilancit (aktiv) “Shpenzime të shtyra të marrjes në sigurim”.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë (16) në pasqyrën FI 7.2Q “Llogaria teknike e sigurimeve, Jo - jetë”.

VI - 3. Shpenzime administrative

Në këtë zë përfshihen shpenzime të lidhura me mbledhjen e primeve, administrimin e portofoleve, bonuseve dhe rabateve, dhe të risigurimit (cedimit dhe risigurimit). Ky zë duhet të përfshijë në veçanti shpenzime të lidhura me stafin, shërbimet nga palët e treta, taksa dhe të ngjashme, shpenzimet e reklamave për shoqërinë në tërësi, amortizimin si dhe shpenzime të tjera administrative.

Në këtë zë do të përfshihen edhe shpenzimet e shoqërisë në lidhje me dëmet e shkaktuara nga personat e pasiguruar, pra dëmet që rrjedhin nga Fondi i Kompensimit, dhe të cilat nuk lidhen drejtpërdrejt me polica të shkruara nga shoqëria e sigurimit apo me policëmbajtës të kësaj shoqërie. Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë (17) në pasqyrën FI 7.2Q “Llogaria teknike e sigurimeve, Jo-Jetë” si edhe me vlerën e të njëjtit zë në pasqyrën FI 15Q “Shpenzimet administrative” (sipas nën zërave përkatës).

VI - 5. Komisione të risigurimit (-)

Në këtë zë përfshihen komisionet e risigurimit që shoqëritë e sigurimit (ceduese) marrin nga shoqëritë e risigurimit për biznesin që ato i sigurojnë këtyre të fundit. Ky zë shënohet me minus në pasqyrë pasi redukton shpenzimet neto operative.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë (19) në pasqyrën FI 7.2Q “Llogaria teknike e sigurimeve, Jo-Jetë”.

VII. Shpenzime të tjera neto për sigurimet (1+2)

VII - 1. Shpenzime për parandalimin e dëmeve

Në këtë zë përfshihen shpenzimet që i lindin shoqërisë së sigurimit nga kryerja e veprimtarisë së parandalimit të dëmeve si: punësimi i specialistëve dhe inxhinierëve për t’u rekomanduar bizneseve masa për parandalimin e humbjeve (nga zjarri, krimi apo risqe të tjera) si dhe masa për përmirësimin e sigurisë në ambientet e punës, si dhe kontribute për bizneset/shoqatat që promovojnë sigurinë në ambientet e punës/shtëpisë/rrugës/makinës.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë (22) në pasqyrën FI 7.2Q “Llogaria teknike e sigurimeve, Jo-Jetë”.

VII - 2. Shpenzime të tjera neto të sigurimeve

Në këtë zë përfshihen shpenzime të tjera që nuk janë përfshirë në zërat e mësipërm.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë (23) në pasqyrën FI 7.2Q “Llogaria teknike e sigurimeve, Jo-Jetë”.

VIII. Të ardhura të llogaritura nga investimet transferuar nga llogaria jo-teknike (+)

Të ardhura të llogaritura nga investime afatgjata të cilat kalohen nga llogaria jo teknike (XII-1 Të ardhura nga investimet) në atë teknike^[1].

Shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës mund të transferojnë një pjesë të të ardhurave nga investimet në llogarinë teknike. Një mënyrë llogaritje mund të jetë si raporti midis mesatares së provigjoneve teknike (neto) me shumën e mesatares së provigjoneve teknike (neto) dhe mesatares së shumës së kapitalit me detyrimet e varura.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë (25) në pasqyrën FI 7.2Q “Llogaria teknike e sigurimeve” për shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë.

^[1] Ky zë është i përfshirë në zërin XII – 1 Të ardhura nga investimet.

IX. Rezultati teknik (I+II-III+IV-V-VI-VII+VIII)

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë (26) në pasqyrën FI 7.2Q “Llogaria teknike e sigurimeve, Jo-Jetë”.

X. Ndryshimi në vlerën e drejtë nëpërmjet llogarisë Fitim/ Humbje

Në këtë zë përfshihen fitimet/humbjet e perealizuara nga instrumentat e kategorizuar si vlerë e drejtë nëpërmjet fitim/humbje (letra me vlerë të tregtueshme).

XI. Investime neto (1-2+3)

XI - 1. Të ardhura nga investimet (1.1+1.2+1.3+1.4+1.5+1.6)

Këtu përfshihen të ardhura nga portofoli i investimit përfshirë interesat e depozitave me afat dhe llogarive rrjedhëse, dividendët dhe fitimi i kapitalit të realizuara nga aksionet si dhe të ardhura nga qiradhënia e aktiveve materiale afatgjata që nuk përdoren për veprimtarinë direkte të shfrytëzimit. Nuk përfshihet vlera e aksioneve dhe letrave me vlerë të zotëruara nga shoqëria. Të ardhurat nga investimet i referohen totalit të aktiveve në grupin C "Investime në toka, ndërtesa dhe investime financiare".

XI - 2. Shpenzime për investime (2.1+2.2)

XI - 2.1. Amortizimi i aktiveve që nuk përdoren direkt në aktivitetin e sigurimit

Amortizimi i aktiveve materiale afatgjata - Toka Ndërtesa të cilat nuk përdoren për veprimtarinë direkte të shfrytëzimit.

XI - 2.2 . Interesa dhe shpenzime të tjera për investime

Shpenzime interesi për hua/financime nga të tretë si dhe shpenzime të tjera për investime.

XI - 3. Fitim / Humbje nga shitja e investimeve (3.1+3.2+3.3+3.4+3.5)

Fitime të realizuara nga shitja e investimeve të shoqërisë në aksione, letra borxhi, kredi hipotekare, pasuri të paluajtshme dhe të tjera.

XI - 3.1. Aksione

XI - 3.2. Letra borxhi

XI - 3.3. Kredi Hipotekore

XI - 3.4. Pasuri e paluajtshme

XI - 3.5. Të tjera

XII. Të ardhura të llogaritura nga investimet që transferohen në llogarinë teknike (-)

Këtu pasqyrohet zëri VIII me efekt të zbritshëm për të evituar llogaritjen e dyfishtë të tij (për sa kohë ai është i përfshirë njëkohësisht në zërin IX dhe në zërin XII - 1).

XIII. Të ardhura të tjera

Këtu përfshihet çdo lloj tjetër e ardhure dytësore, që nuk bën pjesë në grupet e mësipërme.

XIV. Fitim/Humbje të tjera nga investimet (+/-)

Në këtë zë përfshihen fitim humbjet mbi investimet financiare që kanë ardhur nga ndryshimet në kursin e këmbimit.

XV. Të Ardhura të Jashtëzakonshme¹³

Në këtë zë përfshihen të ardhura që shkaktohen nga ngjarje të jashtëzakonshme, që ndodhin rrallë dhe kanë materialitet. Këto të ardhura nuk janë pjesë e veprimtarisë së sigurimit (të shfrytëzimit) të shoqërisë dhe nuk janë të pritshme të ripërsëriten në të ardhmen.

XVI. Shpenzime të jashtëzakonshme¹⁴

Në këtë zë përfshihen shpenzime që shkaktohen nga ngjarje të jashtëzakonshme, që ndodhin rrallë dhe kanë materialitet. Këto shpenzime nuk janë pjesë e veprimtarisë së sigurimit (të shfrytëzimit) të shoqërisë dhe nuk janë të pritshme të ripërsëriten në të ardhmen.

XVII. Fitimi/(humbja) para tatimit (IX+X+XI-XII+XIII+XIV+XV-XVI)

Ky zë përfaqëson fitimin ose humbjen e periudhës përpara zbritjes së shpenzimit tatimor.

XVIII. Tatimi mbi fitimin

Në këtë zë vendoset shpenzimi tatimor (e ardhura tatimore) në përputhje me legjislacionin në fuqi të vendit.

XIX. Fitime (humbje) neto për periudhën (XVII-XVIII)

Ky zë përfaqëson fitimin ose humbjen e periudhës pas zbritjes së shpenzimit tatimor.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me të njëjtin zë (A-VII) në pasqyrën FI 2Q “Bilanci - Pasivi”.

¹³ Duke qenë se SNRF nuk e njeh këtë lloj të ardhure, plotësimi nuk është i nevojshëm për sa kohë që baza rregullative pranon vlerësimin e pasqyrave financiare pranë rregullatorit sipas SNRF.

¹⁴ Duke qenë se SNRF nuk e njeh këtë lloj të ardhure, plotësimi nuk është i nevojshëm për sa kohë që baza rregullative pranon vlerësimin e pasqyrave financiare pranë rregullatorit sipas SNRF.

FI 4Q: Llogaria Fitim / Humbje, Jetë

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve kur shoqëria e sigurimit ushtron veprimtari sigurimi për klasat e sigurimit të jetës do të ketë strukturën e mëposhtme:

- I. Prime të Fituara Neto;
- II. Investime Neto;
- III. Rritja në vlerën e drejtë (fair value) nëpërmjet llogarisë Fitim/Humbje;
- IV. Të ardhura të tjera teknike neto nga veprimtaria e sigurimeve;
- V. Shpenzime neto për dëme të paguara;
- VI. Ndryshimi në provigjonet e tjera teknike;
- VII. Shpenzime neto për bonuse dhe rabate duke përfshirë ndryshimin në provigjone - neto pa risigurimin;
- VIII. Shpenzime operative neto të veprimtarisë;
- IX. Shpenzime të tjera neto për sigurimet;
- X. Të ardhura neto nga investimet duke përfshirë kostot, të transferuara në llogarinë fitim/humbje;
- XI. Rezultati teknik;
- XII. Të ardhura neto nga investimet duke përfshirë kostot, të transferuara nga llogaria teknike e sigurimit të jetës;
- XIII. Të ardhura të tjera;
- XIV. Shpenzime të tjera;
- XV. Fitime / humbje të përcaktuara nga investimet e tjera;
- XVI. Të ardhura të jashtëzakonshme;
- XVII. Shpenzime të jashtëzakonshme;
- XVIII. Fitime / Humbje para tatimit;
- XIX. Tatimi mbi fitimin;
- XX. Fitime/Humbje neto për periudhën.

I. Prime të Fituara neto (1+2+3+4)

Këtu përfshihen të ardhurat nga primet e sigurimit bruto të korigjuara me primet e paguara për risigurime, me ndryshimin e provigjoneve (rezervave) për primet bruto dhe me ndryshimet në provigjonet (rezervat) e primit të risigurimit.

I - 1. Prime të shkruara bruto

Këtu përfshihen të gjitha primet sipas kontratave të sigurimit, pavarësisht nëse këto shuma janë të lidhura tërësisht ose pjesërisht me vitin financiar të mëvonshëm. Primet e shkruara do të përfshijnë:

- Primet akoma të shkruara ku llogaritja e primit mund të bëhet vetëm në fund të vitit;
- Primet e vetme (single premiums), këstet e anuitetit,
- Primet shtesë, në rastet e arkëtimit me këste mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe primet shtesë nga policëmbajtësit për shpenzimet e lindura nga veprimtaria siguruese.
- Në rastet e bashkësigurimit, pjesa që i takon secilit bashkësigurues në totalin e primeve;
- Primet e risigurimit nga cedimi dhe ritocedimi i shoqërive të sigurimit, duke përfshirë portofolin e risqeve të paskaduara dhe primeve të pafituara;
- Pasi janë zbritur;
- Tërheqjet në lidhje me primet e pafituara dhe risqet e paskaduara të kthyer nga cedimi dhe

ritrocedimi i shoqërive të sigurimit dhe/ose risigurimit;

- Anulimet.

Shumat e mësipërme nuk do të përfshijnë taksat ose shpenzimet të arkëtuara së bashku me primet për llogari të të tretëve.

Në ndryshim me kontratat e sigurimit të jetës afatgjata (long term insurance contracts), kontratat e sigurimit afatgjata me DPF (discrete participation feature) dhe kontratat e investimit me DPF, ku primi i shkruar do të njihet si e ardhur në momentin që lind detyrimi nga policëmbajtësi, primi që lind nga kontratat e investimit pa DPF (investment contracts without discretionary participation feature-unit linked product) nuk do të konsiderohet si e ardhur, por si detyrim financiar. Vlera e drejtë e këtyre kontratave ndryshon në varësi të aktiveve financiare përkatëse. Këto përcaktohen që në fillim si me vlerë të drejtë përmes fitim/humbjes.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë (02) në pasqyrën FI 8A “Llogaria teknike e sigurimeve, Jetë”.

I – 2. Prime të ceduara në risigurim (-)

Primet e ceduara në risigurim përfshijnë të gjitha primet e paguara ose të pagueshme që i takojnë kontratave të risigurimit që shoqëria ka nënshkruar. Këtu do të përfshihen edhe primet e pafituara dhe risqet e paskaduara të pagueshme me mbylljen e kontratës së sigurimit ose me ndryshimet që mund t'i bëhen kontratës së risigurimit.

Nga këto duhet të zbriten tërheqjet që kanë të bëjnë me primet e pafituara dhe risqet e paskaduara të marra nga shoqëria e sigurimit.

I – 3. Ndryshimi në provigjoniin e primeve të pafituara bruto (+/-)

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me diferencën e vlerës së zërit C - I “provigjoni për primet e pafituara bruto” (Bilanc – Pasivi), në datën e raportimit me vlerën me 31 Dhjetor të vitit paraardhës, (por me shenjë të kundërt).

II. Investime Neto

Ky zë përfshin vlerën e plotë të të ardhurave financiare që rrjedhin nga totali i aktiveve të shoqërisë së sigurimit, neto nga shpenzimet korresponduese por bruto nga risigurimi. Të ardhurat nga investimet i referohen totalit të të ardhurave që gjenerohen nga aktivet në grupin C "Investime në toka, ndërtesa dhe investime financiare" të aktivit të bilancit, përmendim këtu: interesat, dividendët dhe fitimin e kapitalit të realizuara nga aksionet, të ardhurat nga interesi nga aktivet financiare të klasifikuara me vlerë të drejtë përmes fitim/humbjes, të ardhura nga qiradhënia e aktiveve materiale afatgjata që nuk përdoren për veprimtarinë direkte të shfrytëzimit por janë të mbajtura për qëllime investimi, të gjitha këto neto nga shpenzimet e investimeve dhe interesat e pagueshme. Kjo nënkupton që vlerat e treguara në këtë zë përfshijnë: Të ardhurat e siguruara nga investimi i provigjoneve teknike, ashtu edhe nga investimi i fondeve të shoqërisë. Fitimet/ humbjet e përfshihen nga ato aktive që përfaqësojnë provigjonet teknike që u përkasin kontratave të sigurimit të lidhura me fonde investimi (Unit Linked and Dedicated Fund Products) duhet të përfshihen gjithmonë në këtë zë. Pavarësisht nga ndarja sipas klasave të sigurimit dhe vendit në të cilin ndodhet rreziku të ardhurat nga investimet neto ndahen në dy mënyra: a) Sipas kategorisë në përputhje me territorin ku gjendet rreziku (edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë). Në përputhje me parimet e regjistrimit të shpenzimeve sipas qëllimit në shpenzimet për investime do të përfshihen edhe shpenzimet e brendshme administrative që kryhen për menaxhimin e

investimeve. b) Sipas burimit në përputhje me pasqyrën e "Llogarisë së kalimeve në risigurim", kjo ndarje përfshin shumat që lidhen me aktivet që sigurojnë të ardhura financiare.

Të ardhurat nga investimi do të ndahen në të ardhura nga investimi që do të përfshihen në rezultatin teknik (zëri XI) dhe të ardhura nga investimi që do të përfshihen në pjesën joteknike të rezultatit financiar të shoqërisë së jetës. Do të bëhet një ndarje midis aktiveve/ investimeve që shërbejnë për mbulimin e Provigjoneve Teknike/Matematike dhe aktiveve që financohen tërësisht nga fondet e aksionarëve. Në zërin II 'Investimet neto' (që përfshihet në përllogaritjen e rezultatit teknik të pasqyrës fitim/humbjes jetë) do të përfshihen të ardhurat nga ato investime që shërbejnë për mbulimin e provigjoneve teknike e matematike (mënyra e përllogaritjes është shpjeguar në zërin "Të ardhura neto nga investimet duke përfshirë kostot, të transferuara nga llogaria teknike e sigurimit të Jetës").

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë (06) në pasqyrën FI 8A "Llogaria teknike e sigurimeve, Jetë".

II – 1. Të ardhurat nga investimet (1.1+1.2+1.3+1.4+1.5+1.6)

Këtu përfshihen të ardhura nga portofoli i investimit përfshirë interesat, dividendët dhe fitimi i kapitalit të realizuara nga aksionet si dhe të ardhura nga qiradhënia e aktiveve materiale afatgjata që nuk përdoren për veprimtarinë direkte të shfrytëzimit.

II – 1 – 1.1. Aksione

II – 1 – 1.2. Letra borxhi

II – 1 – 1.3. Kredi Hipotekore

II – 1 – 1.4. Pasuri e paluajtshme

II – 1 – 1.5. Të ardhura nga interesat

II – 1 – 1.6. Të ardhura të tjera nga investimet

II – 2. Shpenzime për investime (2.1+2.2)

II – 2 – 2.1. Amortizimi i aktiveve që nuk përdoren direkt në aktivitetin e sigurimit

Amortizimi i aktiveve materiale afatgjata - Toka Ndërtesa të cilat nuk përdoren për veprimtarinë direkte të shfrytëzimit.

II – 2 – 2.2. Interesa dhe shpenzime të tjera të investimeve

Shpenzime interesi për hua/financime nga të tretë si dhe shpenzime të tjera për investime.

II – 3. Fitim / Humbje nga shitja e investimeve (3.1+3.2+3.3+3.4+3.5)

Në këtë zë përfshihen fitimet/humbjet e realizuara nga shitja e aksioneve, letrave të borxhit, kredive hipotekore, pasurive të paluajtshme etj.

II – 3 – 3.1. Aksione

II – 3 – 3.2. Letra borxhi

II – 3 – 3.3. Kredi Hipotekore

II – 3 – 3.4. Pasuri e paluajtshme

II – 3 – 3.5. Të tjera

III. Rritja në vlerën e drejtë (fair value) nëpërmjet llogarisë Fitim/Humbje;

Në këtë zë përfshihen fitimet/humbjet e parealizuara nga instrumentat e kategorizuar si vlerë e drejtë nëpërmjet fitim/humbje (letra me vlerë të tregtueshme).

IV. Të ardhura të tjera teknike neto nga veprimtaria e sigurimeve;

Të ardhura të tjera teknike neto nga veprimtaria e sigurimeve do të përfshijë të ardhurat teknike që nuk mund të përfshihen në zërat e tjerë. Këtu përfshihen në veçanti:

- a. Të ardhura nga komisionet si për shembull komisionet e largimit të parakohshëm (ang. surrender charges);
- b. Të ardhura nga komisionet e menaxhimit të investimeve që lidhen me kontratat e investimeve (ang. unit linked policies);
- c. Bonuse dhe rabate të cilat nuk janë arkëtuar nga policëmbajtësit dhe janë ndaluar me kalimin e kohës; Të ardhura nga rritja në dëmet e kapitalizuara të policëmbajtësve të cilat ende nuk duhen paguar (ang. capitalised claims on policyholders not yet due). Pjesa e risiguruesit duhet të zbritet nga të ardhurat e mësipërme.

V. Shpenzime neto për dëme të paguara;

V – 1 Dëme të paguara bruto

Dëme të paguara bruto përfshijnë vlerën e përfitimeve paguar përfituesit gjatë periudhës kontabël, që lidhen me ngjarje të siguruara që kanë ndodhur gjatë periudhës kontabël ose në periudhat e mëparshme.

Përfitimet mund të jenë diskretë (të paguarantuar) si dividendë dhe bonuse të pagueshme çdo vit ndaj policëmbajtësve të policave të jetës me elementë kursimi, ose bonuse të pagueshme në maturimin e policës ose vdekjen e policëmbajtësit. Dëmet janë të dy tipeve: a) Dëme nga maturimi i policave me elementë kursimi, dhe b) Dëme si pasojë e vdekjes të të sigurvearit. Shuma e dëmit që i paguhet policëmbajtësit varion nga lloji i policës së shkruar dhe veçanërisht nëse është me fitim ose jo:

1. Polica pa fitim
Përfitimi i vetëm i policëmbajtësit është pagesa e shumës së sigurvearit. Kjo shumë përcaktohet nga kushtet fillestare të policës.

2. Policat me fitim

Ky term përdoret për ato polica ku policëmbajtësit kanë të drejtë të marrin pjesë në tepricat e përcaktuara. Pra vlera e dëmit varet nga disa faktorë:

1. Performanca e investimit;
2. Shpenzimet;
3. Eksperienca e vdekshmërisë;
4. Anulimet dhe heqjet dorë nga kontratat e sigurimit; dhe
5. Taksat.

Policëmbajtësi mbart kështu riskun e investimit por edhe potencialin për kthim të investimit dhe vetëm një pjesë e vogël e dëmit përfaqësohet nga një shumë e garantuar.

Dëmet e paguara bruto duhet të përfshijnë pagesat e anuiteteve, heqjet dorë nga kontratat e sigurimit dhe rimbursimet e paguara, si dhe shpenzimet e brendshme dhe të jashtme të trajtimit të dëmeve.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë (13) në pasqyrën FI 8A “Llogaria

teknike e sigurimeve, Jetë”.

V – 2. Dëme të paguara nga risiguruesit (-)

Pjesa nga “totali i dëmeve të paguara bruto” që është paguar nga risiguruesi në varësi të kontratës së risigurimit.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë (14) në pasqyrën FI 8A “Llogaria teknike e sigurimeve, Jetë”.

V – 3. Ndryshimi në provigjonin e dëmeve, bruto (+/-)

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me diferencën e vlerës në zërin e Bilancit – Pasivi, C- “provigjoni për dëme”, në datën e raportimit me vlerën më 31 dhjetor të vitit paraardhës.

V – 4. Ndryshimi në provigjonin e dëmeve, pjesa e risiguruesve (+/-)

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me diferencën e vlerës në zërin e Bilancit – Aktivi, F – II “provigjone të dëmeve”, në datën e raportimit me vlerën më 31 dhjetor të vitit paraardhës, por me shenjë të kundërt.

VI. Ndryshimi në provigjonet e tjera teknike;

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me shumën e tre nënzhërave të mëposhtëm VI. 1, VI. 2, dhe VI.3.

VI – 1. Ndryshimi në provigjonet e sigurimit të Jetës - neto pa risigurimin

VI – 2. Ndryshimi në provigjonet e sigurimit të Jetës - neto pa risigurimin, ku policëmbajtësi mbart riskun e investimit

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me diferencën e vlerës në zërin e Bilancit – Pasiv, D “Provigjone teknike për llogari të policëmbajtësve të sigurimit të jetës që mbajnë riskun e investimit”, në datën e raportimit me vlerën më 31 dhjetor të vitit paraardhës.

VI – 3. Ndryshimi në provigjone të tjera teknike - neto pa risigurimin

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me diferencën e vlerës në zërin e Bilancit – Pasiv, C “Provigjone të tjera teknike”, në datën e raportimit me vlerën më 31 dhjetor të vitit paraardhës.

VII. Shpenzime neto për bonuse dhe rabate duke përfshirë ndryshimin në provigjone - neto pa risigurimin;

1. Shpenzimet për bonuse në sigurimin e jetës dhe sigurimin e shëndetit duhet të përfshijnë të gjitha shtesat në provigjonet për bonuse.
2. Nëse bonuset dhe rabatet e paguara për policëmbajtësit janë domethënëse, ato duhet të shpjegohen të ndara në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Zakonisht ka dy tipe bonusesh që u jepen policëmbajtësve të ‘policave me fitim’: bonuse të kthyeshme (ang. reversionary) dhe bonuse përfundimtare (ang. terminal).

Bonuset e kthyeshme zakonisht deklarohen çdo vit, gjatë jetës së policës, normalisht si një pjesë e shumës së siguruar (bonuse të kthyeshme të thjeshta) ose si pjesë e shumës së siguruar dhe bonuseve të deklaruar më parë (bonuse të kthyeshme komplekse). Këto bonuse rrisin të drejtën e policëmbajtësit për dëmshpërblim por paguhen në të vërtetë vetëm kur lind detyrimi.

Bonuset përfundimtare paguhen së bashku me shpërblimet e zakonshme dhe shpërndahen vetëm me dëmet e lindura nga vdekja ose maturimi i policës.

Disa polica sigurimi përfshijnë dhe të ashtuquajturat “bonuse të garantuara”, të cilat përbëjnë një pjesë të detyrimeve kontraktuale që lejohen në përcaktimin e primit origjinal dhe nuk konsiderohen në mënyrë rigoroze bonuse.

Këto pagesa shtesë për policëmbajtësin zakonisht përfaqësojnë rimbursimet e primeve kur këto kanë qenë të vendosura në nivele më të larta se ato që kërkohen për të mbuluar shpenzimet e pritura dhe dëmet (rabate).

VIII. Shpenzime operative neto të veprimtarisë;

VIII – 1. Shpenzime të marrjes në sigurim

Ky zë përfshin shpenzimet e drejtpërdrejta, siç janë shpenzimet për lëshimin e policave të sigurimit, si dhe shpenzimet indirekte të tilla si kostot e reklamimit ose shpenzimet administrative të lidhura me përpunimin e kërkesave dhe lëshimin e policave të sigurimit.

“Do të klasifikohen si shpenzime të marrjes në sigurim ato shpenzime që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me marrjen e suksesshme në sigurim të policave të reja ose me rinovimin e kontratave të sigurimit ekzistuese.”

VIII – 2. Ndryshimi në shpenzime të shtyra të marrjes në sigurim (+/-)

Në këtë zë përfshihet ndryshimi në zërin e bilancit (aktiv) “Shpenzime të shtyra të marrjes në sigurim”.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë (21) në pasqyrën FI 8A “Llogaria teknike e sigurimeve, Jetë” si dhe me ndryshimin e zërit K-II-(Bilanci-Aktiv) ‘Shpenzime të marrjes në sigurim të shtyra’, në datën e raportimit me vlerën me 31 dhjetor të vitit paraardhës.

VIII – 3. Shpenzime administrative

Në këtë zë përfshihen shpenzime të lidhura me mbledhjen e primeve, administrimin e portofolave, bonuseve dhe rabateve, dhe të risigurimit (cedimit dhe risigurimit). Ky zë duhet të përfshijë në veçanti shpenzime të lidhura me stafin, shërbimet nga palët e treta, taksa dhe të ngjashme, shpenzimet e reklamave për shoqërinë në tërësi, amortizimin si dhe shpenzime të tjera administrative.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë (22) në pasqyrën FI 8A “Llogaria teknike e sigurimeve, Jetë” si edhe me vlerën e të njëjtit zë në pasqyrën FI 15Q “Shpenzimet administrative” (sipas nën zërave përkatës, për shoqëritë që ushtrojnë vetëm veprimtari sigurimi për klasat e Jetës).

VIII – 4. Shpenzime të tjera operative

Në këtë zë përfshihen shpenzime të tjera që nuk janë përfshirë në zërat e mësipërm.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë (25) në pasqyrën FI 8A

“Llogaria teknike e sigurimeve, Jetë”.

VIII – 5. Komisione të risigurimit (-)

Në këtë zë përfshihen komisionet e risigurimit që shoqëritë e sigurimit (ceduese) marrin nga shoqëritë e risigurimit për biznesin që ato i sigurojnë këtyre të fundit. Ky zë shënohet me minus në pasqyrë pasi redukton shpenzimet neto operative.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë (24) në pasqyrën FI 8A “Llogaria teknike e sigurimeve, Jetë”.

IX. Shpenzime të tjera neto për sigurimet (1+2)

IX – 1. Shpenzime për parandalimin e dëmeve

Në këtë zë përfshihen shpenzimet që i lindin shoqërisë së sigurimit nga kryerja e veprimtarisë së parandalimit të dëmeve si: punësimi i specialistëve për t’u rekomanduar përfituesve masa për parandalimin e humbjeve nga risqe të mundshme përmendim këtu shpenzime për analizimin e kushteve në vendin e punës që mund të rezultojnë në plagosje të përfituesit etj.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë (22) në pasqyrën FI 8A “Llogaria teknike e sigurimeve, Jetë”.

IX – 2. Shpenzime të tjera neto të sigurimeve

X. Të ardhura neto nga investimet duke përfshirë kostot, të transferuara në llogarinë fitim/humbje;

Këtu pasqyrohet zëri XII me efekt të zbritshëm për të evituar llogaritjen e dyfishtë të tij (për sa kohë ai është i përfshirë njëkohësisht në zërin II dhe në zërin XII).

XI. Rezultati teknik;

XII. Të ardhura neto nga investimet duke përfshirë kostot, të transferuara nga llogaria teknike e sigurimit të jetës;

Shoqëria e sigurimit e cila kryen aktivitetin e jetës përcakton pjesën e të ardhurave nga investimet që do të transferohet nga llogaria teknike.

Pjesa që do të transferohet nga llogaria teknike llogaritet si raporti midis mesatares së shumës së kapitalit me detyrimet e varura dhe shumës së mesatares së provigjoneve teknike (neto) dhe mesatares së shumës së kapitalit me detyrimet e varura.

Nëqoftëse të ardhurat nga investimet që mbetet në pjesën e llogarisë teknike rezulton me e ulët se të ardhurat nga investimet që i njihen të siguruarve me kontratë, pjesa e të ardhurave nga investimet që do të transferohet duhet të ulet deri në anulimin e saj.

XIII. Të ardhura të tjera;

Këtu përfshihet çdo lloj tjetër e ardhure dytësore, që nuk bën pjesë në grupet e mësipërme.

XIV. Shpenzime të tjera;

Këtu përfshihet çdo lloj tjetër shpenzimi dytësor, që nuk bën pjesë në grupet e mësipërme.

XV. Fitime / humbje të parealizuara nga investimet e tjera;

Në këtë zë përfshihen fitim humbjet e parealizuara nga investimet financiare të policave të sigurimit të jetës, për të cilat riskun e investimit e mbart policëmbajtësi (zëri E në Aktiv-Bilanci).

XVI. Të ardhura të jashtëzakonshme;

Në këtë zë përfshihen të ardhura që shkaktohen nga ngjarje të jashtëzakonshme, që ndodhin rrallë dhe kanë materialitet. Këto të ardhura nuk janë pjesë e veprimtarisë së sigurimit (të shfrytëzimit) të shoqërisë dhe nuk janë të pritshme të ripërsëriten në të ardhmen.

XVII. Shpenzime të jashtëzakonshme;

Në këtë zë përfshihen shpenzime që shkaktohen nga ngjarje të jashtëzakonshme, që ndodhin rrallë dhe kanë materialitet. Këto shpenzime nuk janë pjesë e veprimtarisë së sigurimit (të shfrytëzimit) të shoqërisë dhe nuk janë të pritshme të ripërsëriten në të ardhmen.

XVIII. Fitime / Humbje paratatimit;

XIX. Tatimi mbi fitimin;

XX. Fitime / Humbje neto për periudhën.

FI 5Q: Pasqyra e Fluksit të Parave

Pasqyra e fluksit të parave do të ketë strukturën e mëposhtme:

- A. – Fluksi monetar nga veprimtaria direkte e shfrytëzimit;
- B. – Fluksi monetar nga aktiviteti i investimit;
- C. – Fluksi monetar nga aktiviteti i financimit.

Me anën e kësaj pasqyre kontrollohet fluksi i parave (CASH), arkëtimet dhe pagesat e mjeteve monetare në shoqërinë e sigurimit, arkëtime nga investimet dhe financimi

Hyrjet përfshijnë arkëtimet nga primet e sigurimit përfshirë dhe pjesën e risiguruesit, arkëtimet nga burime të tjera të veprimtarisë së sigurimit, arkëtime nga investimet dhe arkëtime nga aktiviteti i financimit.

Daljet përfshijnë pagesat për dëmet përfshirë dhe pjesën e risiguruesit në dëme, pagesat për komisione, pagesat për shpenzime administrative, pagesa për dividendë, pagesat për kalimin në investime etj.

A. Flukse monetare nga veprimtaria direkte e shfrytëzimit (I - II)

A - I. Arkëtime (1+2+3)

A – I - 1. Arkëtime nga veprimtaria direkte e sigurimit dhe/ose e risigurimit (1.1+1.2+1.3)

A – I – 1.1. Arkëtime nga prime të shkruara bruto

Shumat e primeve të arkëtuara në vitin financiar (nga arkëtimet e policave prerë gjatë vitit financiar aktual dhe/ose nga reduktimi i zërit ‘të arkëtueshme nga policëmbajtësit/agjentë’) nga shoqëria e sigurimit duke përfshirë pjesën e primit të arkëtuar që do cedohet në risigurim.

A – I – 1.2. Arkëtime nga rekursët, rimarrjet dhe dëme të kthyer

Arkëtime që vijnë nga proceset e rekurseve, rimarrjeve dhe kthimit të dëmeve. Këto mund të konsistojnë në rimbursime nga shoqëritë apo persona të tjerë për dëme të cilat janë paguar tashmë (subrogimi), apo pjesë të shpëtuar (salvage value) nga pasuri të marra nga i siguruari si pjesë e marrëveshjes së dëmshpërblimit.

A – I – 2. Arkëtime nga risiguruesi (nga veprimtaria ceduese) (2.1+2.2+2.3)

A – I – 2.1. Arkëtime nga risiguruesi për pjesën e tij në pagesën e dëmit

Shumat aktuale që risiguruesi ka paguar në rastet e ndodhjes së dëmeve dhe/ose nga marrja e ‘të arkëtueshme-ve nga risiguruesi’, sipas marrëveshjes kontraktuale të risigurimit, të cilat janë përgjegjësi e risiguruesit.

A – I – 2.2. Arkëtime nga komisionet e risiguruesit dhe pjesëmarrja në fitim

Arkëtimet e marra nga shoqëria e risigurimit për komisionet në përputhje me marrëveshjen e risigurimit, si një kompensim për shpenzimet e marrjes në sigurim. Arkëtimet e marra nga shoqëria risiguruese për pjesëmarrjen në fitim, e cila është ajo pjesë e fitimit të risiguruesit (shprehur si përqindje), që sipas marrëveshjes, i paguhet siguruesit mbasi janë paguar komisioni i risigurimit dhe shpenzimet e tjera përfshirë dëmet.

A – I – 3. Arkëtime të tjera nga veprimtaria direkte e shfrytëzimit (3.1+3.2+3.3)

A – I – 3.1. Arkëtime nga aktivitete të vlerësimit të dëmeve.

Arkëtime që vijnë si rezultat i ushtrimit të aktivitetit të vlerësimit të dëmeve nga shoqëria e sigurimit për llogari të palëve të treta.

A – I – 3.2. Arkëtime nga shitja e aktiveve jo-materiale dhe/ose e aktiveve afatgjata materiale të ndryshme nga Toka Ndërtesa.

Arkëtime nga shitja e aktiveve jo-materiale dhe/ose e aktiveve afatgjata materiale të ndryshme nga Toka Ndërtesa.

A - II. Pagesa (1+2+3)

A – II – 1. Pagesa për veprimtarinë direkte të sigurimit dhe/ose të risigurimit (1.1 + 1.2 + 1.3 + 1.4 + 1.5 + 1.6 + 1.7)

A – II – 1.1. Pagesa për kthime të primeve të shkruara bruto

Pagesa për kthimin e primeve të shkruara bruto policëmbajtesve si rezultat i anulimit të kontratës, rregullimit të normës apo rillogaritjes së primeve (në rastet kur primet e paguara janë më të mëdha se primi aktual).

A – II – 1.2. Pagesa për dëmet

Pagesat e bëra nga shoqëria për dëmshpërblimet ndaj të siguruarve, përfshirë dhe pjesën e dëmit mbuluar nga risigurve. Këto pagesa do të pasqyrohen neto, d.m.th. nuk do të përfshihen pagesat e tjera që lidhen me dëmet si p.sh. trajtim dëmi, ekspertizë etj. (këto zëra përfshihen më poshtë në zërin A-II-1.5).

A – II – 1.3. Pagesa për shpenzime të marrjes në sigurim

Pagesat e kompanisë së sigurimit për shitjen e policave të sigurimit (marrjes në sigurim) që përfshijnë pagesat për përgatitjen e policës, për komisionet e ndërmjetësimit, për publikime, për marketing, për ekzaminime mjekësore, pagesat për rrjetin e shitjes, për përgatitjen e ofertave për çmimin, pagesat për lëshimin e policës, komisionet e rinovimit të kontratave të sigurimit etj.

A – II – 1.4. Pagesa për shpenzime administrative

Pagesat operative të bëra nga shoqëria për mbarëvajtjen administrative. Këtu përfshihen pagesat lidhur me stafin, shërbimet nga palët e treta, taksa dhe të ngjashme, si dhe për shpenzime të tjera administrative.

A – II – 1.5. Pagesa për shpenzime mbi vlerësimin e dëmit dhe mbrojtje në ankimime

Të gjitha pagesat që bëhen nga shoqëria e sigurimit të lidhura me vlerësimin, regjistrimin e dëmit si dhe mbrojtjen në ankimimet mbi dëmshpërblimet, pa përfshire vlerën e dëmshpërblimit.

A – II – 1.6. Pagesa për komisione dhe pjesëmarrje në fitim të pagesave të bëra për risigurim (risigurime të shitura)

Pagesat e bëra nga shoqëria risiguruese për komisionet për shoqërinë ceduese (siguruesit primar) në përputhje me marrëveshjen e risigurimit, si një kompensim për shpenzimet e marrjes në sigurim. Pagesa e bërë nga shoqëria risiguruese për shoqërinë ceduese për pjesëmarrjen në fitim, e cila është ajo pjesë e fitimit të risiguruesit (shprehur si përqindje), që sipas marrëveshjes, i paguhet siguruesit mbasi janë paguar komisioni i risigurimit dhe shpenzimet e tjera përfshirë dëmet.

A – II - 2. Pagesa për risiguruesin (për veprimtarinë ceduese) (2.1+2.2)

A – II – 2.1. Pagesa për prime të ceduara

Pagesa e bërë për pjesën e primeve të shkruara të ceduara në risigurim si dhe për reduktimin e zërit 'të pagueshme për risiguruesin'.

A – II - 3. Të tjera pagesa për shpenzime të veprimtarisë direkte të shfrytëzimit(3.1+3.2+3.3)

A – II - 3.1. Shpenzime për vlerësimin e pavarur të dëmeve

Pagesat për komisionet e vlerësuesve të dëmeve (në rastin kur përcaktohet nga kontrata e sigurimit që ky komision paguhet nga siguruesi) që nuk janë të punësuar nga shoqëria e sigurimit por që kryejnë veprimtari si të vetëpunësuar.

A – II - 3.2. Blerje e aktiveve jo materiale ose materiale afatgjata të ndryshme nga Toka dhe ndërtesa

Pagesat e bëra për blerjen e aktiveve jo materiale ose materiale afatgjata të ndryshme nga Toka dhe ndërtesa.

A – II - 3.3. Pagesa të tjera

Të tjera pagesa që nuk janë përfshirë në zërat e mësipërm.

B. Flukse Monetare nga aktiviteti i investimit (I - II)

B - I. Arkëtime (1+2+3+4+5+6+7+8+9+10+11)

B – I - 1. Shitje e tokës dhe ndërtesave

Arkëtimet nga shitja e tokës dhe ndërtesave në pronësi të shoqërisë, përfshirë fitim/humbjet e realizuara nga shitja.

B – I - 2. Shitje e aksioneve në sipërmarrje ku shoqëria zotëron interes pjesëmarrës (mbi20%)

Arkëtime nga shitja e aksioneve në sipërmarrje ku shoqëria zotëron interes pjesëmarrës (mbi 20%).

B – I - 3. Shitje e aksioneve në sipërmarrje të tjera (nën 20%), si dhe njësi dhe certifikata investimi në fondet e investimit.

Arkëtime nga shitja e aksioneve në sipërmarrje të tjera (nën 20%), si dhe njësi dhe certifikata investimi në fondet e investimit.

B – I - 4. Maturimi i letrave të borxhit të emetuara nga sipërmarrje me interesa pjesëmarrës dhe ripagim i huave të dhëna këtyre sipërmarrjeve.

Arkëtime nga maturimi i letrave të borxhit të emetuara nga sipërmarrje me interes pjesëmarrës (mbi 20%) dhe ripagim i huave të dhëna këtyre sipërmarrjeve.

B – I - 5. Maturim i letrave të borxhit të emetuara nga sipërmarrje të tjera

Arkëtime nga maturimi i letrave të borxhit nga sipërmarrje të tjera (nën 20%).

B – I - 6. Mbyllje e depozitave në institucionet e kreditit

Përfshin arkëtimet (vetëm shumën e depozituar dhe jo interesin e përfituar të cilin e paraqesim më poshtë) nga maturimi ose mbyllja para kohe e depozitave me afat të shoqërisë në institucionet e kreditit (me afat maturimi mbi 3 muaj).

B – I - 8. Të ardhura dytësore nga toka dhe ndërtesa

Arkëtime nga pronësia mbi tokën, ndërtesa, si p.sh. qira.

B – I - 9. Interes i marrë

Interesa të marra nga maturimet e depozitave me afat, letrave të borxhit emetuar nga sipërmarrje të tjera dhe investimeve të tjera.

B – I - 10. Dividendët e marrë

Dividendët e arkëtuar nga sipërmarrjet në të cilat shoqëria e sigurimit zotëron aksione.

B - II. Pagesa (1+2+3+4+5+6+7+8+9)

B –II - 1. Blerje e tokës dhe ndërtesave

Pagesa për blerjen e tokës dhe ndërtesave.

B –II - 2. Blerje e aksioneve në sipërmarrje ku shoqëria zotëron interes pjesëmarrës (mbi 20%).

Pagesa për blerjen e aksioneve nga sipërmarrje ku shoqëria zotëron interes pjesëmarrës (mbi 20%).

B –II - 3. Blerje e aksioneve në sipërmarrje të tjera (nën 20%), si dhe njësi dhe certifikata investimi në fondet e investimit.

Pagesa për blerjen e aksioneve në sipërmarrje të tjera (nën 20%), si dhe njësi dhe certifikata investimi në fondet e investimit.

B –II - 4. Blerje e letrave të borxhit të emetuara nga sipërmarrje me interesa pjesëmarrës dhe dhënie e huave këtyre sipërmarrjeve.

Pagesa për blerjen e letrave të borxhit të emetuara nga sipërmarrjet ku shoqëria zotëron interes pjesëmarrës (mbi 20%) dhe dhënie e huave këtyre sipërmarrjeve.

B –II - 5. Blerje e letrave të borxhit të emetuara nga sipërmarrje të tjera

Përfshin çmimin e blerjes së letrave me vlerë emetuar nga sipërmarrje të tjera.

C. Flukse Monetare nga aktiviteti i Financimit (I - II)

C - I. Arkëtime (1+2+3)

C –I - 1. Arkëtime neto nga emetimi i kapitalit aksionar si dhe të ardhura shtesë mbi kapitalin.

Arkëtimet nga aksionet që shoqëria ka emetuar gjatë vitit financiar, qofshin këto aksione të zakonshme ose të preferuara përfshirë dhe arkëtime të tjera shtesë mbi kapitalin.

C –I - 2. Arkëtime nga huamarrje, kredi dhe emetimi i letrave të borxhit

Arkëtime (vlera nominale) nga huat dhe kreditë bankare të marra nga shoqëria e sigurimit si dhe arkëtimet nga emetimi i letrave të borxhit.

C - II. Pagesa (1+2+3+4+5+6)

C –II - 1. Dividendë

Pagesat e bëra për shpërndarjen e dividendëve të shoqërisë.

C –II - 2. Pagesa nga shpërndarja e fitimit e ndryshme nga dividendi

Pagesat e bëra për likuidimin e palëve të lidhura ose palëve të treta me anë të fitimit të shoqërisë.

C –II - 3. Blerje e aksioneve të veta

Pagesat e bëra për riblerjen e aksioneve të shoqërisë.

C –II - 4. Shlyerja e huave, kredive dhe letrave të borxhit të maturuar

Pagesat për shlyerjen e vlerës nominale (principalit) të kredive të marra (si ato të maturuara dhe ato pezull (outstanding) gjatë vitit financiar si dhe vlerën nominale të letrave të borxhit të emetuara nga shoqëria (nuk përfshihet interesi – përfshihet në zërin C – II -5).

C –II - 5. Interesa mbi kreditë, huat dhe letrat e borxhit të emetuara

Pagesa për interesin për kreditë/huat e marra dhe interesin e letrave të borxhit të emetuara nga shoqëria.

D. Fluksi Monetar Neto Total (A+B+C)

E. Mjete monetare në fillim të periudhës (mjete monetare në Aktivin e Bilancit të vitit paraardhës)

F. Mjete monetare në fund të periudhës (mjete monetare në Aktivin e Bilancit të vitit aktual)

FI 6Q: Llogaria Fitim / Humbje, Aktiviteti jashtë territorit të R.Sh.

- I. Prime të fituara neto
- II. Të ardhura të tjera teknike neto nga veprimtaria e sigurimeve
- III. Shpenzime neto për dëme të paguara
- IV. Ndryshimi në provigjonet e tjera teknike (+/-)
- V. Shpenzimet neto për bonuse dhe rabate
- VI. Shpenzime operative neto të veprimtarisë
- VII. Shpenzime të tjera teknike
- IX. Rezultati teknik (I+II+III+IV+V+VI+VII)
- X. Të ardhura neto nga investimet
- XI. Të ardhura të tjera
- XII. Fitime / Humbje të përealizuara nga investimet (+/-)
- XIII. Të ardhura të jashtëzakonshme
- XIV. Shpenzime të jashtëzakonshme
- XV. Fitime / Humbje para tatimit
- XVI. Tatim mbi fitimin
- XVII. Fitime / Humbje neto për periudhën (XV-XVI)

Kjo pasqyrë përmban të dhëna që kanë të bëjnë me të ardhurat dhe shpenzimet të analizuar për veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

I. Prime të fituara neto

Këtu përfshihen të ardhurat nga primet e sigurimit bruto të shkruara nga aktiviteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të korigjuara me pjesën e këtyre primeve të kaluara në risigurim, me ndryshimin e provigjoneve (rezervave) për këto prime të shkruara bruto dhe me ndryshimet në provigjonet (rezervat) e primit të kaluar në risigurim.

I.1. Prime të shkruara bruto

Këtu përfshihen primet e shkruara (vlerën totale të policës), sipas kontratës së sigurimit, të risigurimit ose të bashkësigurimit, në këtë rast për pjesën që i takon shoqërisë, nga aktiviteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilat bëhen efektive në vitin aktual financiar, pavarësisht nga arkëtimi i tyre. Ky zë përfshin primin e regjistruar në llogaritë e shoqërisë së sigurimit përpara zbritjes së komisioneve, shpenzimeve të marrjes në sigurim dhe primeve të ceduara në risigurim në aktivitetin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

I.2. Prime të ceduara në risigurim

Këtu regjistrohen vetëm primet e kaluara në risigurim që i takojnë aktivitetit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

I.3. Ndryshimi në provigjonin e primeve të pafituara bruto (+/-)

Në këtë zë regjistrohet vetëm ndryshimi i provigjoneve teknike të primeve të pafituara bruto që i takon përgjegjësisë të marra jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

I.4. Ndryshimi në provigjonin e primeve të pafituara, pjesa e risiguresve (+/-)

Në këtë zë regjistrohet vetëm ndryshimi i provigjoneve teknike të primeve të pafituara, pjesa e risiguresve që i takon përgjegjësisë të marra jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

II. Të ardhura të tjera teknike neto nga veprimtaria e sigurimeve

Ky zë përfshin të ardhura nga aktiviteti i brokerimit apo të ardhura nga aktiviteti i vlerësimit të dëmeve që mund të kryejë shoqëria e sigurimit në aktivitetin jashtë territorit për llogari të të tretëve. Në këtë zë do të përfshihet edhe vlera e rimbursimeve të dëmeve nga shkaktarët.

III. Shpenzime neto për dëme të paguara (1+2+3+4)

III.1. Dëme të paguara bruto

Në këtë zë përfshihet vlera monetare e kompensimit për dëmin e ndodhur dhe shpenzimet e trajtimit të dëmit që i përkasin këtyre dëmeve për polica të shitura nga aktiviteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Vlera e kompensimit për dëmin e ndodhur është shuma që përfitojnë personat e siguar në rastin e ndodhjes së dëmit, sipas rezultatit të raportit të vlerësimit.

III.2. Dëme të paguara nga risiguruesit (-)

Pjesa nga “totali i dëmeve të paguara bruto” për polica të shitura nga aktiviteti jashtë territorit e cila është paguar nga risiguruesi në varësi të kontratës së risigurimit.

III.3. Ndryshimi në provigjonin e dëmeve, bruto (+/-)

Në këtë zë regjistrohet vetëm ndryshimi në provigjonet teknike të dëmeve, bruto që i takon përgjegjësive të marra jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

III.4. Ndryshimi në provigjonin e dëmeve, pjesa e risiguruesve (+/-)

Në këtë zë regjistrohet vetëm ndryshimi në provigjonet teknike të dëmeve, pjesa e risiguruesit që i takon përgjegjësive të marra jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

IV. Ndryshimi në provigjonet e tjera teknike (+/-)

Në këtë zë regjistrohet vetëm ndryshimi në provigjonet e tjera teknike që i takon përgjegjësive të marra jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

V. Shpenzimet neto për bonuse dhe rabate

Në këtë zë përfshihen shpenzime për bonuset dhe/ose rabatet që i ofrohen policëmbajtësve të policave të shitura nga aktiviteti jashtë territorit në varësi të kushteve të kontratës duke zbritur pjesën që i takon risiguruesit në këto shpenzime.

VI. Shpenzime operative neto të veprimtarisë (1+2+3+4+5)

VI.1. Shpenzime të marrjes në sigurim

Në këtë zë regjistrohen shpenzimet e marrjes në sigurim të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si komisionet e paguara agjentëve (ndërmjetësve) të marrjes në sigurim dhe risigurim, pagat e rrjetit të shitjes, shpenzime lidhur me procesin e vlerësimit të riskut të sigurimit, dhe shpenzime indirekte, siç janë: shpenzimet e reklamave dhe promovimeve të produkteve të sigurimit si dhe shpenzime të përgjithshme të lidhura me verifikimin e aplikimeve dhe lëshimin e policave. Shpenzimet e marrjes në sigurim duhet të përfshijnë dhe komisionet për rinovimin e kontratave të sigurimit të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Shpenzimet e marrjes në sigurim për aktivitetin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të përfshira në këtë zë nuk janë ato të arkëtuara gjatë periudhës financiare, por ato që i përkasin kësaj periudhe.

VI.2. Ndryshimi në shpenzime të shtyra të marrjes në sigurim (+/-)

VI.3. Shpenzime administrative

Në këtë zë përfshihen shpenzime të lidhura me mbledhjen e primeve, administrimin e portofolave, bonuseve dhe rabateve, dhe të risigurimit (cedimit dhe risigurimit) të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ky zë duhet të përfshijë në veçanti shpenzime të lidhura me stafin, shërbimet nga palët e treta, taksa dhe të ngjashme, amortizimin si dhe shpenzime të tjera administrative të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

VI.4. Shpenzime të tjera operative

Në këtë zë përfshihen të gjithë shpenzimet e tjera operative të kryera për vitin financiar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

VI.5. Komisione të risigurimit (-)

Në këtë zë përfshihen komisionet e risigurimit që shoqëritë e sigurimit (ceduese) marrin nga shoqëritë e risigurimit për biznesin që ato i sigurojnë këtyre të fundit në aktivitetin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ky zë shënohet me minus në pasqyrë pasi redukton shpenzimet neto operative.

VII. Shpenzime të tjera teknike

Në këtë zë përfshihen shpenzime të tjera të kryera për vitin financiar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të cilat nuk janë përfshirë në zërat e mësipërm.

IX. Rezultati teknik (I+II-III+IV-V-VI-VII)

X. Të ardhura neto nga investimet (1-2+3)

X.1. Të ardhura nga investimet

Këtu përfshihen të ardhura nga portofoli i investimit përfshirë interesat, dividendët dhe fitimi i kapitalit të realizuara nga aksionet si dhe të ardhura nga qiradhënia e aktiveve materiale afatgjata që nuk përdoren për veprimtarinë direkte të shfrytëzimit të realizuara në aktivitetin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

X.2. Shpenzime për investime

Këtu përfshihen të gjitha shpenzimet për investime të cilat janë kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

X.3. Fitime /Humbje nga shitja e investimeve (+/-)

Në këtë zë përfshihen fitim humbjet mbi investimet financiare që kanë ardhur nga shitja e investimeve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

XI. Të ardhura të tjera

Këtu përfshihet çdo lloj tjetër e ardhure dytësore e realizuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, e cila nuk bën pjesë në grupet e mësipërme.

XII. Fitime/ Humbje të porealizuara nga investimet (+/-)

Në këtë zë përfshihen fitimet/humbjet e porealizuara në aktivitetin jashtë Republikës së Shqipërisë, nga instrumentat e kategorizuar si vlerë e drejtë nëpërmjet fitim/humbje (letra me vlerë të tregtueshme).

XIII. Të ardhura të jashtëzakonshme

Në këtë zë përfshihen të ardhura të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilat shkaktohen nga ngjarje të jashtëzakonshme, që ndodhin rrallë dhe kanë materialitet. Këto të ardhura nuk janë pjesë e veprimtarisë së sigurimit (të shfrytëzimit) të shoqërisë dhe nuk janë të pritshme të ripërsëriten në të ardhmen.

XIV. Shpenzime të jashtëzakonshme

Në këtë zë përfshihen shpenzime të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilat shkaktohen nga ngjarje të jashtëzakonshme, që ndodhin rrallë dhe kanë materialitet. Këto shpenzime nuk janë pjesë e veprimtarisë së sigurimit (të shfrytëzimit) të shoqërisë dhe nuk janë të pritshme të ripërsëriten në të ardhmen.

XV. Fitime / Humbje para tatimit (IX+X+XI+XII+XIII-XIV)

XVI. Tatimi mbi fitimin

XII. Fitime / Humbje neto për periudhën (XV-XVI)

FI 7.1Q: Llogaria teknike, Jo-Jetë (Pjesa A dhe B)

Kjo pasqyrë raportohet e veçantë për sigurimin e jetës dhe sigurimin e Jo-Jetës. Në këtë pasqyrë do të paraqitet llogaria teknike (rezultati financiar nga aktiviteti i drejtpërdrejtë i sigurimit/risigurimit) për shoqëritë që ushtrojnë veprimtari në klasat e sigurimit të jo-jetës e ndarë sipas klasave të sigurimit. Bilanci jep rezultatin për secilin portofol gjatë vitit financiar.

Të dhënat e pasqyruara në Llogarinë Teknike duhet të ndahen sipas klasave dhe grupimeve të mëposhtme:

1. Sigurimi i aksidenteve dhe e shëndetit;
2. Sigurime motorike detajuar sipas produkteve të sigurimit: 'Kasko', 'MTPL e brendshme

- ‘Karton Jeshil’, dhe ‘Kufitare’;
3. Sigurimi i anijeve, përfshirë Sigurimi i përgjegjësive për anijet;
 4. Sigurimi i avionëve, Sigurimi i përgjegjësive nga përdorimi i avionëve;
 5. Sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë;
 6. Sigurimi i mallrave në transport pavarësisht nga mënyra e transportit;
 7. Sigurimi i përgjegjësive;
 8. Sigurimi i kreditit;
 9. Sigurimi i garancive;
 10. Sigurimi i mjeteve lëvizëse mbi shina;
 11. Sigurimi i humbjeve të ndryshme financiare.

Rezultati teknik i sigurimeve është diferencë midis të ardhurave nga primet teknike dhe shpenzimeve për dëmet, të shtuara ose të pakësuara nga rritja ose pakësimi i provigjoneve teknike të sigurimit për periudhën. Të ardhurat dhe shpenzimet nga investimi të lidhura me klasat e sigurimit të jo-jetës nuk do të përfshihen në llogarinë teknike të sigurimeve Jo-jetë por do të pasqyrohen vetëm në llogarinë ‘Fitim humbje’. Të ardhurat dhe shpenzimet nga investimi të lidhura me klasat e sigurimit të jetës do të përfshihen në llogarinë teknike të sigurimeve Jetë dhe do të shpërndahen midis klasave të sigurimit të jetës. Kjo mënyrë shpërndarjeje do të jetë pjesë e shënimeve të pasqyrave financiare. Në rastin e një shoqërie që ushtron veprimtari sigurimi si për klasat e sigurimit të jetës dhe për të jo-jetës, të ardhurat dhe shpenzimet nga investimi që janë të lidhura drejtpërdrejt me veprimtarinë e sigurimit të jetës do të përfshihen në llogarinë teknike të sigurimit të jetës.

(01) Prime të fituara neto (02+03+04+05)

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin I. “Prime të fituara neto (1+2+3+4)” në pasqyrën FI 3Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jo-Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(02) Prime të shkruara bruto

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin I – 1. “Prime të shkruara bruto” në pasqyrën FI 3Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jo-Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(03) Prime të ceduara në risigurim (-)

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin I – 2. “Prime të ceduara në risigurim (-)” në pasqyrën FI 3Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jo-Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(04) Ndryshimi në provigjonin e primeve të pafituara bruto (+/-)

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin I – 3. “Ndryshimi në provigjonin e primeve të

pafituara bruto (+/-)” në pasqyrën FI 3Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jo-Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(05) Ndryshimi në provigjonin e primeve të pafituara, pjesa e risiguruesve (+/-)

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin I – 4. “Ndryshimi në provigjonin për primin e pafituar pjesa e risiguruesit” në pasqyrën FI 3Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jo-Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(06) Të ardhura të tjera teknike neto nga veprimtaria e sigurimeve

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin II. “Të ardhura të tjera teknike neto nga veprimtaria e sigurimeve” në pasqyrën FI 3Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jo-Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(07) Shpenzime neto për dëme të paguara (08+09+10+11)

(08) Dëme të paguara bruto

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin III – 1. “Dëme të paguara bruto” në pasqyrën FI 3Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jo-Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(09) Dëme të paguara nga risiguruesit (-)

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin III – 2. “Dëme të paguara nga risiguruesit (-)” në pasqyrën FI 3Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jo-Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(10) Ndryshimi në provigjoni e dëmeve, bruto (+/-)

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin III – 3. “Ndryshimi në provigjoni e dëmeve, bruto” në pasqyrën FI 3Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jo-Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(11) Ndryshimi në provigjonin e dëmeve, pjesa e risiguruesit (+/-)

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin III – 4. “Ndryshimi në provigjoni e dëmeve, pjesa e risiguruesit” në pasqyrën FI 3Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jo-Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(12) Ndryshimi në provigjonet e tjera teknike (+/-)

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin IV. “Ndryshimi në provigjonet e tjera teknike (+/-)” në pasqyrën FI 3Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jo-Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(13) Shpenzimet neto për bonuse dhe rabate

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin V. “Shpenzimet neto për bonuse dhe rabate” në pasqyrën FI 3Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jo-Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(14) Shpenzime operative neto të veprimtarisë (15+16+17+18+19+20)

(15) Shpenzime të marrjes në sigurim

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin VI – 1. “Shpenzime të marrjes në sigurim” në pasqyrën FI 3Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jo-Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(16) Ndryshimi në shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim (+/-)

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin VI – 2. “Ndryshimi në shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim (+/-)” në pasqyrën FI 3Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jo-Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(17) Shpenzime administrative

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin VI – 3. “Shpenzime administrative” në pasqyrën FI 3Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jo-Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(18) Shpenzime të tjera operative

(19) Komisione të risigurimit (-)

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin VI – 5. “Komisione të risigurimit (-)” në pasqyrën FI 3Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jo-Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(21) Shpenzime të tjera neto për sigurimet (22+23)

(22) Shpenzime për parandalimin e dëmeve

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin VII – 1. “Shpenzime për parandalimin e dëmeve” në pasqyrën FI 3Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jo-Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(23) Shpenzime të tjera neto të sigurimeve

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin VII – 2. “Shpenzime të tjera neto të sigurimeve” në pasqyrën FI 3Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jo-Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(25) Të ardhura të llogaritura nga investimet transferuar nga llogaria jo teknike (+)

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin VIII. “Të ardhura të llogaritura nga investimet transferuar nga llogaria jo teknike në llogarinë teknike (+)” në pasqyrën FI 3Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jo-Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(26) Rezultati teknik (01+06-07-12-13-14-21+25)

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë IX. në pasqyrën FI 3Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jo-Jetë”.

Totali i rezultatit teknik për të gjitha klasat e sigurimit duhet të jetë i barabartë me vlerën e zërit korrespondues në pasqyrën FI 3Q Llogaria Fitim/Humbje (zëri IX: Rezultati teknik).

FI 8A: Llogaria teknike, Jetë

Në këtë pasqyrë do të paraqitet llogaria teknike (rezultati financiar nga aktiviteti i drejtpërdrejtë i sigurimit/risigurimit) e ndarë sipas klasave të sigurimit. Për detajimin e zërave referoju pasqyrës FI 4Q.

Në ndryshim nga llogaria teknike e shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës, në llogarinë teknike të shoqërive që kryejnë aktivitetin e jetës, rezultati teknik përveç të ardhurave nga primet teknike dhe shpenzimeve për dëmet, të shtuara ose të pakësuara nga rritja ose pakësimi i provigjoneve teknike të sigurimit për periudhën, do të përfshihen edhe të ardhurat/ shpenzimet e investimeve që vijnë nga produktet e lidhura me klasat e sigurimit të Jetës.

Të dhënat e pasqyruara në Llogarinë Teknike duhet të ndahen sipas klasave dhe grupimeve të mëposhtme:

1. Sigurim Jetë / Vdekje;
2. Sigurim Martesë / Lindje;
3. Sigurime të lidhura me fondet e investimeve;
4. Sigurimi i administrimit të fondeve kolektive;
5. Sigurime të jetës të mbështetura në llogaritje aktuariale.

Totali i rezultatit teknik për të gjitha klasat e sigurimit duhet të jetë i barabartë me vlerën e zërit korrespondues në pasqyrën FI 4Q Llogaria Fitim/Humbje (zëri XI: Rezultati teknik).

(01) Prime të fituara neto (02+03+04+05)

(02) Prime të shkruara bruto

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin I – 1. “Prime të shkruara bruto” në pasqyrën FI 4Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(03) Prime të ceduara në risigurim (-)

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin I – 2. “Prime të ceduara në risigurim (-)” në pasqyrën FI 4Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(04) Ndryshimi në provigjonin e primeve të pafituara bruto (+/-)

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin I – 3. “Ndryshimi në provigjonin e primeve të pafituara bruto (+/-)” në pasqyrën FI 4Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(05) Ndryshimi në provigjonin e primeve të pafituara, pjesa e risiguruesve (+/-)

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin I – 4. “Ndryshimi në provigjonin për primin e pafituar pjesa e risiguruesit” në pasqyrën FI 4Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(06) Investime neto (07+08+09)

(07) Të ardhura nga investimet

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin II - 1. “Të ardhura nga investimet” në pasqyrën FI 4Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(08) Shpenzime për investime

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin II - 2. “Shpenzime për investime” në pasqyrën FI 4Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(09) Fitim / Humbje nga shitja e investimeve

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin II - 3. “Fitim / Humbje nga shitja e investimeve” në pasqyrën FI 4Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(10) Rritja në vlerën e drejtë (fair value) nëpërmjet llogarisë Fitim/Humbje

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin III. “Rritja në vlerën e drejtë (fair value) nëpërmjet llogarisë Fitim/Humbje” në pasqyrën FI 4Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(11) Të ardhura të tjera teknike neto nga veprimtaria e sigurimeve

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin IV. “Të ardhura të tjera teknike neto nga veprimtaria e sigurimeve” në pasqyrën FI 4Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(12) Shpenzime neto për dëme të paguara (13+14+15+16)

(13) Dëme të paguara bruto

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin V – 1. “Dëme të paguara bruto” në pasqyrën FI 4Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(14) Dëme të paguara nga risiguruesit (-)

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin V – 2. “Dëme të paguara nga risiguruesit (-)” në pasqyrën FI 4Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(15) Ndryshimi në provigjoni e dëmeve, bruto (+/-)

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin V – 3. “Ndryshimi në provigjoni e dëmeve, bruto” në pasqyrën FI 4Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(16) Ndryshimi në provigjoni e dëmeve, pjesa e risiguruesit (+/-)

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin V – 4. “Ndryshimi në provigjoni e dëmeve, pjesa e risiguruesit” në pasqyrën FI 4Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(17) Ndryshimi në provigjonet e tjera teknike (+/-)

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin VI. “Ndryshimi në provigjonet e tjera teknike (+/-)” në pasqyrën FI 4Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(18) Shpenzimet neto për bonuse dhe rabate duke përfshirë ndryshimin në provigjone – neto pa risigurime

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin VII. “Shpenzimet neto për bonuse dhe rabate duke përfshirë ndryshimin në provigjone – neto pa risigurim” në pasqyrën FI 4Q “Llogaria Fitim /

Humbje, Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(19) Shpenzime operative neto të veprimtarisë (20+21+22+23+24)

(20) Shpenzime të marrjes në sigurim

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin VIII – 1. “Shpenzime të marrjes në sigurim” në pasqyrën FI 4Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(21) Ndryshimi në shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim (+/-)

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin VIII – 2. “Ndryshimi në shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim (+/-)” në pasqyrën FI 4Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(22) Shpenzime administrative

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin VIII – 3. “Shpenzime administrative” në pasqyrën FI 4Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(23) Shpenzime të tjera operative

(24) Komisione të risigurimit (-)

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin VIII – 5. “Komisione të risigurimit (-)” në pasqyrën FI 4Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(25) Shpenzime të tjera neto për sigurimet (26+27)

(26) Shpenzime për parandalimin e dëmeve

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin IX – 1. “Shpenzime për parandalimin e dëmeve” në pasqyrën FI 4Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(27) Shpenzime të tjera neto të sigurimeve

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin IX – 2. “Shpenzime të tjera neto të sigurimeve” në pasqyrën FI 4Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(28) Të ardhura neto nga investimet duke përfshirë kostot, të transferuara në llogarinë fitim/humbje

Shpjegimi i këtij zëri është bërë në zërin X. “Të ardhura të llogaritura nga investimet transferuar nga llogaria jo teknike në llogarinë teknike (+)” në pasqyrën FI 4Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jetë”. Vlera e këtij zëri në të dyja pasqyrat duhet të jetë e barabartë.

(29) Rezultati teknik (01+06+10+11-12-17-18-19-25-28)

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë IX. në pasqyrën FI 4Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jetë”.

Raportim mbi portofolin e investimeve

FI 9.1Q: Toka dhe ndërtesa

Në këtë pasqyrë raportohen tokat dhe ndërtesat, parapagimet dhe pagesat pjesore të kryera për ndërtimet në proces, të drejtat në pasuri të paluajtshme dhe të drejta të tjera të ngjashme të përcaktuara në Kodin Civil.

Kosto e një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa) do të njihet si aktiv nëse dhe vetëm nëse:

- a. Entiteti /shoqëria ka kontroll mbi aktivin;
- b. Është e mundshme që përfitimet ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktiv do të rrjedhin tek njësia ekonomike; dhe
- c. Kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri.

Ky zë duhet të paraqitet i detajuar sipas zërave përbërës dhe amortizimeve përkatës.

- Shumat që i korrespondojnë njësive të zërit Toka dhe Ndërtesa të mbajtura nga shoqëria e sigurimit për zhvillimin e aktivitetit të vet.
- Shumat që i korrespondojnë njësive të zërit Toka dhe Ndërtesa të mbajtura nga shoqëria e sigurimit për qëllime investimi.

Totali i këtij zëri duhet të përkojë me totalin e po të njëjtit zë (Aktiv C- I) në pasqyrën FI 1Q “Aktivi”.

FI 9.2Q: Investime në filiale dhe shoqëri të bashkëkontrolluara

Kjo pasqyrë paraqet zërin CII: Investime në filiale/shoqëri të kontrolluara dhe shoqëri me interesa pjesëmarrëse (1+2+3+4+5) në Bilanc /Aktiv të detajuar sipas kategorive filiale/shoqëri të kontrolluara dhe investime në shoqëri me interesa pjesëmarrëse.

1. Investime në filial¹ (1.1+1.2+1.3)

¹ Në zbatim të kërkesave të ligjit nr.52 datë 22.05.2014 termi ‘filial’ ka të njëjtin kuptim me termin shoqëri e

Në këtë zë përfshihen investimet e shoqërisë së sigurimit në njësitë ekonomike ku ajo zotëron influencë domethënëse dhe kontroll (zakonisht shoqërohet me zotërim të aksioneve në masën 50-100%-Investimet në Filiale), të klasifikuara sipas kategorizimeve përkatëse aksione/instrumenta borxhi/të tjera.

Një shoqëri mëmë do të paraqesë pasqyra financiare të konsoliduara në të cilat ajo konsolidon investimet e saj në filiale në përputhje me SNK 27.

Kur përgatiten pasqyra financiare individuale për një shoqëri mëmë për kontabilizimin e investimeve në filiale përdoret metoda e kostos së amortizuar (SNK 27).

Totali i këtij zëri duhet të përkojë me shumën e nënzërave C - II.1 dhe C- II.2 në pasqyrën Fl 1Q.

2. Investime në shoqëri me interesa pjesëmarrëse (Investime në sipërmarrje 2.1+2.2)

Në këtë zë përfshihen investimet e shoqërisë së sigurimit në njësitë ekonomike ku ajo zotëron influencë domethënëse (dhe e cila nuk është as filial dhe as një interes kapitali në një sipërmarrje të përbashkët) por jo kontroll (zakonisht shoqërohet me zotërim të aksioneve në masën 20-50%), të klasifikuara sipas kategorizimeve përkatëse aksione/instrumenta borxhi/të tjera.

Për vlerësimin kontabël të investimeve me interesa pjesëmarrëse do të përdoret metoda e kapitalit neto.

Totali i këtij zëri duhet të përkojë me shumën e nënzërave C - II.3, C - II.4 dhe C - II.5 në pasqyrën Fl 1Q.

FI 9.3Q: Investimet financiare afatgjata

Këtu do të pasqyrohen Investimet Financiare (referencë zëri i Bilancit/Aktiv: C – III. Investime të tjera financiare (1+2+3+4+5+6+7) me afat maturimi më të lartë se një vit (afatgjata).

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar për një njësi ekonomike dhe një detyrim financiar ose instrument të kapitalit të vet për njësinë tjetër ekonomike.

1.1 Investime me pjesëmarrje. (Kuota/aksione në fonde investimi /shoqëri investimi dhe në fonde të tjera)

Në këtë zë përfshihen investimet në kuota/ aksione në fonde investimi apo fonde të tjera (ku pjesëmarrja është më e ulët se 20%).

1.2 Letra borxhi dhe letra të tjera me vlerë me të ardhura fikse

Në këtë zë përfshihen letra borxhi të qeverisë (obligacionet e thesarit) me afat mbi 1 vit (1.2.1) si dhe letra borxhi të tjera ndaj njërive të tjera ekonomike (1.2.2).

1.3 Hua hipotekore

kontrolluar.

Në këtë zë përfshihen hua të dhëna nga shoqëria të cilat janë të garantuara me hipotekë (referencë zëri i bilancit / Aktiv C – III – 5. Hua hipotekore) me afat maturimi më të madh se një vit.

1.4 Hua të tjera

Në këtë zë përfshihen hua të dhëna nga shoqëria të cilat janë të pagarantuar me hipotekë (referencë zëri i bilancit / Aktiv C – III – 6. Hua të tjera) me afat maturimi më të lartë se një vit.

1.5. Depozita në bankë (> 1 vit)

Në këtë zë përfshihen shumat e depozituara në institucione të autorizuar, afati i maturimit i të cilave është më i madh se një vit.

1.6. Investime të tjera financiare

Në këtë zë përfshihen investime të tjera afatgjata të cilat nuk janë përfshirë në kategorizimet e mësipërme.

FI 9.4Q: Investimet financiare afatshkurtra

Këtu do të pasqyrohen Investimet Financiare (referencë zëri i Bilancit/Aktiv: C – III. Investime të tjera financiare (1+2+3+4+5+6+7)) me afat maturimi më të ulët se një vit (afatshkurtra) apo të cilat mbahen për qëllime tregtimi të afërt.

1.1 Aksione dhe investime me interes pjesëmarrës të mbajtura për tregtim

Në këtë zë përfshihen investimet në kuota/ aksione në fonde investimi apo fonde të tjera (ku pjesëmarrja është më e ulët se 20%), të cilat mbahen nga shoqëria për qëllime tregtimi të afërt.

1.2 Letra borxhi të mbajtura për tregtim

Në këtë zë përfshihen Bonot e Thesarit të qeverisë (zëri 1.2.1) me afat maturimi 1 vit ose më pak si dhe letra borxhi të tjera (1.2.2) të cilat mbahen nga shoqëria për qëllime tregtimi të afërt.

1.3 Hua afatshkurtra

Në këtë zë përfshihen hua të dhëna nga shoqëria afati i maturimit i të cilave është 1 vit ose më pak.

1.4 Depozita në bankë (afatshkurtra midis 3 muaj dhe 1 vit)

Në këtë zë përfshihen shumat e depozituara në institucione të autorizuar, afati i maturimit i të cilave është më i madh se 3 muaj dhe më i vogël se 1 vit.

1.5 Të tjera investime afatshkurtra

Në këtë zë përfshihen investime të tjera afatshkurtra të cilat nuk janë përfshirë në kategorizimet e mësipërme.

FI 10Q: Llogari të arkëtueshme tregtare

Pasqyra FI 10Q “Llogari të arkëtueshme tregtare” paraqet detajimin e zërit I. “Llogari të arkëtueshme tregtare” në pasqyrën e Bilancit/Aktiv. Për një detajim specifik të çdo zëri referoju zërit I. në pasqyrën e Bilancit Aktiv.

I. Llogari të arkëtueshme tregtare që rrjedhin drejtpërdrejt nga veprimtaria e sigurimeve (1+2+3+4)

Në këtë zë përfshihen llogaritë e arkëtueshme tregtare që rrjedhin drejtpërdrejt nga veprimtaria e sigurimeve (zërit korrespondues në bilanc Aktiv: I.I) të detajuara sipas të drejtave të shoqërisë ndaj policëmbajtësve (I1), ndërmjetësve (I 2), filialeve dhe shoqërive të bashkëkontrolluara (I 3) dhe të tjerë që rrjedhin nga veprimtaria direkte e sigurimit (I 4) dhe kohës së lindjes së të drejtave në < 3 muaj, 3 muaj – 1 vit dhe në >1 vit.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë (I.I) në pasqyrën FI 1Q “Bilanci-Aktiv”.

II. Llogari të arkëtueshme tregtare nga veprimtaria e risigurimeve (1+2)

Në këtë zë përfshihen llogaritë e arkëtueshme tregtare që rrjedhin drejtpërdrejt nga veprimtaria e risigurimeve (zëri korrespondues në bilanc Aktiv:I.II) të ndarë: zëri ‘Llogari të arkëtueshme tregtare nga risigurimi’ (II.1) i detajuar sipas moshës < 3 muaj, 3muaj – 1vit dhe në >1 vit dhe zëri ‘Llogari të arkëtueshme tregtare nga risiguruesi’ (II.2) i detajuar sipas klasifikimit të risiguruesve (“nën BBB-“ dhe “mbi BBB-“) dhe sipas moshës në <1vit dhe në >1 vit.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë (I.II) në pasqyrën FI 1Q “Bilanci-Aktiv”.

III. Llogari të tjera të arkëtueshme tregtare

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë (I.III) në pasqyrën FI 1Q “Bilanci-Aktiv”.

III.1. Llogari të arkëtueshme tregtare që rrjedhin nga financimi

Në këtë zë përfshihen të drejtat nga shoqëritë e lidhura përveç filialeve ose shoqërive me interesa pjesëmarrëse. Pra përfshin të drejtat nga palët e treta ku shoqëria ka pjesëmarrje nën 20% dhe nuk ka as influencë dhe as kontroll.

III.2. Llogari të arkëtueshme tregtare nga shteti

Në këtë zë përfshihen të drejtat nga organet shtetërore, si ato tatimore, sigurimet shoqërore, etj.

III. 3. Llogari të tjera të arkëtueshme tregtare (detajo debitorët me $\geq 20\%$ të shumës III)

Në këtë zë do të detajohen 'Llogaritë e tjera të arkëtueshme tregtare' që përbejnë 20% ose më shumë të totalit të llogarive të tjera të arkëtueshme tregtare (III. Llogari të tjera të arkëtueshme tregtare).

III. 3.a Të tjerë (që nuk janë cituar nën 3)

Në këtë zë përfshihen të drejta që nuk janë përfshirë në zërat e mësipërm.

FI 11Q: Llogari të pagueshme tregtare

Në këtë pasqyrë do të pasqyrohen Llogaritë e Pagueshme Tregtare (referencë zëri i Bilancit/Pasiv: G. Llogari të Pagueshme Tregtare (I+II+III+IV+V)) të detajuara sipas veprimtarive nga të cilat rrjedhin, sipas kolateralit me të cilin janë të garantuara, sipas institucioneve ose palëve të cilat ju detyrohen këto hua qofshin këto institucione krediti, palë të lidhura ose jo dhe të ndara sipas moshës në 'Kreditorë afatgjatë' dhe 'Kreditorë Afatshkurtër'.

I. Llogari të pagueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria direkte e sigurimit (1+2+3+4)

Në këtë zë përfshihen llogaritë e pagueshme tregtare që rrjedhin drejtpërdrejt nga veprimtaria e sigurimeve (për shpjegim referoju zërit korrespondues në bilanc Pasiv: G I) të detajuara sipas detyrimeve të shoqërisë, ndaj policëmbajtësve (I 1), ndërmjetësve (I 2), filialeve (I 3) dhe të tjerë që rrjedhin nga veprimtaria direkte e sigurimit (I 4), dhe kohës së lindjes së detyrimit në < 1 vit dhe në > 1 vit.

II. Llogari të pagueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria e risigurimit (1+2+3+4)

Në këtë zë përfshihen llogaritë e pagueshme tregtare që rrjedhin drejtpërdrejt nga veprimtaria e risigurimeve (për shpjegim referoju zërit korrespondues në bilanc Pasiv: G II) të detajuara sipas moshës dhe sipas klasifikimit të risigurveve ("nën BBB-" dhe "mbi BBB-") nga agjensitë 'rating'.

III. Letër me vlerë (Debenture) e kolateralizuar me instrumenta financiar me të ardhura fikse (1+2)

Në këtë zë përfshihen huat (Debenture loan) e marra nga shoqëria dhe të kolateralizuara me

instrumenta financiarë me të ardhura fikse (përfshirë edhe rastin kur këto hua janë të konvertueshme) të detajuara sipas palës huadhënëse (palë të lidhura në të cilat shoqëria e sigurimit zotëron min 10% ose palë të tjera jo të lidhura) dhe kohëzgjatjes së huas (afat-shkurtër <= 1 vit ose afat-gjatë > 1 vit) në secilin rast (për shpjegim referoju zërit korrespondues në bilanc Pasiv:G III).

IV. Shuma që u detyrohen insitucioneve të kreditit

Këtu regjistrohen detyrimet për hua të marra pranë institucioneve të kreditit, detajuar sipas kohëzgjatjes së tyre në kredi afat gjata (më të mëdha ose baraz me 1 vit) ose kredi afat shkurtër (për shpjegim referoju zërit korrespondues në bilanc Pasiv:G IV).

V. Të tjera llogari të pagueshme tregtare (1+2+3+4)

V.1 Llogari të pagueshme tregtare nga financimi

Në këtë zë përfshihen shumat që u detyrohen shoqërive të lidhura përveç filialeve ose shoqërive me interesa pjesëmarrëse. Pra përfshin detyrimet ndaj nda atyre palëve të treta ku shoqëria ka pjesëmarrje nën 20% dhe nuk ka as influencë dhe as kontroll.

V.4.4 Të tjera llogari të pagueshme tregtare(3.1+3.2)

Ky zë i korespondon zërit G-V-4 në Pasivin e Bilancit dhe përfshin shumat që u detyrohen shoqërive të lidhura duke përfshirë këtu detyrimet ndaj shoqërive me interesa pjesëmarrëse investime në sipërmarrje 20%-50%) dhe ndaj degëve/filialeve (pjesëmarrje 50%-100%), detyrimet ndaj palëve jo të lidhura (V4.3.2) si dhe detyrimet e shoqërisë për dëmet e shkaktuar nga personat e pasiguar, pra detyrimet për Fondin e Kompensimit .

Në këtë zë duhen paraqitur të detajuara detyrimet ndaj palëve jo të lidhura që përbejnë 20% ose më shumë të totalit të tjera llogari të pagueshme tregtare (V.4. Të tjera llogari të pagueshme tregtare).

Shuma e zërave VI: Totali i llogarive të pagueshme tregtare afatgjate (> 1 vit) dhe VII: Totali i llogarive të pagueshme tregtare afatshkurtër (<= 1 vit) duhet të jetë e njëjtë me zërin në Pasivin e Bilancit:G. Llogari të Pagueshme Tregtare (I+II+III+IV+V)

FI 12Q: Kostot e marrjes në sigurim, Jo-Jetë

Kjo pasqyrë jep një detajim të kostove të marrjes në sigurim të ndara sipas klasave të sigurimeve të aktivitetit të jo jetës. Totali i kostove të marrjes në sigurim të aktivitetit të Jo-Jetës për të gjitha klasat e sigurimit duhet të jetë i barabartë me zërin VI.1 “Shpenzime të marrjes në sigurim” në Pasqyrën Fitim / Humbje, Jo-Jetë (FI 3Q).

“Do të klasifikohen si shpenzime të marrjes në sigurim ato shpenzime që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me marrjen e suksesshme në sigurim (succesful acquisition) të policave të reja ose me rinovimin e kontratave të sigurimit ekzistuese.”

1. Komisionet e ndërmjetësve

Në këtë zë përfshihen komisionet e paguara agjentëve (ndërmjetësve) për marrjen në sigurim dhe në risigurim të detajuara sipas klasave të sigurimit të aktivitetit të Jo-Jetës.

2. Shpenzimet e marrjes në sigurim

Në këtë zë përfshihen shpenzimet e lidhura me nënshkrimin dhe rinovimin e kontratave të sigurimit, shpenzimet e përgjithshme të lidhura me verifikimin e aplikimeve dhe lëshimin e policave, shpenzime lidhur me procesin e vlerësimit të rrezikut të sigurimit (underwriting process) duke përfshirë dhe shpenzimet e stafit/departamentit të marrjes në sigurim të detajuara sipas klasave të sigurimit të aktivitetit të jo jetës.

3. Shpenzime marketingu

Në këtë zë përfshihen shpenzimet e marketingut që lidhen me produktet e sigurimit në veçanti (jo të shoqërisë) siç janë shpenzimet e reklamave dhe promovimeve të detajuara sipas klasave të sigurimit të aktivitetit të jo jetës.

4. Kosto të tjera të marrjes në sigurim

Në këtë zë përfshihen shpenzime të tjera të marrjes në sigurim të papërfshira në zërat e mësipërm. Zëri ‘Ndryshimi në kostot e shtyra të marrjes në sigurim’ nuk është pjesë e kësaj pasqyre pasi është zë më vete në Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve (FI 3Q zëri VI 2.).

FI 13Q: Kostot e marrjes në sigurim, Jetë

Kjo pasqyrë jep një detajim të kostove të marrjes në sigurim të ndara sipas klasave të sigurimeve të aktivitetit të jetës. Totali i kostove të marrjes në sigurim të aktivitetit të jetës për të gjitha klasat e sigurimit duhet të jetë i barabartë me zërin VIII.1 “Shpenzime të marrjes në sigurim” në Pasqyrën Fitim / Humbje, Jetë (FI 4Q).

“Do të klasifikohen si shpenzime të marrjes në sigurim ato shpenzime që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me marrjen e suksesshme në sigurim (successful acquisition) të policave të reja ose me rinovimin e kontratave të sigurimit ekzistuese.”

1. Komisionet e ndërmjetësve

Në këtë zë përfshihen komisionet e paguara agjentëve (ndërmjetësve) për marrjen në sigurim dhe në risigurim të detajuara sipas klasave të sigurimit të aktivitetit të Jetës. Komisionet janë të dy tipeve: komisionet fillestare të policave të reja që hyjnë në fuqi dhe komisionet e rinovimit për periudhat në vijim.

2. Shpenzimet e marrjes në sigurim

Në këtë zë përfshihen shpenzimet e lidhura me nënshkrimin e kontratave të sigurimit të Jetës, shpenzimet e përgjithshme të lidhura me verifikimin e aplikimeve dhe lëshimin e policave, shpenzime lidhur me procesin e vlerësimit të riskut të sigurimit si shpenzimet e diagnostikimeve

mjekësore si dhe shpenzimet e stafit/departamentit të marrjes në sigurim të detajuara sipas klasave të sigurimit të aktivitetit të Jetës.

3. Shpenzime marketingu

Në këtë zë përfshihen shpenzimet e marketingut që lidhen me produktet e sigurimit në veçanti (jo të shoqërisë) siç janë shpenzimet e reklamave dhe promovimeve të detajuara sipas klasave të sigurimit të aktivitetit të Jetës.

4. Kosto të tjera të marrjes në sigurim

Në këtë zë përfshihen shpenzime të tjera të marrjes në sigurim të papërfshira në zërat e mësipërm. Zëri ‘Ndryshimi në kostot e shtyra të marrjes në sigurim’ nuk është pjesë e kësaj pasqyre pasi është zë më vete në Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve (FI 3Q zëri VI 2.).

FI 15Q: Shpenzimet administrative

Pasqyra FI 15Q, “Shpenzimet administrative” paraqet në mënyrë të detajuar zërat “Shpenzime administrative” dhe “Shpenzime të tjera operative” të pasqyrës Fitim / Humbje, përkatësisht: në pasqyrën FI 3Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jo jetë” zërat VI – 3 dhe VI – 4, ose zërat VIII – 3 dhe VIII – 4 në pasqyrën FI 4Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jetë”.

I. Shpenzime administrative (1+2+3+4+5)

Në këtë zë duhet të përfshihen të gjitha shpenzimet që vijnë nga aktivitetet si mbledhja e primeve, administrimi i portofolit dhe risigurimi.

Në veçanti në këtë zë do përfshihen shpenzimet e shoqërisë të cilat nuk lidhen ose rrjedhin drejtpërsëdrejti nga një policë e caktuar, ku përfshihen pagat dhe shpenzimet e tjera për punonjësit, shërbime nga palë të treta, taksat, amortizimi, etj., sipas ndarjeve në nënzërat përkatës në pasqyrë.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë (VI - 3) në pasqyrën FI 3Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jo-Jetë” ose zërin (VIII - 3) në pasqyrën FI 4Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jetë”.

II. Shpenzime të tjera operative (1+2)

Në këtë zë do përfshihen shpenzime të tjera operative, si provigjone debitorësh të këqij dhe të tjera.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë (VI - 4) në pasqyrën FI 3Q “Llogaria Fitim / Humbje, Jo-Jetë” ose në pasqyrën zërin FI 4Q (VIII - 4) “Llogaria Fitim / Humbje, Jetë”.

FI 16Q: Përputhshmëria e aktiveve

Kjo pasqyrë është në funksion të matjes së likuiditetit (pra liston detyrimet afatshkurtra të kompanisë dhe aktivet likuide të saj) të kompanisë dhe nuk ka për qëllim matjen e aktiveve që mbulojnë Provigjonet Teknike.

Plotësimi i pasqyrës përputhshmëria e aktiveve duhet të bëhet si më poshtë:

- Në tabelën “Monedha në të cilën do të paguhet përgjegjësitë” duhet të vendosen vetëm provigjonet për dëmet pezull (pa përfshirë IBRN) të ndara sipas valutave.

Në tabelën “Monedha në të cilën mbahen Provigjonet Teknike” duhet të vendosen të ndara sipas valutave. Vlerat e zërave të bilancit: “mjete monetare në arkë dhe në bankë”; “Depozita në institucione krediti” si dhe “Bono Thesari”, nga zërat e mësipërm duhet të zbritet vlera e Fondit të Garancisë (vetëm kërkesa sipas bazës ligjore, jo vlera totale e depozitave dhe bonove të thesarit që shoqëria ka të bllokuara për këtë qëllim).

FI 17Q: Provigjoni i primit të pafituar – Jo-Jetë

Provigjone bruto për primin e pafituar

Pjesa e ceduar në risigurim

Në këtë pasqyrë do të regjistrohen provigjonet për primin e pafituar nga shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin e Jo-Jetës, e cila duhet të përlllogaritet në mënyrë të veçantë për secilën nga policat në fuqi. Provigjonet do të regjistrohen sipas klasës së produktit, dhe sipas monedhës në të cilën është lëshuar polica.

Provigjonet për primet e pafituara lidhen me atë pjesë të primit të marrë, që i përket periudhës së rrezikut pas daljes së mbylljes së periudhës financiare. Në këtë provigjon teknik duhet të merret parasysh përgjegjësia për vazhdimësinë e mbulimit deri në përfundimin ose rinovimin e ardhshëm të policës, si edhe nëse i siguruari kërkon ndërprerjen e kontratës para afatit të shënuar në policë, deri në datën e ndërprerjes. Provigjoni teknik duhet përlllogaritur në veçanti për çdo policë në fuqi.

Përveç sa më sipër, shoqëria e sigurimit mund të krijojë provigjone për rreziqe të paskaduara, nëse nga një vlerësim i përgjegjësisë totale, (d.m.th duke përfshirë edhe shpenzimet) në lidhje me ekspozimin ndaj rrezikut pas datës së mbylljes së vitit financiar për policat e lëshuara para asaj date, mund të rezultojë që provigjoni teknik i primit të pafituar është i pamjaftueshëm për të mbuluar rreziqet në të ardhmen. Nëse shoqëria e sigurimit mbulon rreziqe që lidhen me sigurimin e garancive dhe kredive, ngjarje të forcës natyrore, si dhe dëmtime të shkaktuara nga energjia bërthamore, ajo krijon provigjone shtesë për primet e pafituara për këto klasa, në përputhje me natyrën e veçantë të tyre.

Provigjonet për primet e pafituara dhe provigjonet për rreziqet e paskaduara përbëjnë së bashku provigjonet për primet e pafituara.

Provigjoni i primit të pafituar Totali i kësaj pasqyre duhet të përputhet me zërin C - I.

Provigjone të primit të pafituar të pasqyrës **FI 2Q Pasqyra e Bilancit: Pasivi.**

Provigjoni i primit të pafituar -Pjesa e ceduar në risigurim: Totali i kësaj pasqyre duhet të përputhet me zërin *F - I. Provigjone të primit të pafituar* të pasqyrës

FI 2Q Pasqyra e Bilancit: Aktivi.

FI 18Q: Provigjone matematike – Jetë

Provigjone bruto për primin e pafituar

Pjesa e ceduar në risigurim

Provigjonet matematike, krijohen nga shoqëria e sigurimit që ushtron veprimtari në sigurimin e Jetës apo në klasa të tjera sigurimi, ku primet janë grumbulluar në formën e një fondi kursimi ose një fondi për tu përdorur për mbulimin e rreziqeve e viteve të ardhshme, të cilat janë të natyrës afatgjatë dhe janë subjekt i tabelave të probabilitetit dhe llogaritjeve të njëjta me ato të sigurimit të Jetës.

Provigjonet matematike llogariten për secilën nga klasat e sigurimit, duke zbatuar vlerësimet e përshtatshme aktuariale, të cilat marrin parasysh të gjitha përgjegjësitë e ardhshme të shoqërisë së sigurimit që rrjedhin nga çdo kontratë e sigurimit të Jetës, duke përfshirë:

- a. Pagesa të garantuara, të cilat i siguruari ka të drejtë t'i përfitojë;
- b. Bonuset, për të cilat i siguruari gëzon të drejtën kolektive ose individuale për t'i përfituar, pavarësisht nga forma e tyre;
- c. Opsionet në dispozicion të të siguarit, të përcaktuara në kushtet e kontratës;
- ç. Pjesën e llogaritur për mbulimin e shpenzimeve, përfshirë dhe komisione.

Përafrimet ose përgjithësimet mund të zbatohen vetëm nëse gjykohet se zbatimi i tyre sjell një rezultat përafërsisht të njëjtë me atë të llogaritur veçmas.

Kur i siguruari, në bazë të kontratës së sigurimit, ka të drejtën e pagesës së vlerës së dorëzimit, provigjonet matematike, që krijohen duke iu referuar kësaj kontrate, nuk duhet të jenë nën vlerën e pagesës së dorëzimit.

Totali i kësaj pasqyre duhet të përputhet me zërin *Pasiv: C - II. Provigjone matematike* të pasqyrës **FI 2Q Pasqyra e Bilancit: Pasivi.**

Pjesa e risiguruesit në provigjonet teknike përfshin shumat e risigurimit dhe llogaritjet në përputhje me kushtet e kontratës së risigurimit, duke u bazuar në shumat bruto të provigjoneve teknike.

Provigjonet e primeve që lidhen me shumat e risigurimit llogariten sipas klasave të sigurimit. Provigjone matematike -Pjesa e ceduar në risigurim: Totali i kësaj pasqyre duhet të përputhet me zërin *F - I. Provigjone të primit të pafituar* të pasqyrës

FI 2Q Pasqyra e Bilancit: Aktivi.

Shoqëria e sigurimit në shtojcën e raportit vjetor shpjegon bazën teknike dhe metodën e përdorur për llogaritjen e provigjoneve matematike.

FI 19Q: Provigjoni i dëmeve- Jo-Jetë

Provigjone për dëme pezull

Provigjone IBNR

Pjesa e ceduar në risigurim

Këtu regjistrohen provigjonet për dëmet, nga shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin e Jo-Jetës.

Provigjonet teknike të dëmeve krijohen në nivel të njëjtë me përgjegjësitë e marra përsipër nga shoqëria e sigurimit nëpërmjet kontratave, kur ngjarja e siguruar ndodh para përfundimit të periudhës financiare, duke përfshirë çdo shpenzim të pagueshëm nga shoqëria e sigurimit të përcaktuar në kontratën e sigurimit.

Provigjonet teknike të dëmeve përfshijnë, gjithashtu, edhe përgjegjësitë për dëmet, të cilat kanë ndodhur, por nuk janë raportuar.

Në këtë zë përfshihen shumat e parashikuara të dëmeve pezull të ndodhura dhe të raportuara në vitin aktual financiar, por ende të pashqyrtuara/vlerësuara plotësisht, përfshirë dhe parashikimin për shpenzimet e trajtimit të dëmeve, si dhe shumat për dëme të ndodhura në vitin financiar, por të paraportuara në këtë periudhë (IBNR).

Këtu përfshihen edhe detyrimet e shoqërisë ndaj policëmbajtësve për dëmet e ndodhura të llogaritura/vlerësuara dhe të rëna dakord për t'u paguar por akoma të palikuiduara (përfshirë këtu edhe vlerësimet për dëmet që janë në proces gjyqësor).

Gjithashtu shoqëria e sigurimit në këtë zë paraqet dhe vlerësimet për dëmet e refuzuara nëse pala e dëmtuar paraqet provat të reja të kërkuara nga shoqëria e sigurimit përpara përfundimit të afatit të parashkrimit parashikuar në Kodin Civil.

Totali i kësaj pasqyre duhet të përputhet me zërin *Pasiv: C -III. Provigjone të dëmeve* të pasqyrës

FI 2Q Pasqyra e Bilancit: Pasivi.

Provigjoni i dëmeve -Pjesa e ceduar në risigurim: Totali i kësaj pasqyre duhet të përputhet me *F - III. Provigjone të Dëmeve* të pasqyrës

FI 2Q Pasqyra e Bilancit: Aktivi.

FI 20Q: Provigjoni i dëmeve – Jetë

Provigjone për dëme pezull

Provigjone IBNR

Këtu regjistrohen provigjonet për dëmet, nga shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin e Jetës.

Provigjonet teknike të dëmeve krijohen në nivel të njëjtë me përgjegjësitë e marra përsipër nga shoqëria e sigurimit nëpërmjet kontratave, kur ngjarja e siguruar ndodh para përfundimit të periudhës financiare, pavarësisht nëse ngjarja është raportuar apo jo, duke përfshirë çdo shpenzim të pagueshëm nga shoqëria e sigurimit të përcaktuar në kontratën e sigurimit.

Provigjonet teknike të dëmeve përfshijnë, gjithashtu, edhe përgjegjësitë për dëmet, të cilat kanë

ndodhur, por nuk janë raportuar.

Në këtë zë përfshihen shumat e parashikuara të dëmeve pezull të ndodhura dhe të raportuara në vitin aktual financiar, por ende të pashqyrtuara/vlerësuara plotësisht, përfshirë dhe parashikimin për shpenzimet e trajtimit të dëmëve, si dhe shumat për dëme të ndodhura në vitin financiar, por të paraportuara në këtë periudhë (IBNR). Këtu përfshihen edhe detyrimet e shoqërisë ndaj policëmbajtësve për dëmet e ndodhura të llogaritura/vlerësuara dhe të rëna dakord për t'u paguar por akoma të palikuiduara (përfshirë këtu edhe vlerësimet për dëmet që janë në proces gjyqësor).

Gjthashtu shoqëria e sigurimit në këtë zë paraqet dhe vlerësimet për dëmet e refuzuara nëse pala e dëmtuar paraqet provat të reja të kërkuara nga shoqëria e sigurimit përpara përfundimit të afatit të parashkrimit parashikuar në Kodin Civil, sipas rregulloreve të fushës.

Totali i kësaj pasqyre duhet të përputhet me zërin *Pasiv: C -III. Provigjone të dëmeve* të pasqyrës **FI 2Q Pasqyra e Bilancit: Pasivi.**

Provigjoni i dëmeve -Pjesa e ceduar në risigurim: Totali i kësaj pasqyre duhet të përputhet me *F - III. Provigjone të Dëmeve* të pasqyrës

FI 2Q Pasqyra e Bilancit: Aktivi.

FI 21Q: Provigjone të tjera teknike

Në këtë pasqyrë do të regjistrohen ato zëra të provigjoneve teknike të ndryshme nga provigjonet e cilësuara në pasqyrat FI 17Q-FI 20Q.

Provigjoni i Katastrofave: shoqëria e sigurimit krijon provigjone të tjera teknike për të mbuluar përgjegjësitë e pritshme dhe rreziqet e dëmeve të mëdha, të cilat rrjedhin nga rreziqet e përmbytjes, tërmetit si dhe rreziqe të tjera me natyrë nga Katastrofat Natyrore.

Provigjoni i barazimit të dëmeve: shoqëria e sigurimit krijon provigjonin e barazimit të dëmeve me qëllim balancimin e luhatjeve në rastin e ndodhjes së ngjarjeve që shkaktojnë dëme.

Shoqëria e sigurimit mund të krijojë provigjonin e barazimit të dëmeve për ato klasa të sigurimit, në të cilat, ka një devijim të konsiderueshëm nga shumat e zakonshme të dëmshpërblimeve të llogaritura mbi baza vjetore, devijim i cili, bazuar në të dhënat statistikore, është i pritshëm.

Provigjoni i barazimit të dëmeve krijohet bazuar në devijimin e masës së dëmshpërblimeve të pritshme për periudhën financiare nga masa mesatare e dëmshpërblimeve për të njëjtën periudhë.

Provigjone të tjera teknike – Shoqëria e sigurimit krijon provigjone të tjera teknike me qëllim për të mbuluar përgjegjësitë e pritshme dhe rreziqet për dëme të mëdha të cilat rrjedhin nga sigurimi i përgjegjësisë për humbje nga rreziqe bërthamore, përgjegjësinë e prodhuesit të produkteve farmaceutike, si dhe rreziqe apo përgjegjësi të tjera për të cilat nuk krijohen provigjonet e përmendura më sipër.

ANEKS 2

Forma, përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të raportit mbi aktivet në mbulim të provigjoneve teknike:

- I. **Aktivet e lejuara në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, sipas nenit 97 të Ligjit 52/14 1** paraqet zërat:
- I.1 Germa a) Tituj të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose Banka e Shqipërisë*
 - I.2 Germa b) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë
 - I.3 Germa c) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të emetuar nga qeverisja vendore e Republikës së Shqipërisë;
 - I.4 Germa ç) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të shoqëruara nga garanci të emetuara nga qeverisja vendore e Republikës së Shqipërisë;
 - I.5 Germa d) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të tregtuar në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë;
 - I.6 Germa dh) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të cilët nuk tregtohen në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë, nëse emetuesi i tyre është person juridik, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë;
 - I.7 Germa e) Aksione të tregtuara në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë;**
 - I.8 Germa ë) Aksione, të cilat nuk tregtohen në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë, nëse emetuesi i tyre është person juridik, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë;***
 - I.9 Germa f) Kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;
 - I.10 Germa g) dhe gërma a) neni 4, pika 2, e Rregullores nr. 19, date 28.04.2015 Hua të pasiguruara dhe hua të siguruara nga garanci hipotekore, garanci bankare ose siguruese në Republikën e Shqipërisë, me kusht që këto të fundit të mos jenë siguruar nga shoqëri sigurimi apo banka të kontrolluara nga i njëjti grup që kontrollon dhe shoqërinë;
 - I.11 Germa gj) Toka, ndërtesa dhe të drejta në pasuri të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë nëse plotësohen njëkohësisht kërkesat sipas nenit 97, germa gj) e Ligjit 52/14.
Ky zë do të ndahet në rreshta më vete bazuar në qëllimin që ka secili objekt, pra në qëllime shfrytëzimi ose qëllime investimi. Do të plotësohet : Lloji I pasurisë, numri/numrat i/e pasurisë dhe zona kadastrale.
 - I.12 Germa h) Depozita në banka dhe/ose degë të bankave të huaja, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë.*

* Tituj të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose Banka e Shqipërisë dhe Depozita në banka dhe/ose degë të bankave të huaja, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë do të pakësohen për bonot e thesarit ose depozitat bankare që shërbejnë për financimin e Fondit të Garancisë (neni 4, pika 3 e Rregullores nr. 19, datë 28.04.2015) deri në nivelin e kërkuar ligjor.

** Aksione të tregtuara në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë dhe Aksione, të cilat nuk tregtohen në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë, nëse emetuesi i tyre është person juridik, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë do të pakësohen për investimet në pjesëmarrje dhe letrat me vlerë të shoqërive të cilat janë filiale, shoqëri mbështetëse, aksionarë, në shoqërinë e sigurimit apo çdo rast tjetër që konsiderohet si palë e lidhur me shoqërinë e sigurimit (neni 4, pika 3 e Rregullores nr. 19, datë 28.04.2015).

II. Investime të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, për të cilat është marrë miratimi paraprak i Autoritetit. Këtu do të përfshihen:

II.1 Obligacione afatgjata dhe tituj borxhi afatgjatë të emetuar nga një vend anëtar ose vend anëtar i OECD-së; që janë të klasifikuar si BBB+ e më lart sipas Standart & Poor's ose vlerësimi ekuivalent nga vlerësues të tjerë ndërkombëtarë të njohur gjerësisht;

II.2 Obligacione afatgjata dhe tituj afatgjatë të emetuar nga një entitet joqeveritar i një vendi anëtar ose vendi anëtar të OECD-së; me kushtin që entitetet jo qeveritare emetuese të jenë Banka Ndërkombëtare e Pagesave (BIS), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Komisioni Evropian apo banka zhvillimi shumëpalëshe, nëse ato plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme:

i. Për këta tituj ekzistojnë tregje aktive të marrëveshjeve të riblerjes;

ii. Titujt nuk janë emetuar nga bankat apo institucione të tjera financiare.

II.3 Aksione të emetuara nga një shoqëri aksionare e huaj, e cila tregton në tregje të rregulluara të kapitalit në një vend anëtar ose vend anëtar të OECD-së;

II.4 Kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, të cilat tregtohen në një vend anëtar ose vend anëtar të OECD-së.

III. Investime të tjera të lejuara sipas Rregullores nr. 19, date 28.04.2015, neni 4, pika 2, :

III.1 Germa b) Kredi individuale hipotekore për apartamente banimi vetëm për punonjësit e shoqërisë së sigurimit

III.2 Germa c) Para dhe ekuivalentë të saj (të cilat përfaqësojnë mjete monetare në arkë, mjete monetare në bankë dhe depozita me afat maturimi më të vogël se 3 muaj), në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë, me seli në Republikën e Shqipërisë;

III.3 Germa d) Të arkëtueshmet nga risiguruesit, që nuk janë pezull më shumë se 90 ditë nga lindja e detyrimit;

III.4 Germa e) Pjesën e risiguruesit në provigjonet teknike;

III.5 Germa f) Depozita në shoqëri ceduese dhe borxhe të zotëruara nga ato;

III.6 Germa g) Shuma, që detyrohen nga policëmbajtësit dhe ndërmjetësit, e që rrjedhin nga veprimtaria e sigurimeve të drejtpërdrejta dhe risiguruese, n.q.s nga dita e detyrimit të pagesës nuk kanë kaluar më shumë se 90 ditë, por jo më shumë se 20 % e provigjonit të primit të pafiturar;

III.7 Germa h) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara, përveç atyre të parashikuara në shkronjën “gj”, pika 1, e nenit 97, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”;

III.8 Germa i) Interesa dhe qira të maturuara dhe të ardhura të tjera të maturuara;

III.9 Germa j) Investimet në depozitat e garancisë së Kartonit Jeshil pranë BSHS;

III.10 Germa k) Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim.

Në kolonën e tretë “% e lejuar” janë vendosur përqindjet e lejuara për secilin nga zërat e mësipërm sipas përcaktimeve të Rregullores Nr.19, datë 28.04.2015 (e ndryshuar).

Në kolonën “Vlera në fakt” do të vendoset vlera e zërit përkatës në pozicionin financiar të periudhës në të cilën përgatitet raporti.

Në kolonën “% faktike” rezulton llogaritja e përqindjes faktike të investimit kundrejt provigjoneve teknike.

Kolona “Investime mbi limitet e lejuara” përfaqëson vlerën e investimit që mbetet pas vlerës maksimale të aktivitetit që lejohet të merret në konsideratë për mbulimin e provigjoneve. Kjo kolonë gjenerohet automatikisht në bazë të formulës.

IV. TOTALI I INVESTIMEVE (...+...+...) Gjenerohet automatikisht në kolonën “Vlera në fakt” duke mbledhur totalin e zërave të mësipërm.

- V. **TOTALI I INVESTIMEVE TE LEJUARA** Gjenerohet automatikisht nëpërmjet formulës, e cila zbret nga totali i investimeve, totalin e investimeve mbi limit.
- VI. **Provigjone teknike, të ndryshme nga ato matematike, bruto (VI.1 deri VI.5)** përfshin totalin e:
- VI.1 Provigjoneve të primit të pafiturar;
 - VI.2 Provigjoneve të dëmeve;
 - VI.3 Provigjoneve për bonuse dhe rabate;
 - VI.4 Provigjoneve barazimi dhe katastrofe;
 - VI.5 Provigjoneve të tjera teknike.
- VII. **Tepricë / (Mungesë) (V-VI)** përfaqëson diferencën midis totalit të investimeve të lejuara dhe provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike. Vlera e saj gjenerohet automatikisht nëpërmjet formulës.
- VIII. **Mbulimi në % (V/VI)** përfaqëson raportin midis totalit të investimeve të lejuara dhe provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike. Ky raport gjenerohet automatikisht nëpërmjet formulës.

ANEKS 3.

Forma, përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të raportit mbi mjaftueshmërinë e kapitalit.

- I. **Kapitali baze, neni 76 I Ligjit 52/14 (I.a+I.b+I.c-II) përfshin totalin e:**
- I.a Kapitali aksionar i shoqërisë së sigurimit, i cili përbëhet nga aksionet e zakonshme të emetuara;
 - I.b Rezervat e kapitalit, të cilat nuk i korrespondojnë detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimit;
 - I.c Fitimi i pashpërndarë, i mbartur pas zbritjes së dividendëve të pagueshëm.
- II. **Elementet që nuk përfshihen në llogaritjen e kapitalit bazë: (II.a+I.b+I.c+I.ç) renditen si më poshtë:**
- II.a Aksionet e veta të riblera;
 - II.b Investimet në aktive të patrupëzuara;
 - II.c Humbjet e mbartura dhe humbja e vitit ushtrimor;
 - II.ç Diferenca midis provigjoneve të dëmeve të skontuara dhe të paskontuara.
- Totali i pikave të mësipërme përbën të gjithë elementet që nuk përfshihen në llogaritjen e kapitalit bazë, kjo vlerë gjenerohet automatikisht nëpërmjet formulës.
- III. **Kapitali shtesë, neni 77 i Ligjit 52/14 (III.a+III.b+III.c+III.ç) konsiderohet shuma e:**
- III.a Kapitalit aksionar i cili përbëhet nga aksionet me përparësi të akumuluar;
 - III.b Instrumenteve të borxhit të varur;
 - III.c Rezervës kapitali që lidhen me aksionet me përparësi të akumuluar;
 - III.ç Elementeve të tjera.
- IV. **Elementet e zbritshme në llogaritjen e kapitalit, neni 79 i Ligjit 52/14 (IV.a+IV.b+IV.c+V)** përfaqësojnë totalin e zërave të mëposhtëm së bashku me aktivet jolikuide, nënndarja e të cilave pasqyrohet më poshtë:
- IV.a Pjesëmarrje dhe instrumente të borxhit të varur në një tjetër shoqëri sigurimi, risigurimi, grupi kontrollues sigurimi, banka dhe/ose degë të bankave të huaja, shoqëri komisionere, shoqëri administruese dhe institucione të tjera financiare, në të cilat shoqëria e sigurimit zotëron pjesëmarrje influencuese mbi 10 për qind;

- IV.b Investime të tjera në personat e parashikuar në shkronjën “a”, të kësaj pike, që janë përfshirë në llogaritjen e kapitalit të personave përkatës;
- IV.c Pjesëmarrjet dhe titujt e borxhit të varur, si dhe investime të tjera në një shoqëri tjetër sigurimi ose ente financiare, të tjera nga ato të parashikuara në shkronjën “a”, të kësaj pike, të cilat kalojnë masën 10 për qind të kapitalit të shoqërisë së sigurimit, e llogaritur përpara zbritjes së elementeve të përmendura në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike.

V. Aktivet jolikuide (V.a deri V.gj)

- V.a Aksionet e palistuara në tregje të rregulluara. ;
- V.b Huatë/llogaritë e arkëtueshme me palë të lidhura.
- V.c Huatë nga brokerat dhe agjentët.
- V.ç Primet e arkëtueshme ose debitorë nga risigurimi, që kanë tejkaluar afatin 90-ditor.
- V.d Debitorë të tjerë ose llogari të tjera të arkëtueshme, të cilat nuk rrjedhin drejtpërsëdrejti nga veprimtaria e sigurimit.
- V.dh Inventari.
- V.e Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim.
- V.ë Shpenzimet e parapaguara dhe aktive jomateriale në proces.
- V.f Aktivet e tjera, të cilat nuk janë të lira nga çdo përgjegjësi apo detyrim i parashikuar.
- V.g Aktivet e tjera, të cilat nuk janë lehtësisht të kthyeshme në para në momentin kur është e nevojshme përmbushja e detyrimeve financiare kur u vjen afati.
- V.gj Elementë të tjerë të zbritshëm sipas nenit 4 të kësaj rregullore.

VI. KAPITALI (Aftësia Paguese) është diferenca midis totalit të kapitalit bazë dhe kapitalit shtesë dhe elementëve të zbritshëm në llogaritjen e kapitalit.

VII. Kufiri minimal i aftësisë paguese përllogaritet sipas pikës 3 të nenit 80 të Ligjit nr. 52/2014.

VIII. Fondi i garancisë, vendoset vlera sipas nenit 81 të Ligjit nr. 52/2014.

IX. Niveli i kërkuar i aftësisë paguese, sipas pikës 2 të nenit 80 të Ligjit nr. 52/2014

X. Mbi (+) / nën (-) nivelin e kërkuar të Aftësisë paguese (VI-IX) është rezultat i diferencës midis Kapitalit dhe nivelit të kërkuar të aftësisë paguese.

XI. Mjaftueshmëria e Kapitalit (i mjaftueshëm / i pamjaftueshëm).

ANEKS 4

Forma, përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të statistikave 3 mujore.

St BA 1Q: Raport mbi primet dhe dëmet

Ky formular mbledh të dhëna që përdoren për hartimin e statistikave të bilancit të pagesave. Mbledhja e këtij informacioni është e rëndësishme për plotësimin e pasqyrës së bilancit të pagesave, në llogarinë e shërbimeve.

Formulari do të plotësohet vetëm për veprime të kryera midis rezidentëve dhe jorezidentëve. Përkufizimet për kategoritë dhe nënkategoritë e shërbimeve të sigurimit janë në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi aktivitetin e shoqërive të sigurimit. Kërkesa specifike për raportimin e informacionit lidhet me aplikimin korrekt të konceptit të rezidencës së palëve të përfshira në transaksion.

Jorezident: Do të konsiderohet çdo individ, ndërmarrje apo organizatë e vendosur në një vend tjetër jashtë Shqipërisë. Bankat që operojnë në shtete të tjera janë shembuj të jorezidentëve. Personat të cilët nuk jetojnë zakonisht (për një periudhë kohore më shumë se një vit) në Shqipëri janë gjithashtu jorezidentë. Edhe personelet e huaja të vendosura në ambasadat e akredituara në Shqipëri do të konsiderohen jo rezidentë.

St BA 2Q: Raport mbi borxhin nga Jo-Rezidentët

Formulari do të plotësohet vetëm për veprime të kryera mes rezidentëve dhe jorezidentëve.

Në vijim tregohet se çfarë përfshin çdo zë i veçantë i këtij formulari.

1. Numri **identifikues i huasë**. Shënohet numri-kod i përcaktuar paraprakisht për çdo hua.
2. Emri i **huadhënësit**. Subjekti që akordon huanë.
3. **Monedha e huasë/shlyerjes**. Regjistrohet lloji i monedhës në të cilën huaja lëvrohet (disbursohet) dhe lloji i monedhës në të cilën ajo do të shlyhet.
4. **Shuma totale e huasë**. Shënohet shuma totale, për të cilën është angazhuar huadhënësi.
5. **Data e tërheqjes së parë**. Shënohet data e tërheqjes së kështit të parë të huasë.
6. **Data e shlyerjes së plotë**. Shënohet data kur duhet të shlyhet plotësisht huaja.
7. **Borxh i lëvruar pezull (BLP)**. BLP në fillim të periudhës është e barabartë me BLP në fund të periudhës paraardhëse.
8. **Tërheqjet gjatë periudhës**. Regjistrohet shuma e huasë së lëvruar (tërhequr) gjatë periudhës.
9. **Falje borxhi**. Regjistrohet shuma e borxhit të falur.

10. **Principal i maturuar gjatë periudhës.** Regjistrohet shuma e principalit që është maturuar gjatë periudhës.

11. **Principal i shlyer gjatë periudhës.** Regjistrohet shuma e principalit të shlyer gjatë periudhës.

12. **BLP në fund të periudhës** është e barabartë me BLP në fillim të periudhës plus tërheqjet gjatë periudhës, minus shlyerjet e principalit, minus faljet e borxhit. $(12=7+8-9-11)$

13. **Interesi i maturuar gjatë periudhës.** Regjistrohet shuma e interesit të maturuar gjatë periudhës.

14. **Interesi i shlyer gjatë periudhës.** Regjistrohet sasia e interesit të shlyer gjatë periudhës.

15. **Pagesat kumulative të principalit të prapambetur në fillim të periudhës.** Regjistrohen kumulative, nga fillimi i vitit deri në fillim të periudhës, shlyerjet e principalit të prapambetur (që i ka kaluar afati i shlyerjes).

16. **Pagesat kumulative të principalit të prapambetur në fund të periudhës.** Regjistrohen kumulative, nga fillimi i vitit deri në fund të periudhës, shlyerjet e principalit të prapambetur (që i ka kaluar afati i shlyerjes).

17. **Pagesat kumulative të interesit të prapambetur në fillim të periudhës.** Regjistrohen kumulative, nga fillimi i vitit deri në fillim të periudhës, shlyerjet e interesave të prapambetura (që i ka kaluar afati i shlyerjes).

18. **Pagesat kumulative të interesit të prapambetur në fund të periudhës.** Regjistrohen kumulative, nga fillimi i vitit deri në fund të periudhës, shlyerjet e interesave të prapambetura (që i ka kaluar afati i shlyerjes).

St BA 3Q: Raport mbi investimet e huaja direkte

Rezidentë dhe Jo - rezidentë

Jorezidentë: Do të konsiderohet çdo individ, ndërmarrje apo organizatë vendosur në një vend tjetër jashtë Shqipërisë. Degët dhe filialet e kompanive jorezidentë që ndodhen në Shqipëri janë rezidentë. Në mënyrë të ngjashme edhe degët e filialet e kompanive shqiptare në vende të huaja janë jorezidentë.

Ndërmarrje të Investimit të huaj Direkt

Një **investitor direkt** mund të jetë individ ose ndërmarrje që zotërojnë një ndërmarrje investimi direkt me aktivitet në një vend jashtë vendit të rezidencës së investitorit direkt. Një **ndërmarrje investimi direkt** është një person juridik apo person fizik, në të cilën një investitor i huaj direkt ka në pronësi 10% ose më shumë të aksioneve ose të fuqisë votuese të një shoqërie tregtare ose ekuivalentin të një ortakëri.

Edhe ndërmarrjet jorezidentë të lidhura me investitorin direkt konsiderohen si investitorë direkt në kompaninë tuaj. Një kompani mund të ketë me shumë se një investitor direkt, dhe këta mund ta kenë rezidencën në vende të ndryshme.

Konsiderohen Ndërmarrje të Investimit të Huaj Direkt dhe janë subjekt i raportimit të këtij formulari të gjithë rezidentët që janë:

- Shoqëri tregtare ekzistuese në të cilën një jorezident ka blerë pjesë kapitali nga pronari i mëparshëm ose ka rikapitalizuar atë;
- Shoqëri simotra, filiale ose degë të ndërmarrjeve jorezidente të themeluara nga ndërmarrje të huaja¹⁵;
- Institucione apo fondacione në të cilat persona të huaj fizikë apo juridik kanë pjesën e tyre të influencës në vendim marrje.

Jorezidentë të tjerë janë ata jorezidentë të lidhur me ndërmarrjen që nuk janë investitorë direkt ose ndërmarrje investimi direkt.

Vlerësimi

Ju lutemi konvertoni shumat e shprehura në monedha të huaja në Lekë.

Transaksionet financiare dhe të ardhurat e shprehura në monedhë të huaj duhet të konvertohen në Lekë duke përdorur kursin mesatar të këmbimit për periudhën e raportimit. Ndërsa për vlerësimin e gjendjeve dhe pozicioneve të llogarive financiare të shprehura në monedhë të huaj, për konvertimin në Lekë duhet të përdoret kursi zyrtar i ditës së fundit të periudhës së referencës.

Struktura e formularit

Në rubrikën e parë kërkohet informacion mbi përbërjen dhe origjinën e kapitalit.

Rubrika e dytë, përmban informacion financiar të marrë nga pasqyra e bilancit kontabël të fundvitit.

Rreshti 1. Vlera totale e kapitalit: plotësohet vlera totale e kapitalit të ndërmarrjes në 31.12 të vitit që raportohet. Vlera e paraqitur në këtë rresht është shume e rreshtave 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11.

Rreshti 2. Kapitali i nënshkruar: raportohet vlera e kapitalit të investuar, sipas nënshkrimit të kapitalit në institucionet përkatëse.

¹⁵ Një filial është në vetvete një shoqëri tregtare në të cilën investitori i huaj kontrollon direkt ose indirekt (nëpërmjet një tjetër filiali), më shumë se 50% të fuqisë votuese në aksione. Një shoqëri simotra, është një kompani në të cilën investitori direkt dhe filialet e tij kontrollojnë ndërmjet 10-50% të fuqisë votuese. Një degë (shoqëritë e kontrolluara) është një kompani me pronësi totale ose bashkërisht të huaj.

Rreshti 3. Kapitali i paguar: raportohet vlera aktualisht e paguar e investimit, e cila mund të jetë e barabartë ose më e vogël sesa vlera e kapitalit të nënshkruar. Kapitali i paguar mund të jetë në cash, mallra, si edhe në rritje kapitali nga fondet e ndërmarrjes.

Rreshti 4. Kapitali i papaguar: raportohet vlera e papaguar e kapitalit të nënshkruar, në rastet kur totali i kapitalit të nënshkruar nuk është paguar deri në 31.12 i vitit të raportimit.

Rreshti 5. Shtesat e kapitalit: raportohet diferenca e vlerës nominale të aksioneve dhe asaj të tregut.

Rreshti 6. Rezervat: Raportohet vlera e fitimit neto nga viti aktual ose i kaluar, që mbahet në formë rezervash të detyruara apo rezervash të tjera sipas vendimit të bordit drejtues të ndërmarrjes

Rreshti 7. Fitimi i mbartur nga periudhat e mëparshme: raportohet vlera e fitimit neto nga vitet e mëparshme që ka mbetur i pashpërndarë dhe nuk është shpenzuar në asnjë mënyrë deri në 31.12 të vitit të raportimit.

Rreshti 8. Humbja e mbartur nga periudhat e mëparshme: raportohet humbja e periudhave të mëparshme që ka mbetur e pambuluar (me shenjë minus).

Rreshti 9. Rivlerësime të kapitalit: raportohet vlera totale e rivlerësimit të të gjithë zërave të kapitalit.

Rreshti 10. Fitimi neto i ushtrimit: raportohet vlera totale të fitimit neto të periudhës.

Rreshti 11. Humbja neto e ushtrimit: raportohet vlera totale e humbjes neto të pambuluar të periudhës (me shenjë minus).

Në **rubrikën e tretë** raportohet mbi shpërndarjen e dividendit.

Fitimi i shpërndarë në formë dividendësh si total përfshin shumën totale të të ardhurave që shpërndahet tek të gjithë pronarët (dhe jo vetëm ata të huaj) të kategorizuar sipas pronarëve. Si investitorë jorezidentë të tjerë konsiderohen ata investitorë jorezidentë që kanë pjesë në kapitalin e ndërmarrjes, por kjo pjesë është më e vogël se 10 për qind.

Në **rubrikën e fundit** raportohet në lidhje me stokun e pretendimeve dhe detyrimeve ndaj kompanive të ndërlidhura, jorezidentëve të tjerë dhe rezidentëve. Kompanitë e ndërlidhura mund të jenë degët, shoqëriamëmë, apo filialet. Jorezidentë të tjerë mund të jenë partnerë biznesi, si klientë apo furnitorë jorezidentë. Ndërsa pretendimet apo detyrimet me rezidentë përfaqësojnë kategorinë e gjithë partnerëve të tjerë brenda Shqipërisë (dhe rezidentë të saj). Pretendimet dhe detyrimet përfshijnë: hua afatshkurtra, afatmesme apo afatgjata, kredi tregtare, depozita, garanci apo qera financiare.

ST 3Q: Sigurimi individual i Pensionit Vullnetar Suplementar

Kjo pasqyrë plotësohet nga shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin në sigurimin e Jetës.

Personat e siguruar të përfshirë në skemën e pensionit

Këtu do të jepet informacioni lidhur me numrin total të personave të cilët janë të përfshirë në skemën e pensionit në datën e raportimit të informacionit.

Këto persona mund të jenë pjesëmarrës aktivë në skemë (punojnë ende ose kontribuojnë, pra janë duke akumuluar contribute/përfitime në mënyrë aktive) ose pasivë (kanë dalë në pension, dhe tërheqin kontributet/përfitimet nga skema), ose pezull (janë tërhequr nga skema dhe kanë të drejta të pezulluara deri në plotësimin e kushteve të kontratës.

Personat e siguruar pezull

Anëtarë të cilët janë tërhequr nga skema dhe kanë të drejta të pezulluara deri në plotësimin e kushteve të kontratës (mosha, kohëzgjatja, etj.)

Personat e siguruar që u ka lindur e drejta e përfitimit

Anëtarë të skemës të cilëve u ka lindur e drejta të tërheqin kontributet/përfitimet nga skema e pensionit.

Numri në datën e fundit të periudhës

Numri i anëtarëve në fund të periudhës së raportimit.

Masa e kontributeve / përfitimeve nga fillimi i vitit deri në fund të periudhës

Vlera monetare në ALL e kontributeve/përfitimeve të akumuluar nga anëtarët nga fillimi i vitit deri në fund të periudhës së raportimit.

Masa e grumbulluar e kontributeve/përfitimeve

Vlera monetare në ALL e totalit të kontributeve/përfitimeve të akumuluar nga anëtarët e skemës deri në fund të periudhës së raportimit.

Provizjonet matematike në datën e fundit të periudhës

Vlera monetare në ALL e provizjoneve matematike që krijohen nga shoqëria e sigurimit që ushtron veprimtari në sigurimin e jetës në favor të përfituesve të skemës së pensionit të përlogaritura në datën e fundit të periudhës.

ST 4Q: Sigurimi kolektiv i Pensionit Vullnetar Suplementar

Kjo pasqyrë plotësohet nga shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin në sigurimin e Jetës.

Personat e siguruar të përfshirë në skemën e pensionit

Këtu do të jepet informacioni lidhur me numrin total të personave të cilët janë të përfshirë në skemën e pensionit në datën e raportimit të informacionit.

Këto persona mund të jenë pjesëmarrës aktivë në skemë (punojnë ende ose kontribuojnë, pra

janë duke akumuluar kontribute/përfitime në mënyrë aktive) ose pasivë (kanë dalë në pension, dhe tërheqin kontributet/përfitimet nga skema), ose pezull (janë tërhequr nga skema dhe kanë të drejta të pezulluara deri në plotësimin e kushteve të kontratës.

Personat e siguruar pezull

Anëtarë të cilët janë tërhequr nga skema dhe kanë të drejta të pezulluara deri në plotësimin e kushteve të kontratës (mosha, kohëzgjatja, etj.)

Personat e siguruar që u ka lindur e drejta e përfitimit

Anëtarë të skemës të cilëve u ka lindur e drejta të tërheqin kontributet/përfitimet nga skema e pensionit.

Punëdhënësit e përfshirë në skemat e pensionit

Këtu do të jepet informacioni lidhur me totalin e numrit të punëdhënësve të përfshirë në skemë.

Nga të cilët: Punëdhënësit që nuk kanë paguar primet

Këtu do të jepet informacioni lidhur me totalin e numrit të punëdhënësve të përfshirë në skemë të cilët nuk kanë paguar primet e sigurimit.

Numri i personave të siguruar

Këtu do të jepet informacioni lidhur me totalin e numrit të punëdhënësve të përfshirë në skemë të cilët janë:

- Me të drejta të përfituara

Anëtarë të skemës të cilëve u ka lindur e drejta të tërheqin kontributet/përfitimet nga skema e pensionit.

- Të tjerë

Anëtarë pasivë në skemë (kanë dalë në pension, dhe tërheqin kontributet/përfitimet nga skema), ose pezull (janë tërhequr nga skema dhe kanë të drejta të pezulluara deri në plotësimin e kushteve të kontratës.

Numri në datën e fundit të periudhës

Numri i anëtarëve në fund të periudhës së raportimit.

Masa e kontributeve / përfitimeve nga fillimi i vitit deri në fund të periudhës

Vlera monetare në ALL e kontributeve/përfitimeve të akumuluar nga anëtarët nga fillimi i vitit deri në fund të periudhës së raportimit.

Masa e grumbulluar e kontributeve/përfitimeve

Vlera monetare në ALL e totalit të kontributeve/përfitimeve të akumuluar nga anëtarët e

skemës deri në fund të periudhës së raportimit.

Provigjonet matematike në datën e fundit të periudhës

Vlera monetare në ALL e provigjoneve matematike që krijohen nga shoqëria e sigurimit që ushtron veprimtari në sigurimin e Jetës në favor të përfituesve të skemës së pensionit të përlogaritura në datën e fundit të periudhës.

ANEKS 5

Forma, përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të statistikave mujore.

ER: Kurset e Këmbimit

Këtu përdoret kursi i konvertimit që duhet përdorur tek pasqyrat statistikore mujore në vijim dhe është njëkohësisht kursi mesatar i periudhës sipas Bankës së Shqipërisë.

St 1M: Primet, Jo-Jetë

Kontrata sigurimi të paguara

Kolona “Produkti i sigurimit” paraqet : produktin e sigurimit për të cilat kjo formë do të plotësohet.

Produktet e Sigurimit të Jo-Jetës sipas klasave dhe emërtimeve:

01 Sigurimi i aksidenteve

- a. Sigurimi i personave ndaj aksidenteve të ndodhura në punë ose jashtë saj.
- b. Sigurimi i personave ndaj aksidenteve nga automjetet motorike dhe profesione të veçanta.
- c. Sigurimi i fëmijëve dhe nxënësve ndaj aksidenteve dhe sigurime të veçanta për të rinjtë.
- d. Sigurimi i vizitorëve dhe turistëve nga pasojat e aksidenteve në udhëtim.
- e. Sigurimi i detyrueshëm i udhëtarëve në transportin publik nga pasojat e aksidentit.
- f. Sigurime të tjera nga pasojat e aksidentit.

Në formën ST 1M, kjo klasë i korrespondon emërtimeve A1 dhe A3. Tek emërtimi A3 rregjistrohen produktet e kombinuara të aksidenteve dhe shëndetit të ndryshme nga klasa 2.

2 Sigurimi i sëmundjeve

- a. Sigurimi shëndetësor privat.
- b. Llojet e tjera vullnetare të sigurimit shëndetësor.

Në formën ST 1M, kjo klasë i korrespondon emërtimeve A2.

3 Sigurimi i mjeteve tokësore (të ndryshme nga ato që lëvizin mbi shina)

- a. Sigurimi KASKO i mjeteve motorike
- b. Sigurimi KASKO i mjeteve tokësore, të tjera përveç mjeteve motorike.

c. Llojet e tjera të sigurimit KASKO.

Në formën ST 1M, kjo klasë i korrespondon emërimit B1.

4 Sigurimi i mjeteve lëvizëse mbi shina

a. Sigurimi kasko i mjeteve lëvizëse hekurudhore.

Në formën ST 1M, kjo klasë i korrespondon emërimit L.

5 Sigurimi i avionëve

a. Sigurim kasko për avionë dhe mjete fluturuese.

b. Sigurim ajror, i ndryshëm nga pika a.

Në formën ST 1M, kjo klasë i korrespondon emërimit D1.

6 Sigurimi i anijeve (në det, liqen dhe lumenj)

a. Sigurimi kasko për anijet, jahte dhe mjete transporti detare.

b. Sigurimi kasko për anijet dhe mjetet e tjera të lundrimit në lumë.

c. Sigurimi kasko për anijet dhe mjetet e tjera të lundrimit në liqen.

d. Sigurimi kasko për anijet në ndërtim.

e. Sigurimi kasko i platformave.

f. Llojet e tjera të sigurimit kasko në det, liqen dhe lumenj.

Në formën ST 1M, kjo klasë i korrespondon emërimit C1.

7 Sigurimi i mallrave në transport

a. Sigurimi i mallrave të transportit detar.

b. Sigurimi i mallrave të transportit ajror.

- c. Sigurimi i mallrave të transportit tokësor.
- d. Sigurimi i mallrave të transportit në magazinim.
- e. Llojet e tjera të sigurimeve të mallrave në transport.

Në formën ST 1M, kjo klasë i korrespondon emërimit F.

8 Sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës

- a. Sigurimi nga zjarri.
- b. Sigurimi nga zjarri në industri dhe vepra artizanale.
- c. Sigurimi nga zjarri dhe forcat e tjera natyrore.

Në formën ST 1M, kjo klasë i korrespondon emërimit E1.

9 Sigurimi i dëmtimeve të tjera të pronës

- a. Sigurimi i makinerive.
- b. Sigurim nga vjedhja.
- c. Sigurimi i objekteve të ndërtimit (CAR)
- d. Sigurimit nga ngritja e makinerive (EAR)
- e. Sigurimi i mallrave në miniera
- f. Sigurimi kompjuterik
- g. Sigurimi i mallrave në frigoriferë rimorkio, etj.
- h. Sigurim agrokulture dhe i plantacioneve.
- i. Sigurim i gjësë së gjallë.
- j. Dëme të tjera të pronës

Në formën ST 1M, kjo klasë i korrespondon emërimit E2, E3, E4 dhe G.

10 Sigurimi i përgjegjësive civile nga përdorimi i automjeteve

Sigurimi i përgjegjësive civile nga përdorimi i mjeteve motorike sipas legjislacionit në fuqi.

Në formën ST 1M, kjo klasë i korrespondon emërimit B2, B3 dhe B4.

11 Sigurimi i përgjegjësive civile nga përdorimi i avionëve

Sigurimi i përgjegjësive civile së aviacionit sipas legjislacionit në fuqi.

Në formën ST 1M, kjo klasë i korrespondon emërtimit D2.

12 Sigurimi i përgjegjësive civile për anijet

Sigurimi i përgjegjësive civile të marinës sipas legjislacionit në fuqi.

Në formën ST 1M, kjo klasë i korrespondon emërtimit C2.

13 Sigurimi i përgjegjësive civile të përgjithshme

- a. Sigurimi i përgjegjësive kontraktuale.
- b. Sigurimi i përgjegjësive të prodhuesve për produktet.
- c. Sigurim i përgjegjësive të transportit hekurudhor.
- d. Sigurimi i garancisë për prodhuesit, shitësit dhe furnizuesit.
- e. Sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme.
- f. Sigurimi i përgjegjësive për projekte nga kompanitë inxhinierike dhe kompani të tjera.
- g. Sigurimi përgjegjësie për projekte nga kompanitë inxhinierike dhe kompani të tjera, për dëmet e shkaktuara për shkak të pasaktësisë së dokumentacionit teknik.
- h. Sigurimi i përgjegjësive së noterit.
- i. Sigurim i përgjegjësive për pronarin ose shfrytëzuesin e mjeteve detare.
- j. Sigurim i përgjegjësive për riparimin e anijeve.
- k. Sigurimi i përgjegjësive profesionale të agjentit në sigurime.
- l. Sigurimi i detyrueshëm për përgjegjësinë e organizatorit të paketës së udhëtimit.
- m. Sigurimi i përgjegjësive profesionale të brokerit.
- n. Llojet e tjera të sigurimit të përgjegjësive së përgjithshme.

Në formën ST 1M, kjo klasë i korrespondon emërtimit H.

14 Sigurimi i kreditit

- a. Sigurimi i humbjes së aftësisë paguese.
- b. Sigurimi i kredisë së eksportit.
- c. Sigurimi i kredisë Lombard.
- d. Sigurimi i kredisë hipotekore.
- e. Sigurimi i kredisë bujqësore.
- f. Të tjera.

Në formën ST 1M, kjo klasë i korrespondon emërimit I.

15 Sigurimi i garancive

- a. I drejtpërdrejtë
- b. I tërthortë

Shënim : I drejtpërdrejtë: Risku i humbjes së të siguarit, si rrjedhojë e zbatimit të kontratave të garancisë, në të cilat ka hyrë. Risqet kryesore janë kontratat e performancës apo garancitë.

I tërthortë: Garancitë për palë të treta, ku risqet kryesore janë si p.sh.: oferta ose tenderim, sigurim ndaj akteve mashtroese, etj.

Në formën ST 1M, kjo klasë i korrespondon emërimit J.

16 Sigurimi i humbjes financiare

- a. Sigurimi ndaj humbjeve financiare nga ndërprerja e punës për shkak të zjarrit dhe rezeqeve të tjera.
- b. Sigurimi ndaj humbjeve financiare nga ndërprerja e punës për shkak të prishjes së makinerive.
- c. Sigurim ndaj motit.
- d. Llojet e tjera të sigurimeve të humbjeve financiare.

Në formën ST 1M, kjo klasë i korrespondon emërimit M.

17 Sigurimi i mbrojtjes ligjore

- a. Shpenzimet ligjore dhe shpenzimet e sigurimit.

Në formën ST 1M, kjo klasë i korrespondon emërimit K.

18 Sigurimi i asistencës (ndihmës)

- b. Sigurim i turistit.
- c. Sigurim për anulim të udhëtimit turistik.
- d. Sigurim për risqe të tjera të turistëve.

Në formën ST 1M, kjo klasë i korrespondon emërimit K.

Kolona “Total në lekë” përfaqëson : totalin e konvertuar në lekë të kolonave ALL, EURO,USD.

Shënim: Kursi i konvertimit që duhet përdorur tek kolona "Total" është kursi mesatar i periudhës sipas Bankës së Shqipërisë.

Kolona “Prime të shkruara bruto” përfaqëson : primin e faturuar (ose për tu faturuar) për një policë apo grup policash.

Shënim: Primi i shkruar bruto duhet të deklarohet në valutat në të cilat ai është mbajtur. Në rastet kur valuta është e ndryshme nga euro apo dollari amerikan, valuta konvertohet në lekë dhe paraqitet tek kolona në lekë.

Kolonat e Valutave ALL, EURO, USD paraqet: primin e shkruar bruto në valutat në të cilën është mbajtur.

Kolona “Numri i policave” paraqet: numrin e kontratave të sigurimit.

Kolona “Numri i të siguruarve” paraqet: numrin e personave të siguruar.

Kontrata sigurimi të anuluar

Kolona “Produkti i sigurimit” paraqet: produktin e sigurimit për të cilat kjo formë do të plotësohet.

Produktet janë specifikuar sipas klasave tek pasqyra St 1M primi i shkruar bruto, jo-jeta.

Kolona “Total në lekë” përfaqëson : totalin e konvertuar në lekë të kolonave ALL, EURO,USD.

Shënim: Kursi i konvertimit që duhet përdorur tek kolona "Total" është kursi mesatar i periudhës sipas Bankës së Shqipërisë.

Kolona “Prime të shkruara bruto” përfaqëson: primin e kthyer për një policë apo grup policash.

Shënim: Primi i anuluar duhet të deklarohet në valutat në të cilat ai është kthyer. Në rastet kur valuta është e ndryshme nga euro apo dollari amerikan, valuta konvertohet në lekë dhe paraqitet tek kolona në lekë.

Kolonat e Valutave ALL, EURO, USD paraqet: primin e anuluar në valutat në të cilën është mbajtur.

Kolona “Numri i policave” paraqet: numrin e kontratave të sigurimit të anuluar.

Kolona “Numri i të siguruarve” paraqet: numrin e personave të siguruar që anulojnë kontratën.

Diferenca midis pasqyrave ‘Kontrata sigurimi të paguara’ me ‘Kontrata sigurimi të anuluar’, duhet të japë vlerën e saktë të primeve të shkruara bruto, numrit të të siguruarve dhe kontratave të lidhura për periudhën në fjalë.

St 2M: Primet, Jeta

Kontrata sigurimi të paguara

Kjo tabelë plotësohet mbi bazë produkti sipas emërtimeve përkatëse në tabelë.

Kolona “Total në lekë” përfaqëson: totalin e konvertuar në lekë të kollonave ALL, EURO,USD.

Shënim: Kursi i konvertimit që duhet përdorur tek kolona “Total” është kursi mesatar i periudhës sipas Bankës së Shqipërisë.

Kolona “Prime të shkruara bruto” përfaqëson: primin e faturuar (ose për tu faturuar) për një policë apo grup policash.

Shënim: Primi i shkruar bruto duhet të deklarohet në valutat në të cilat ai është mbajtur. Në rastet kur valuta është e ndryshme nga euro apo dollari amerikan, valuta konvertohet në lekë dhe paraqitet tek kollona në lekë.

Kolonat e Valutave ALL, EURO, USD paraqet: primin e shkruar bruto në valutat në të cilën është mbajtur.

Kolona “Numri i policave” paraqet: numrin e kontratave të sigurimit.

Kolona “Numri i të siguruarve” paraqet: numrin e personave të siguruar.

Kontrata sigurimi të anuluar

Kolona “Produkti i sigurimit” paraqet: produktin e sigurimit për të cilat kjo formë do të plotësohet.

Kolona “Total në lekë” përfaqëson: totalin e konvertuar në lekë të kolonave ALL, EURO,USD.

Shënim: Kursi i konvertimit që duhet përdorur tek kolona "Total" është kursi mesatar i periudhës sipas Bankës së Shqipërisë.

Kolona “Prime të shkruara bruto” përfaqëson : primin e kthyer për një policë apo grup policash.

Shënim: Primi i anuluar duhet të deklarohet në valutat në të cilat ai është kthyer. Në rastet kur valuta është e ndryshme nga euro apo dollari amerikan, valuta konvertohet në lekë dhe paraqitet tek kolona në lekë.

Kolonat e Valutave ALL, EURO, USD paraqet: primin anuluar në valutat në të cilën është mbajtur.

Kolona “Numri i policave” paraqet : numrin e kontratave të sigurimit të anuluar.

Kolona “Numri i të siguruarve” paraqet: numrin e personave të siguruar që anulojnë kontratën.

St 3M: Dëmet, Jo-Jeta

Dëme të paguara

Kolona “Produkti i sigurimit” paraqet: produktin e sigurimit për të cilat kjo formë do të plotësohet.

Produktet janë specifikuar sipas klasave tek pasqyra St 1M, Jo-Jeta .

Kolona “Total në lekë” përfaqëson: totalin e konvertuar në lekë të kolonave ALL, EURO,USD.

Shënim: Kursi i konvertimit që duhet përdorur tek kolona "Total" është kursi mesatar i periudhës sipas Bankës së Shqipërisë.

Kolona “Vlera e dëmeve të paguara” paraqet: vlerën e dëmeve të paguara gjatë periudhës.

Shënim : Dëmet e paguara duhet të deklarohen në valutat në të cilat ato janë të paguar. Në rastet kur valuta është e ndryshme nga euro apo dollari amerikan, valuta konvertohet në lekë dhe paraqitet tek kolona në lekë.

Kolonat – Valutave ALL, EURO, USD paraqet: vlerën e dëmet të paguara në valutat në të cilën është paguar.

Kolona “Numri i dëmeve” paraqet: numrin e dëmeve të paguara.

Kolona “Pjesa e risiguruesit” paraqet: shumën e paguar nga risiguruesi gjatë periudhës:

Dëme pezull

Kolona “Produkti i sigurimit” paraqet: produktin e sigurimit për të cilat kjo formë do të plotësohet.

Produktet janë specifikuar sipas klasave tek pasqyra St 1M, Jo-Jeta .

Kolona “Total në lekë” përfaqëson: totalin e konvertuar në lekë të kolonave ALL, EURO,USD.

Shënim: Kursi i konvertimit që duhet përdorur tek kolona "Total" është kursi mesatar i periudhës sipas Bankës së Shqipërisë.

Kolona “Vlera e dëmeve pezull ”paraqet: shumën e dëmeve pezull gjatë periudhës.

Shënim : Dëmet pezull duhet të deklarohen në valutat në të cilat ato do të paguhen. Në rastet kur valuta është e ndryshme nga euro apo dollari amerikan, valuta konvertohet në lekë dhe paraqitet tek kolona në lekë.

Kolonat – Valutave ALL, EURO, USD paraqet: vlerën e dëmet pezull në valutat në të cilën do të paguhen.

Kolona “Numri i dëmeve” paraqet: numrin e dëmeve pezull.

Kolona “Pjesa e risiguruesit” paraqet: shumën e dëmeve pezull nga risiguruesi gjatë periudhës.

St 4M: Dëmet, Jeta

Dëme të paguara

Kolona “Produkti i sigurimit” paraqet: produktin e sigurimit për të cilat kjo formë do të plotësohet.

Produktet janë specifikuar sipas klasave tek pasqyra St 2M, Jeta.

Kolona “Total në lekë” përfaqëson: totalin e konvertuar në lekë të kolonave ALL, EURO,USD.

Shënim: Kursi i konvertimit që duhet përdorur tek kolona "Total" është kursi mesatar i periudhës sipas Bankës së Shqipërisë.

Kolona “Vlera e dëmeve të paguara” paraqet: shumën e dëmeve të paguara gjatë periudhës.

Shënim : Dëmet e paguara duhet të deklarohen në valutat në të cilat ato janë të paguar. Në rastet kur valuta është e ndryshme nga euro apo dollari amerikan, valuta konvertohet në lekë dhe paraqitet tek kolona në lekë.

Kolonat – Valutave ALL, EURO, USD paraqet: vlerën e dëmet të paguara në valutat në të cilën është paguar.

Kolona “Numri i dëmeve” paraqet : numrin e dëmeve të paguara.

Kolona “Pjesa e risiguruesit” paraqet: shumën e paguar nga risiguruesi gjatë periudhës.

Dëme pezull

Kolona “Produkti i sigurimit” paraqet: produktin e sigurimit për të cilat kjo formë do të plotësohet.

Produktet janë specifikuar sipas klasave tek pasqyra St 2M, Jeta .

Kolona “Total në lekë” përfaqëson: totalin e konvertuar në lekë të kolonave ALL, EURO,USD

Shënim: Kursi i konvertimit që duhet përdorur tek kolona "Total" është kursi mesatar i periudhës sipas Bankës së Shqipërisë.

Kolona “Vlera e dëmeve pezull ”paraqet: shumën e dëmeve pezull gjatë periudhës.

Shënim : Dëmet pezull duhet të deklarohen në valutat në të cilat ato do të paguhen .

Kolonat – Valutave ALL, EURO, USD paraqet: vlerën e dëmet pezull në valutat në të cilën do të paguhen.

Kolona “Numri i dëmeve” paraqet: numrin e dëmeve pezull.

Kolona “Pjesa e risiguruesit” paraqet: shumën e dëmeve pezull nga risiguruesi gjatë periudhës.

St 1R M: Risigurim i pranuar: Primet, Jo-Jeta

Kjo formë plotësohet vetëm për risigurimin e pranuar.

Kolona “Produkti i sigurimit” paraqet: produktin e sigurimit për të cilat kjo formë do të plotësohet.

Produktet janë specifikuar sipas klasave tek pasqyra St 1M, Jo-Jeta.

Kolona “Total në lekë” përfaqëson: totalin e konvertuar në lekë të kolonave ALL, EURO,USD

Shënim: Kursi i konvertimit që duhet përdorur tek kolona "Total" është kursi mesatar i periudhës sipas Bankës së Shqipërisë.

Kolona “Prime të shkruara bruto” përfaqëson: primin e faturuar nga shoqëria e risigurimit (ose për tu faturuar) për një policë apo grup policash.

Shënim: Primi i shkruar bruto duhet të deklarohet në valutat në të cilat ai është mbajtur. Në rastet kur valuta është e ndryshme nga euro apo dollari amerikan, valuta konvertohet në lekë dhe paraqitet tek kolona në lekë.

Kolonat e Valutave ALL, EURO, USD paraqet: primin e shkruar bruto në valutat në të cilën është mbajtur.

Kolona “Numri i policave” paraqet: numrin e kontratave të sigurimit.

Kolona “Numri i të sigurve” paraqet: numrin e personave të siguruar.

St 2R M: Risigurim i pranuar: Primet, Jeta

Kjo formë plotësohet vetëm për risigurimin e pranuar.

Kolona “Produkti i sigurimit” paraqet: produktin e sigurimit për të cilat kjo formë do të plotësohet.

Produktet janë specifikuar sipas klasave tek pasqyra St 2M, Jeta.

Kolona “Total në lekë” përfaqëson: totalin e konvertuar në lekë të kolonave ALL, EURO,USD

Shënim: Kursi i konvertimit që duhet përdorur tek kolona “Total” është kursi mesatar i periudhës sipas Bankës së Shqipërisë.

Kolona “Prime të shkruara bruto” përfaqëson: primin e faturuar nga shoqëria e risigurimit (ose për tu faturuar) për një policë apo grup policash.

Shënim: Primi i shkruar bruto duhet të deklarohet në valutat në të cilat ai është mbajtur. Në rastet kur valuta është e ndryshme nga euro apo dollari amerikan, valuta konvertohet në lekë dhe paraqitet tek kolona në lekë.

Kolonat e Valutave ALL, EURO, USD paraqet: primin e shkruar bruto në valutat në të cilën është mbajtur.

Kolona “Numri i policave” paraqet: numrin e kontratave të sigurimit.

Kolona “Numri i të sigurve” paraqet: numrin e personave të siguruar.

St 3R M: Risigurim i pranuar: Dëmet, Jo-Jeta

Kjo formë plotësohet vetëm për risigurimin e pranuar.

Kolona “Produkti i sigurimit” paraqet: produktin e sigurimit për të cilat kjo formë do të plotësohet.

Produktet janë specifikuar sipas klasave tek pasqyra St 1M, Jo-Jeta.

Kolona “Total në lekë” përfaqëson: totalin e konvertuar në lekë të kolonave ALL, EURO,USD.

Shënim: Kursi i konvertimit që duhet përdorur tek kolona "Total" është kursi mesatar i periudhës sipas Bankës së Shqipërisë.

Kolona “Vlera e dëmeve të paguara” paraqet: shumën e dëmeve të paguara gjatë periudhës.

Shënim: Dëmet e paguara duhet të deklarohen në valutat në të cilat ato janë të paguar. Në rastet kur valuta është e ndryshme nga euro apo dollari amerikan, valuta konvertohet në lekë dhe paraqitet tek kolona në lekë.

Kolonat – Valutave ALL, EURO, USD paraqet : vlerën e dëmet të paguara në valutat në të cilën është paguar.

Kolona “Numri i dëmeve” paraqet: numrin e dëmeve të paguara.

Kolona “Pjesa e risiguruesit” paraqet: shumën e paguar nga risiguruesi gjatë periudhës:

Kolona “Pjesa e retrocesionarit në dëmet e paguara” paraqet: shumën e paguar nga risiguruesi për risiguruesin gjatë periudhës.

St 4R M: Risigurim i pranuar: Dëmet, Jeta

Kjo formë plotësohet vetëm për risigurimin e pranuar.

Kolona “Produkti i sigurimit” paraqet: produktin e sigurimit për të cilat kjo formë do të plotësohet.

Produktet janë specifikuar sipas klasave tek pasqyra St 4M, Jo-Jeta.

Kolona “Total në lekë” përfaqëson: totalin e konvertuar në lekë të kolonave ALL, EURO,USD.

Shënim: Kursi i konvertimit që duhet përdorur tek kolona "Total" është kursi mesatar i periudhës sipas Bankës së Shqipërisë.

Kolona “Vlera e dëmeve të paguara” paraqet: shumën e dëmeve të paguara gjatë periudhës.

Shënim: Dëmet e paguara duhet të deklarohen në valutat në të cilat ato janë të paguar. Në rastet kur valuta është e ndryshme nga euro apo dollari amerikan, valuta konvertohet në lekë dhe paraqitet tek kolona në lekë.

Kolonat – Valutave ALL, EURO, USD paraqet: vlerën e dëmet të paguara në valutat në të cilën është paguar.

Kolona “Numri i dëmeve” paraqet: numrin e dëmeve të paguara.

Kolona “Pjesa e risiguruesit” paraqet: shumën e paguar nga risiguruesi gjatë periudhës:

Kolona “Pjesa e retrocesionarit në dëmet e paguara” paraqet: shumën e paguar nga risiguruesi për risiguruesin gjatë periudhës.

ANEKS 6

Forma, përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të statistikave vjetore.

ST 2A: Trekëndëshat e dëmeve në sigurimet motorike

Trekëndëshat e dëmeve në sigurimet motorike plotësohen për produktet e sigurimit: MTPL e brendshme, Karton Jeshil dhe Kasko.

Shoqëria e sigurimit selekton `po` për vitet kur është i zbatueshëm plotësimi i formës dhe `jo` në rast të kundërt.

Viti i aksidentit nënkupton mbledhjen e të dhënave në bazë të vitit të ndodhjes së dëmeve ose në bazë të vitit të raportimit të dëmeve. Ndërsa numri i viteve i zhvillimit të një dëmi do të quhet vit i zhvillimit.

Vlerësimi i dëmeve pezull në fund të vitit financiar lidhet me vlerësimin e bërë nga ekspertët e vlerësimit të dëmeve të shoqërisë së sigurimit bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara.

Monedha që duhet përdorur në plotësimin e kësaj forme duhet të jetë Lekë.

G 1A: Shpërndarja gjeografike e primeve të Jo-Jetës

Kjo formë plotësohet për secilën prefekturë sipas emërimit dhe i korrespondon specifikimeve të produkteve si tek pasqyra St 1M, Jo-Jeta.

Kolona “Produkti i sigurimit” paraqet: produktin e sigurimit për të cilat kjo formë do të plotësohet.

Kolona “Total në lekë” përfaqëson: totalin vjetor të primeve të shkruara bruto sipas prefekturës, kjo kolonë është totali i konvertuar në lekë i valutave ALL, EURO,USD.

Shënim: Vlera “Total në lekë” duhet të korrespondojë me vlerën progresive vjetore të statistikave mujore të raportuara sipas pasqyrave St 1 M.

G 2A: Shpërndarja gjeografike e primeve të Jetës

Kjo formë plotësohet për secilën prefekturë sipas emërimit dhe i korrespondon specifikimeve të produkteve si tek pasqyra St 2M, Jeta.

Kolona “Produkti i sigurimit” paraqet: produktin e sigurimit për të cilat kjo formë do të plotësohet.

Kolona “Total në lekë” përfaqëson: totalin vjetor të primeve të shkruara bruto sipas prefekturës, kjo kolonë është totali i konvertuar në lekë i valutave ALL, EURO,USD.

Shënim: Vlera “Total në lekë” duhet të korrespondojë me vlerën progresive vjetore të statistikave mujore të raportuara sipas pasqyrave St 2 M.

G 3A: Shpërndarja gjeografike e dëmeve të Jo-Jetës

Kjo formë plotësohet për secilën prefekturë sipas emërimit dhe i korrespondon specifikimeve të produkteve si tek pasqyra St 1M, Jo-Jeta.

Kolona “Produkti i sigurimit” paraqet: produktin e sigurimit për të cilat kjo formë do të plotësohet.

Kolona “Total në lekë” përfaqëson: totalin vjetor i dëmeve të paguara sipas prefekturës , kjo kolonë është totali i konvertuar në lekë i valutave ALL, EURO,USD.

Shënim: Vlera “Total në lekë” duhet të korrespondojë me vlerën progresive vjetore të statistikave mujore të raportuara sipas pasqyrave St 1 M.

G 4A: Shpërndarja gjeografike e dëmeve të Jetës

Kjo formë plotësohet për secilën prefekturë sipas emërimit dhe i korrespondon specifikimeve të produkteve si tek pasqyra St 2M, Jeta.

Kolona “Produkti i sigurimit” paraqet: produktin e sigurimit për të cilat kjo formë do të plotësohet.

Kolona “Total në lekë” përfaqëson: totalin vjetor i dëmeve të paguara sipas prefekturës , kjo kolonë është totali i konvertuar në lekë valutave i ALL, EURO,USD.

Shënim: Vlera “Total në lekë” duhet të korrespondojë me vlerën progresive vjetore të statistikave mujore të raportuara sipas pasqyrave St 2 M.

Shënim i përgjithshëm për pasqyrat G1 A, G2 A, G3 A, G4 A: Vlerat në kolonën e konvertimit në pasqyrat më sipër duhet të shprehen në Lekë. Kursi i konvertimit që duhet përdorur tek kolona "Total" është kursi vjetor i ponderuar sipas kurseve mujore mesatare zyrtare sipas B.SH., të cilat janë përdorur në plotësimin e statistikave mujore. Kursi i përfutur del si rezultat i shumës së prodhimeve të kurseve mesatare mujore me peshën specifike të të ardhurave (apo dëmeve) në muajin përkatës ndaj totalit vjetor. Ky kurs është vetëm për shpërndarjen gjeografike të primeve dhe dëmeve me qëllim shmangien e diferencave nga kursi i këmbimit, pasi shpërndarja gjeografike në total duhet të korrespondojë me vlerat e pasqyrave progresive mujore statistikore.

ST 5Q: Kufijtë e mbajtjes

Në këtë formë shoqëria e sigurimit, përcakton sipas produktit të sigurimit, për çdo klasë sigurimi, vlerën e mbajtjes maksimale për rrezik për periudhën raportuese. Raportimi dhe plotësimi i saj do të bëhet në fund të çdo viti financiar.

ST 6Q: Primit dhe dëmet - Cedimi në Risigurim

Primi i shkruar: në këtë zë përfshihet pjesa e primit të ceduar në risigurim, e ndarë sipas produkteve dhe llojeve të marrëveshjeve të risigurimit, sipas periudhës raportuese.

Vlera totale e saj duhet të jetë e barabartë me zërin I – 2 “Prime të ceduara në risigurim” të pasqyrës FI 3Q “Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve”.

Dëmet e ndodhura: në këtë zë përfshihen vlerat e dëmeve të ndodhura gjatë periudhës raportuese për pjesën e risiguresit, sipas produkteve të marra në risigurim dhe kushteve të përcaktuara në marrëveshjet e risigurimit.

ST 7Q: Pasqyra e zhvillimit të provigjonit të dëmeve

(ilustrim)

Viti financiar			Viti i Aksidentit										
			Y-5 dhe vitet e mëparshme	Y-4	Y-4 dhe vitet e mëparshme	Y-3	Y-3 dhe vitet e mëparshme	Y-2	Y-2 dhe vitet e mëparshme	Y-1	Y-1 dhe vitet e mëparshme	Y	Y dhe vitet e mëparshme
Y-5	Provigjoni në fund të vitit		300										
Y-4	Të paguara gjatë vitit		100										
	Provigjoni në fund të vitit		250	200	450								
	Tejkalim/pamjaftueshmëri		-50										
	Tejkalim/pamjaftueshmëri - Raporti		-16.67%										
	Të paguara gjatë vitit		50	60	110								
	Provigjoni në fund të vitit		220	140	360	300	660						
	Tejkalim/pamjaftueshmëri		-70	0	-20								
	Tejkalim/pamjaftueshmëri - Raporti		-23.33%	0.00%	-4.44%								
	Të paguara gjatë vitit		70	80	150	150	300						
	Provigjoni në fund të vitit		130	70	200	150	350	350	700				
	Tejkalim/pamjaftueshmëri		-50	-10	-10	0	-10						
	Tejkalim/pamjaftueshmëri - Raporti		-16.67%	-5.00%	-2.22%	0.00%	1.52%						
	Të paguara gjatë vitit		60	30	90	75	165	120	285				
	Provigjoni në fund të vitit		50	35	85	85	170	150	320	450	770		
	Tejkalim/pamjaftueshmëri		-30	-5	15	-10	25	80	95				
	Tejkalim/pamjaftueshmëri - Raporti		-10.00%	-2.50%	3.33%	-3.33%	3.79%	22.86%	13.57%				
	Të paguara gjatë vitit		75	37	112	56	167	80	247	250	497		
	Provigjoni në fund të vitit		5	2	7	50	57	80	137	350	487	580	1067
	Tejkalim/pamjaftueshmëri		-60	-9	19	-30	29	70	31	-150	-211		
	Tejkalim/pamjaftueshmëri - Raporti		-20.00%	-4.50%	4.22%	-10.00%	4.39%	20.00%	4.43%	-33.33%	-27.79%		

Provigjoni në fund të vitit: në këtë zë përfshihet vlera e provigjonit të dëmeve neto (pa pjesën e risiguruesit) të shoqërisë së sigurimit për periudhën raportuese. Në vlerën e provigjonit të dëmeve do të përfshihen: vlera RBNS, IBNR, si dhe vlerat e shpenzimeve të trajtimit të dëmeve për të gjithë produktet e marra në sigurim (sigurimit të detyrueshëm dhe vullnetar), për të cilat kanë ndodhur dëme në periudhat raportuese.

Të paguara gjatë vitit: në këtë zë do të përfshihet vlera e dëmeve të paguara neto sipas periudhës raportuese nga shoqëria e sigurimit.

Të dhënat e kësaj forme do të përmbajnë minimalisht informacionin e 5 (pesë) viteve të fundit të aktivitetit të shoqërive të sigurimit.

Viti Y – lidhet me vitin aktual të periudhës së raportimit.

TI 12: Mbajtja maksimale neto, për çdo risk për çdo produkt sigurimi

Limiti i kontratës së sigurimit: në këtë zë do të përfshihen limitet maksimale bruto të mbulimit sipas produkteve të sigurimit dhe periudhës së raportimit.

Mbajtja Neto: në këtë zë do të shënohet vlera e mbajtjes maksimale neto për rrezik e shoqërisë së sigurimit sipas produktit të sigurimit, për periudhën paraardhëse dhe periudhën aktuale të raportimit.

ANEKS 7.

Forma, përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të të dhënave teknike 3 mujore.

TI 1: Kufiri minimal i aftësisë paguese, Jo-Jetë

Kapitali i shoqërisë së sigurimit, që ushtron veprimtari sigurimi dhe risigurimi gjatë gjithë veprimtarisë së shoqërisë, nuk duhet të jetë më i ulët se niveli i kërkuar i aftësisë paguese të shoqërisë.

Kufiri minimal i aftësisë pasuese të shoqërisë së sigurimit që ushtron veprimtari në klasat e Jo-Jetës llogaritet me metodën me bazë primet ose me bazë dëmet dhe është vlera maksimale e përfutur nga llogaritjet. Për vitin e parë të veprimtarisë së shoqërisë, niveli i kërkuar i aftësisë paguese llogaritet duke zbatuar metodën me bazë primet.

Referuar formës së “Kufirit minimal të aftësisë paguese” për shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës, **sqarojmë** zërat e mëposhtëm:

1. Llogaritja me bazë primet:

2 – Prime të shkruara nga aktiviteti i sigurimeve:

Ky zë përfshin të ardhurat nga primet e sigurimit të realizuara nga veprimtaritë e drejtëpërdrejta të sigurimit në vitin e fundit ushtrimor

3- Prime të shkruara nga aktiviteti i risigurimeve:

Ky zë përfshin të ardhurat nga primet e sigurimit të realizuara nga veprimtaritë e marrjes në risigurim në vitin e fundit ushtrimor

4 – Taksa të zbritshme:

Ky zë përfshin Taksat dhe tatimet që i zbriten (debitojnë) të ardhurat nga primet e sigurimit të dëmeve (jo jetës).

11 - Dëme të paguara bruto:

Në këtë zë përfshihet vlera monetare e kompensimit për dëmet e ndodhura dhe shpenzimet e trajtimit që i përkasin këtyre dëmeve për periudhën aktuale financiare. Vlera e kompensimit për dëmin e ndodhur është shuma që përfitojnë personat e siguar në rastin e ndodhjes së dëmit, sipas rezultatit të raportit të vlerësimit të dëmit.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë (08) në pasqyrën FI 7.2Q “Llogaria teknike e sigurimeve, Jo-Jetë” dhe zërit III – 1 në pasqyrën e Të Ardhurave Dhe Shpenzimeve.

12 - Pjesa e risiguruesit në dëmet e paguara:

Në këtë zë përfshihet vlera monetare e pjesës së risiguruesit për kompensimin e dëmeve të ndodhura, bazuar në kushtet e marrëveshjeve të risigurimit.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me totalin e të njëjtit zë (09) në pasqyrën FI 7.2Q “Llogaria teknike e sigurimeve, Jo-Jetë”.

14 – Provizijone bruto të dëmeve në periudhën aktuale:

Në këtë zë përfshihet vlera monetare e provigjoneve bruto të dëmeve deri në fund të periudhës aktuale financiare.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me vlerën e të njëjtit zë (C/III) në pasqyrën FI 2Q “Bilanci-Pasivi”, për periudhën aktuale financiare.

15 - Provizijone bruto të dëmeve në fund të vitit të kaluar:

Në këtë zë përfshihet vlera monetare e provigjoneve bruto të dëmeve deri në fund të periudhës së mëparshme financiare.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me vlerën e të njëjtit zë (C/III) në pasqyrën FI 2Q “Bilanci-Pasivi”, për periudhën e mëparshme financiare.

16 – Pjesa e risiguruesve në provigjonet e dëmeve në periudhën aktuale:

Në këtë zë përfshihet vlera monetare e provigjonit të dëmeve, pjesa e risiguruesve, deri në fund të periudhës aktuale financiare.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me vlerën e të njëjtit zë (F/III) në pasqyrën FI 1Q “Bilanci-Aktivi”, për periudhën aktuale financiare.

17 - Pjesa e risiguruesve në provigjonet e dëmeve në fund të vitit të kaluar:

Në këtë zë përfshihet vlera monetare e provigjonit të dëmeve, pjesa e risiguruesve, deri në fund të periudhës së mëparshme financiare.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me vlerën e të njëjtit zë (F/III) në pasqyrën FI 1Q “Bilanci-Aktivi”, për periudhën e mëparshme financiare.

2. Llogaritja me bazë dëmet:

Periudha mesatare e llogaritjes së “Kufirit minimal të aftësisë paguese” për shoqëritë e sigurimit që ushtrojnë veprimtari sigurimi në klasat e jo-jetës është zakonisht tre vjet, por nëse më shumë se 60% e të ardhurave nga primet e një aktiviteti sigurimesh bashkërisht ose të ndara rezultojnë nga kontrata sigurimi që lidhen me rrezikun e dëmeve të kreditit, ngricave, akullit, stuhive, tërmetit, periudha mesatare do të jetë shtatë vjet.

27 - Dëme të paguara bruto në vitin e parë:

Në këtë zë përfshihet vlera monetare e dëmeve të paguara bruto, për vitin e parë të marrë për llogaritjen e periudhës mesatare.

Nëse Y do të ishte viti aktual financiar, viti i parë do t'i referohet vitit financiar Y-2.

28 - Pjesa e risiguruesit në dëmet e paguara në vitin e parë:

Në këtë zë përfshihet vlera monetare e dëmeve të paguara nga risiguruesi, për vitin e parë të marrë për llogaritjen e periudhës mesatare.

30 - Dëme të paguara bruto në vitin e dytë:

Në këtë zë përfshihet vlera monetare e dëmeve të paguara bruto për periudhën e mëparshme financiare.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me vlerën e të njëjtit zë (III-1) në pasqyrën FI 3Q “Llogaria Fitim/Humbje, Jo-Jetë”, për periudhën e mëparshme financiare.

31 - Pjesa e risiguruesit në dëmet e paguara në vitin e dytë:

Në këtë zë përfshihet vlera monetare e dëmeve të paguara nga risiguruesi për periudhën e mëparshme financiare.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me vlerën e të njëjtit zë (III-2) në pasqyrën FI 3Q “Llogaria Fitim/Humbje, Jo-Jetë”, për periudhën e mëparshme financiare.

33 - Dëme të paguara bruto në vitin e tretë:

Në këtë zë përfshihet vlera monetare e dëmeve të paguara bruto për periudhën aktuale financiare.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me vlerën e të njëjtit zë (III-1) në pasqyrën FI 3Q “Llogaria Fitim/Humbje, Jo-Jetë”, për periudhën aktuale financiare.

34 - Pjesa e risiguruesit në dëmet e paguara në vitin e tretë:

Në këtë zë përfshihet vlera monetare e dëmeve të paguara nga risiguruesi për periudhën aktuale financiare. Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me vlerën e të njëjtit zë (III-2) në pasqyrën FI 3Q “Llogaria Fitim/Humbje, Jo-Jetë”, për periudhën aktuale financiare.

36 - Provizijone bruto të dëmeve në fund të vitit të parë:

Në këtë zë përfshihet vlera monetare e provizjoneve bruto të dëmeve në fund të vitit të parë.

Nëse Y do të ishte viti aktual financiar, viti i parë do t'i referohet vitit financiar Y-2.

37 - Provizijone neto të dëmeve në fund të vitit të parë:

Në këtë zë përfshihet vlera monetare e provizjoneve neto të dëmeve, pra duke i zbritur vlerën e provizionit të dëmeve që i takon risiguruesit, në fund të vitit të parë.

ANEKS 8

Forma, përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të të dhënave teknike Ad-Hoc.

TI 3: Informacion për marrëveshjet e risigurimit

*Informacioni të depozitohet brenda pesë ditëve nga dita e lidhjes së marrëveshjes, siç përcaktuar në legjislacionin në fuqi. Në këtë pasqyrë duhet të jepet informacioni mbi të gjitha marrëveshjet e risigurimit që shoqëria ka në fuqi.

Me “marrëveshje”, do të kuptohet marrëveshja e risigurimit që lejon cedimin automatik të klasave dhe shumave të rrezikut të parapërcaktuara, sipas termave dhe kushteve të specifikuara në marrëveshje.

1. Referenca në kontratën origjinale të sigurimit

Në këtë kolonë duhet të jepet numri i referencës së kontratës së sigurimit siç referuar në kontratën origjinale.

2. Lloji i marrëveshjes

Në këtë kolonë shoqëria duhet të specifikojë llojin e marrëveshjes së lidhur siç është referuar në kontratën origjinale të risigurimit.

3. Rreziqet e mbuluara nga marrëveshja

Në këtë kolonë jepet lista e rreziqeve të mbuluara siç është përcaktuar në marrëveshjen e risigurimit.

4. Periudha e mbulimit

- (Nga)

- (Në)

Në këtë kolonë jepet data efektive e fillimit dhe e përfundimit të marrëveshjes së risigurimit siç është përcaktuar në kontratën origjinale, sipas formatit datë/muaj/vit.

5. Monedha e marrëveshjes

Në këtë kolonë jepet monedha origjinale në të cilën është lidhur marrëveshja e risigurimit siç është cilësuar në kontratën origjinale.

6. Mbajtja e shoqërisë

- Për çdo rrezik

- Për çdo ngjarje

Kjo kolonë përmban informacionin lidhur me nivelin e mbajtjes së shoqërisë së sigurimit për çdo rrezik dhe për çdo ngjarje. Niveli i mbajtjes së rrezikut nga shoqëria e sigurimit jepet në vlerë monetare dhe tregon pjesën e mbulimit të pranuar nga shoqëria e sigurimit në kontratën e kaluar në risigurim.

7. Primet e risigurimit

Në këtë kolonë pasqyrohen primet e risigurimit në vlerë monetare në monedhën origjinale të marrëveshjes së risigurimit për secilën nga marrëveshjet e lidhura nga shoqëria.

8. Detaje mbi provigjionim për debitorët të këqinj nga risigurimi

Në këtë kolonë jepen detaje të plota mbi çdo provigjion të mbajtur nga shoqëria për debitorët e këqij nga risigurimi. Përfshihen këtu debitorët e këqij nga risigurimi, informacioni për të cilët duhet të jepet në një faqe të veçantë. Në rast se nuk ka provigjione të tilla, kjo kolonë duhet të lihet bosh.

TI 4: Lista e rreziqeve mbi 10%-in e Aftësisë Pagueuse

Në këtë pasqyrë do të regjistrohen informacionet mbi rreziqet me vlerë të madhe. Konsiderohen rreziqe të mëdha të gjitha ato rreziqe, vlera e të cilave është jo më e ulët se ekuivalenti në Lekë i 10%-it të Aftësisë Pagueuse që zotëron shoqëria. Këtu përfshihet sigurimi i detyrueshëm i mbajtësve të mjeteve motorike, për të cilat është përcaktuar vlera maksimale e përgjegjësisë.

Me anë të kësaj pasqyre shoqëritë e sigurimeve paraqesin në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare:

1. Referenca në kontratën origjinale të sigurimit

Në këtë kolonë duhet të jepet numri i referencës së kontratës së sigurimit siç referuar në kontratën origjinale.

2. Objekti i siguruar

Në këtë kolonë do të regjistrohen të dhënat mbi objektin e marrë në sigurim, siç është referuar në kontratën origjinale.

3. Vendndodhja

Në këtë kolonë shoqëria regjistron të dhënat mbi vendndodhjen e objektit/objekteve të marrë në sigurim siç është referuar në kontratën origjinale.

4. Rreziqe të siguruara

Në këtë kolonë specifikohet lloji i rrezikut apo lista e rreziqeve të mbuluar nga kontrata e sigurimit. Rreziku nënkupton humbjen e mundshme në lidhje me një ngjarje të pritshme (ngjarja e siguruar) në të ardhmen, e cila kur ndodh, i jep të drejtën të siguruarit të dëmshpërblehet nga siguroesi.

5. Monedha në kontratën origjinale

Në këtë kolonë jepet monedha origjinale në të cilën është lidhur marrëveshja e sigurimit siç cilësuar në kontratën origjinale.

6. Shuma e siguruar/Limiti i policës

Këtu do të regjistrohet shuma e siguruar/limiti i policës siç është referuar në kontratën origjinale.

7. Pjesa e zbritshme

Në këtë kolonë shoqëria plotëson në vlerë monetare në monedhën e kontratës pjesën e zbritshme referuar në kontratën origjinale.

8. Data e fillimit

Në këtë kolonë jepet data efektive e fillimit të marrëveshjes së sigurimit siç përcaktuar në kontratën origjinale, sipas formatit datë/muaj/vit.

9. Data e përfundimit

Në këtë kolonë jepet data efektive e përfundimit të marrëveshjes së sigurimit siç është përcaktuar në kontratën origjinale, sipas formatit datë/muaj/vit.

10. Primi i sigurimit

Në këtë kolonë do të regjistrohet primi i sigurimit i shkruar në monedhën origjinale të policës siç është referuar në kontratën origjinale.

11. Mbuluar nga marrëveshja e risigurimit (referenca e marrëveshjes)

Në këtë kolonë duhet të jepet numri i referencës së marrëveshjes (treaty) së risigurimit siç referuar në kontratën origjinale, nëse kontrata e sigurimit në fjalë është ceduar në risigurim nëpërmjet një marrëveshje të tillë.

12. Mbuluar nga kontratë fakultative (referenca e kontratës)

Në këtë kolonë duhet të jepet numri i referencës së kontratës fakultative së risigurimit siç referuar në kontratën origjinale, nëse kontrata e sigurimit në fjalë është ceduar në risigurim nëpërmjet një kontrate të tillë.

Ky informacion paraqitet në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare rast pas rasti, brenda datës 5 të muajit pasardhës.

TI 5: Informacion mbi risigurimet fakultative

Kontrata e risigurimit fakultativ, është një kontratë risigurimi e cila i lejon shoqërisë ceduese të kryejë risigurimin e rreziqeve specifike kur kushtet dhe termat janë ofruar nga shoqëria ceduese dhe pranuar nga risiguruesi.

Në këtë pasqyrë jepet një përmbledhje e kushteve dhe termave e të gjitha marrëveshjeve të risigurimit fakultativ të shoqërisë.

1. Referenca në kontratën origjinale të sigurimit

Në këtë kolonë duhet të jepet numri i referencës së kontratës së sigurimit siç referuar në kontratën origjinale të marrë në sigurim, e cila është ceduar në risigurim.

2. Referenca e risigurimit fakultativ

Në këtë kolonë duhet të jepet numri i referencës së kontratës së risigurimit siç referuar në kontratën origjinale lidhur me risiguruesin.

3. Lloji i risigurimit

Në këtë kolonë jepet lloji i mbulimit ofruar nga marrëveshja e risigurimit.

4. Data e fillimit

Në këtë kolonë jepet data efektive e fillimit të marrëveshjes së risigurimit siç është përcaktuar në kontratën origjinale, sipas formatit datë/muaj/vit.

5. Data e përfundimit

Në këtë kolonë jepet data efektive e përfundimit të marrëveshjes së risigurimit siç është përcaktuar në kontratën origjinale, sipas formatit datë/muaj/vit.

6. Monedha

Në këtë kolonë jepet monedha origjinale në të cilën është lidhur marrëveshja e risigurimit siç është cilësuar në kontratën origjinale.

7. Mbajtja e shoqërisë

Kjo kolonë përmban informacionin lidhur me nivelin e mbajtjes së shoqërisë së sigurimit. Niveli i mbajtjes së rrezikut nga shoqëria e sigurimit jepet në vlerë monetare dhe tregon pjesën e mbulimit të pranuar nga shoqëria e sigurimit në kontratën e kaluar në risigurim.

8. Limiti i kontratës së risigurimit

Në këtë kolonë jepet limiti i marrëveshjes së risigurimit siç është specifikuar në kontratën origjinale të risigurimit në vlerë monetare.

9. Prime të risigurimit minus komisione të risigurimit

Këtu jepet diferenca në vlerë monetare ndërmjet primit të risigurimit, që është vlera e pjesës së primit të sigurimit e ceduar në risigurim sipas kontratës përkatëse, dhe komisionit të risigurimit ku përfshihet vlera e komisionit që shoqëritë ceduese marrin nga shoqëritë e risigurimit për biznesin e siguruar.

Informacioni për çdo marrëveshje risigurimi të lidhur nga shoqëria duhet të raportohet brenda 10 ditëve kalendarike nga nënshkrimi i tyre.

TI 6: Informacion mbi risiguruesit

Në këtë pasqyrë do të jepet informacioni mbi risiguruesit, sipas marrëveshjeve apo kontratave fakultative të risigurimit që shoqëria ka lidhur. Me “marrëveshje”, do të kuptohet marrëveshja e risigurimit e tipit “Treaty” që lejon cedimin automatik të klasave dhe shumave të rrezikut të parapërcaktuara, sipas termave dhe kushteve të specifikuara në marrëveshje.

Për përcaktimin e kontratës fakultative të risigurimit, shih shpjegimin në seksionin për pasqyrën TI 5.

1. Referenca e marrëveshjes / kontratës fakultative të risigurimit

Në këtë kolonë duhet të jepet numri i referencës së marrëveshjes/ kontratës së risigurimit siç është referuar në kontratën origjinale.

2. Emrat e risiguruesve

Në këtë kolonë duhet të jepet emri/emrat e plotë të risiguruesve me të cilët është lidhur marrëveshja/ kontrata fakultative e risigurimit siç është referuar në kontratën origjinale.

3. Adresa e zyrës së regjistruar

Në këtë kolonë jepet adresa e plotë e risiguruesit siç është referuar në kontratën origjinale.

4. Pjesëmarrja në shtresa të palimituara në marrëveshje (po/jo)

Me “shtresë të mbulimit me risigurim” do të kuptohet një segment horizontal i përgjegjësisë së risiguruar. Shtresat e mbulimit me risigurim përcaktohen bazuar në shumën e siguruar.

Në këtë kolonë do të jepet informacion mbi pjesëmarrjen ose jo në shtresa të palimituara nga ana e risiguruesit në marrëveshje.

5. Agjencia e klasifikimit

Në këtë kolonë do të jepet emri i agjencisë së klasifikimit të cilës i referohet siguruesi në përzgjedhjen e risiguruesit, siç përcaktuar në Rregulloren e AMF Nr. 2 datë, 18.06.2007, neni 4.

6. Klasifikimi i fundit

Në këtë kolonë duhet të jepet klasifikimi i fundit i publikuar nga agjencia e klasifikimit (e dhënë në kolonën 5), për risiguruesin përkatës.

7. Lidhja në rast se ka, midis risiguruesit dhe siguruesit

Në këtë kolonë shoqëria e sigurimit, duhet të japi informacion nëse ka ose jo lidhje midis risiguruesit dhe shoqërisë.

8. Detyrime të risiguruesit në fund të periudhës

Në këtë kolonë do të jepet në vlerë monetare nëse ka, detyrimi që risiguruesi ka kundrejt shoqërisë së sigurimit që raporton në fund të periudhës së raportimit.

TI 7: Lista e dëmeve mbi 10 mln. lekë

Në këtë pasqyrë do të përfshihen disa nga informacionet kryesore që lidhen me dëmet e mëdha mbi 10 milionë lekë. Do të konsiderohen dëme të mëdha ato që për një rast sigurimi kanë vlerën mbi 10 milionë lekë. Shoqëria e sigurimit raporton në AMF të dhënat që kanë të bëjnë me objektin apo personin e dëmtuar, vendndodhjen, të dhëna për policën e sigurimit vlerën e dëmit pjesën që ka përballuar shoqëria dhe pjesën që i takon risiguruesit, si dhe dokumente të tjera që i gjykon të arsyeshme Autoriteti në raste të caktuara.

1. Referenca e dëmit

Në këtë kolonë do të jepet referenca e praktikës së dëmit siç është pasqyruar në bazën e të dhënave të shoqërisë që raportohet pranë AMF dhe që duhet të merret në konsideratë për përlogaritjen e provigjoneve teknike.

2. Numri i kontratës

Në këtë kolonë do të jepet numri i kontratës të lidhur ndërmjet shoqërisë dhe përfituesit të dëmshpërblimit siç është referuar në kontratën origjinale.

3. Data e ndodhjes

Në këtë kolonë shoqëria duhet të raportojë datën e saktë të ndodhjes së ngjarjes (dëmit) që përbën rastin e sigurimit sipas formatit datë/muaj/vit.

4. Data e raportimit

Në këtë kolonë shoqëria duhet të pasqyrojë datën e saktë të raportimit të ngjarjes që përbën rastin e sigurimit sipas formatit datë/muaj/vit.

5. Vendi

Në këtë kolonë shoqëria duhet të raportojë vendin e saktë të ndodhjes së ngjarjes që përbën rastin e sigurimit.

6. Rezerva bruto fillestare

Në këtë kolonë shoqëria duhet të pasqyrojë në vlerë monetare vlerësimin e saj fillestar për rezervën bruto për dëmin e raportuar.

7. Pjesa e risiguruesit në rezervën fillestare

Kjo kolonë duhet të paraqesë në vlerë monetare pjesën e risiguruesit në rezervën fillestare bruto të llogaritur nga shoqëria për dëmin e raportuar, në rastet kur ka të tilla.

8. Rreziku i siguruar

Në këtë kolonë specifikohet lloji i rrezikut të mbuluar nga kontrata e sigurimit. Rreziku nënkupton humbjen e mundshme në lidhje me një ngjarje të pritshme (ngjarja e siguruar) në të ardhmen, e cila kur ndodh, i jep të drejtën të siguruarit të dëmshpërblehet nga siguresi.

9. Monedha në kontratën origjinale

Në këtë kolonë jepet monedha origjinale në të cilën është lidhur marrëveshja e sigurimit siç është cilësuar në kontratën origjinale.

10. Mbuluar nga marrëveshja (referenca e marrëveshjes)

Në këtë kolonë duhet të jepet numri i referencës së marrëveshjes (treaty) së risigurimit siç është referuar në kontratën origjinale, nëse kontrata e sigurimit në fjalë është ceduar në risigurim nëpërmjet një marrëveshje të tillë.

11. Mbuluar nga kontratë fakultative (referenca e kontratës)

Në këtë kolonë duhet të jepet numri i referencës së kontratës fakultative së risigurimit siç është referuar në kontratën origjinale, nëse kontrata e sigurimit në fjalë është ceduar në risigurim

nëpërmjet një kontrate të tillë. Ky informacion paraqitet në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare rast pas rasti, brenda 5 ditëve nga ndodhja e ngjarjes.

TI 8: Raporti i Auditit të Jashtëm

Raporti i auditorit të jashtëm i referohet periudhës së auditimit të pasqyrave financiare të shoqërisë, sipas letrës së angazhimit të auditit të jashtëm. Me vite të njëpasnjëshme të auditimit të shoqërisë nënkuptohen vitet e auditimit të kryera nga e njëjta shoqëri auditimi.

Ndërsa periudha e auditimit do të quhet periudha e cila i nënshtrohet auditimit të pasqyrave financiare të shoqërisë nga auditori i jashtëm i saj miratuar nga AMF.

Në rubrikën bashkëngjit një kopje elektronike të raportit të skanuar, shoqëria duhet të bashkëngjisë një kopje elektronike të raportit të auditit të jashtëm së bashku me kopjen elektronike të “Letrës për Drejimin” (Letra e Manaxhimit), që shoqëria e auditit të jashtëm përgatit për drejtuesit e lartë të shoqërisë që auditohet.

Lloji i raportit nënkupton , raportin e lëshuar nga auditit i jashtëm i shoqërisë, përcaktuar në letrën e angazhimit të shoqërisë së auditit të jashtëm, i cili duhet të jetë raport i pasqyrave financiare individuale të shoqërisë dhe raport i konsoliduar i aktivitetit të saj për periudhën e audituar, në rastet kur ka një të tillë.

TI 9: Caktimi i Ekspertit Kontabël të Pavarur

Në rubrikën 1. Depozitimi i kërkesës në AMF, periudha që do të auditohet i referohet vitit financiar që shoqëria kërkon të auditohet.

Në rubrikën 2. Statusi i kërkesës së paraqitur në AMF, pika c, në proces, plotësohet seksioni komente, duke listuar dokumentacionin shtesë të kërkuar nga AMF, (në rastet kur një i tillë kërkohet) dhe me informacion tjetër të ndryshëm nga ai i dokumentacionit shtesë.

TI 10: Raporti i Auditit të Brendshëm

Raporti i Auditit të Brendshëm plotësohet nga shoqëritë në rastet e raportit vjetor të auditit të brendshëm të tyre të miratuar nga këshilli mbikëqyrës i shoqërisë.

Kjo formë plotësohet edhe për raporte të tjera tematike të auditit të brendshëm të shoqërisë, në rastet kur këto raporte kërkohet të kryhen në zbatim të rekomandimeve të lëna në raportet e inspektimit në vend të AMF në shoqëri duke respektuar afatet e vendosura në këto rekomandime.

TI 11: Programi i Risigurimit

Programi i risigurimeve duhet të përmbajë:

- a. llogaritjen e rreziqeve të mbajtura për çdo klasë sigurimi;
- b. tabelën e mbulimeve maksimale, të hartuar në bazë të llogaritjeve të përmendura në shkronjën “a” të kësaj pike;
- c. vlerësimin e mbajtjes neto të mbulimit maksimal agregat të rreziqeve të një

shoqërie sigurimi, që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të tërmeteëve dhe vlerësimin e mbajtjes maksimale për rreziqe të tjera agregate dhe të akumuluar, në përputhje me nenin 116, të Ligjit 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit, dhe aktet e Autoritetit;

- ç. Procedurat, bazat teknike dhe kriteret e përcaktimit të mbajtjes maksimale për rreziqe të tjera agregate dhe të akumuluar për kontrata të nënshkruara nga shoqëria e sigurimit, në rastet kur nuk janë të përcaktuara me aktet e Autoritetit.

Në llogaritjet referuar shkronjës "a", të programit të risigurimit, shoqëria e sigurimit merr parasysh:

- a. nivelin e kapitalit dhe nivelin e kërkuar të aftësisë paguese;
- b. volumin total të veprimtarisë;
- c. primet e shkruara të sigurimit, të ndara për çdo klasë sigurimi;
- ç. peshën specifike të çdo klase sigurimi në bazat teknike, referuar shkronjave "b" dhe "c" të kësaj pike;
- d. përshtatjet si pasojë e shmangieve brenda klasave të veçanta të sigurimeve.

Llogaritjet për rreziqet agregate, të lidhura me sigurimin nga katastrofat natyrore, kryhen në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 116, të Ligjit 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".

Në këtë formë, shoqëria e sigurimit duhet të bashkëngjisë një kopje të programit të risigurimit.

ANEKS 9

Forma, përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të të dhënave teknike vjetore.

TI 2: Kufiri minimal i aftësisë paguese, Jeta

Kapitali i shoqërisë së sigurimit, që ushtron veprimtari sigurimi dhe risigurimi gjatë gjithë veprimtarisë së shoqërisë, nuk duhet të jetë më i ulët se niveli i kërkuar i aftësisë paguese të shoqërisë.

Kufiri minimal i aftësisë paguese të shoqërisë së sigurimit që ushtron veprimtari sigurimi në klasat e jetës si dhe sigurimi i jetës i lidhur me fondet e investimeve, llogaritet si shuma e dy rezultateve që përftohen nga llogaritjet me metodën me bazë primet dhe metodën me bazë dëmet.

Referuar formës së “Kufirit minimal të aftësisë paguese” për shoqëritë sigurimit të jetës, sqarojmë zërat e mëposhtëm:

1. Kufiri minimal i aftësisë paguese për kontratat që nuk lidhen me fonde të investimeve:

Llogaritja e parë:

3 – Provigjone matematike bruto në fund të periudhës:

Në këtë zë përfshihet vlera monetare e provigjoneve matematike për veprimtaritë e veta të shoqërisë së sigurimit dhe ato të marra në risigurim, pa zbritur provigjonet matematike që i përkasin pjesës së ceduar në risigurim, deri në fund të periudhës aktuale financiare.

Vlera e këtij zëri duhet të jetë e barabartë me vlerën e të njëjtit zë (C/II) në pasqyrën FI 2Q “Bilanci-Pasivi”, për periudhën aktuale financiare.

4 - Provigjone matematike neto në fund të periudhës:

Në këtë zë përfshihet vlera monetare e provigjoneve matematike për veprimtaritë e veta të shoqërisë së sigurimit dhe ato të marra në risigurim, pasi zbriten provigjonet matematike që i përkasin pjesës së ceduar në risigurim, deri në fund të periudhës aktuale financiare.

Llogaritja e dytë:

9 – Vlera e kapitalit në rrezik bruto për kontratat me afat 5 vjet ose më shumë:

Në këtë zë përfshihet vlera totale jonegative e kapitalit të rrezikuar për kontratat individuale të sigurimit të jetës (duke mos zbritur vlerën e kapitalit të rrezikuar që i përket pjesës së dhënë në risigurim), të cilit i zbritet totali i vlerës së kapitalit të rrezikuar që lidhet me kontratat e sigurimit të jetës me afat 5 vjet ose më shumë.

Me **vlerë të kapitalit të rrezikuar** do të kuptohet shuma e sigurimit që duhet të paguajë shoqëria e sigurimit, në rast vdekje të ndodhur në kohën e përcaktimit të kërkesave për nivelin e kërkuar të marzhit të aftësisë paguese, e reduktuar nga shuma e provigjoneve matematike të krijuara deri në atë datë në lidhje me sigurimin e dhënë. (Kur llogaritet niveli i kërkuar i aftësisë paguese, nuk mund të merret në konsideratë vlera negative e kapitalit të rrezikuar.)

10 - Vlera e kapitalit në rrezik neto për kontratat me afat 5 vjet ose më shumë:

